



Raport përfundimtar

**Projekti: "Mbikëqyrja e implementimit të standardeve
ndërkombëtare për gjykime të drejta
në gjykatat e vendit dhe vlerësimi për funksionimin e gjyqësisë
në Republikën e Maqedonisë"**

Shkup, shtator 2004

- »ADI - Gostivar
- »АНИ - Штип
- »АРКА - Куманово
- »АСВИН - Скопје
- »Граѓански патеки - Битола
- »Здружение за правата на ромите - Штип
- »ЗПД - Скопје
- »Меѓаши - Скопје
- »МОСТ - Скопје
- »Младински Образовен Форум - Скопје
- »МПРЦ - Скопје
- »ПХУРТ - Делчево
- »РОЗПР - Скопје
- »Спектар - Штип
- »СППМД - Кавадарци
- »ТЕМИС - Скопје
- »ФЕМИНА - Куманово
- »ФОКУС - Ресен
- »Хелсиншки комитет за човекови права - Скопје
- »CDR - Tetovo

Raport përfundimtar

I përgatitur në bazë të gjykimeve të mbikëqyrura prej qershorit deri më korrik 2004

Autorët: prof. dr Arsen Janevski; zotri Ranko Maksimovski, gjykatës i pensionuar në Gjykatën Supreme ; prof. dr Lupço Arnaudovski; dr Gordan Kajalxhiev; doc. dr Gordana Buzharovska; zonjusha Jasna Cvetkovska, analitik juridik në Koalicionin

Përmbajtje

Falënderim
Hyrje
Rezyme e shkurtër
Shkurtica

Kreu 1 Të dhëna themelore

- 1. Koalicioni “Të gjithë për gjykime të drejta”**
- 2. Metodologjia, korniza kohore dhe temat**

Kreu 2 Implementimi i standardeve ndërkombëtare për gjykime të drejta

1. E drejta e barazisë në gjykata

Procedura Civile

2 E drejta për gjykim para gjykatës kompetente, të pavarur e të paanshme dhe të themeluar me ligj

Procedura Penale

Procedura Civile

3. Barazi armësh

4. E drejta për të qenë i pranishëm në gjykim

5. E drejta e gjyimit publik

6. Gjykimi në afat të arsyeshëm

Procedura Penale

Procedura Civile

7. E drejta e heshtjes

8. E drejta për përkthyes

Procedura Penale

Procedura Civile

9. E drejta për mbrojtje

Procedura Penale

Procedura Civile

10. E drejta e ankesës

Procedura Penale

Procedura Civile

Kreu 3 Funsionimi i Gjyqësisë

- 1. Shpërndarja e lëndëve**
- 2. Përgatitja e lëndëve**

3. Sistemi i zhvillimit të lëndëve
4. Caktimi i seancave
5. Procesverbale
6. Vendimet Gjyqësore
7. Kodi Etik
8. Shkarkimi dhe disiplina e gjykatësve
9. Pajisje zyrash dhe me kompjutorë
10. Efikasiteti i administratës gjyqësore
11. Ndërtesat e gjykatave dhe sigurimi
12. Finansimi i gjyqësisë

Rekomandime

Shtojca 1: Raport për lëndët me interes të veçantë për Koalicionin

Shtojca 2: Konkluzione nga tryeza e rumbullakët e mbajtur me rastin e Raportit Përfundimtarë të Koalicionit “Të gjithë për gjykime të drejta”

Shtojca 3: Letra përkrahjeje

Falënderim

Raporti përfundimtar i Koalicionit “Të gjithë për Gjykime të drejta” paraqet rezultatin e një përcaktimi të përbashkët dhe të këmbëngultë të një numri të madh aktorësh. Para së gjithash, raporti është rezultat i një profesionalizmi dhe kontributi objektiv të vëzhguesve të Koalicionit, nëpërmjet regjistrimit të të dhënave nga proceset gjyqësore, të koordinatorëve rajonale të cilët luajnë rolin e shtyllave bartëse të strukturës së Koalicionit dhe garancion për realizimin e aktiviteteve të projektit si dhe të ekspertëve juridikë lokalë të cilët njëherit paraqesin edhe kontrollin e parë të saktësisë të të dhënave.

Raporti përfundimtar bazohet në analizat e kryera nga ana e prof. D-r Ljupço Arnaudovski, D-r Gordana Kajallxhievaska dhe Doc. D-r Gordana Buzharovska në sferën e materies penale dhe Prof. Dr. Arsen Janevski dhe Z.Ranko Maksimovski, gjyqtarë në Gjykatën Supreme, në pension, në sferën e procedurave civile.

Realizimi i raportit të Koalicionit, nuk do të ishte i mundur pa përkrahjen e Sektorit për sundimin e së drejtës pranë OSBE-së në Shkup.

Përkrahja financiare për aktivitetet e projektit u mundësua nga Agjencioni Kanadez Ndërkombëtar për Zhvillim (CIDA), Sektori për sundimin e së drejtës pranë OSBE-së, Ambasada Kanadeze në Shkup si dhe Fondacioni Instituti Shoqëria e Hapur – Maqedoni.

Koalicioni “Të gjithë për gjykime të drejta” u falënderon Kryetarëve të Gjykatave Themelore të R. së Maqedonisë, të cilët duke bërë të mundshme qasjen në të dhënat për lëndët e vëzhguara, i ndihmojnë përpjekjet e Koalicionit për zmadhimin e besimit të qytetarëve ndaj gjyqësisë dhe identifikimin e problemeve me të cilat ballafaqohet gjyqësia si dhe gjetjen e zgjidhjeve të mundshme për eliminimin e tyre. Poashtu falënderojmë Kryetarin e Gjykatës Supreme të R. së Maqedonisë dhe Ministrinë e Drejtësisë për përkrahjen gjatë fillimit të realizimit të projektit “Implementimi i standardeve Ndërkombëtare për gjykime të drejta më Gjykatat e vendit dhe vlerësimi i funksionimit të gjyqësisë në Republikën e Maqedonisë”.

Para së gjithash, falënderim iu drejtojmë të gjithë gjykatësve në Gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë për sjelljen profesionale dhe korekte ndaj vëzhguesve.

Hyrje

Gjatë vitit në të cilin realizohej projekti "Implementimi i standardeve Ndërkombëtare për gjykime të drejta në Gjykatat e vendit dhe vlerësimi i funksionimit të gjyqësisë në Republikën e Maqedonisë", gjyqësia në Republikën e Maqedonisë gjendej nën shtypje të vazhdueshme të faktorëve politik të vendit dhe të jashtëm, vlerësime të organeve të vendit dhe të jashtme, të institucioneve, si dhe mediave publike. Në të gjitha diskutimet, vlerësimet dhe analizat për gjyqësinë, ajo u kualifikua si joazhure, jo efikase dhe e korumpuar, kurse funksionimi zhvillohet në mënyrë që do të mund të ndihmojë dhe përparojë funksionimin e shtetit, mbi postulatet për sundimin e drejtësisë.¹

Poashtu, në këtë periudhë kohore punohej në Ndryshimet dhe plotësimet e LPP, i cili ende gjendet në shqyrtim parlamentar, si dhe në Propozim Ndryshimet dhe plotësimet e LPP dhe LZD. Pastaj, u formua Komisioni për punë rreth ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për Gjykatat, kurse në ndërkohë u përgatit Propozim Strategji për reforma në sistemin gjyqësor, prokurorisë publike, sistemit të instituteve penitenciare, avokaturës publike, avokaturës dhe notarisë. Është sjellur edhe Ligji për buxhet të pavarur gjyqësor.

Në këtë gjendje në të cilën gjendet gjyqësia, dhe nevoja për reforma me qëllim të sigurimit të qasjes së shpejtë ndaj drejtësisë, realizimit të shpejtë të të drejtave dhe interesave juridike të qytetarëve, si dhe mbrojtje efikase të të drejtave të njeriut, nëpërmjet mehanizmave të sistemit juridik, rezultatet e fituara me realizimin e këtij projekti do të japin të dhëna të kontrolluara në mënyrë empirike të cilat do të gjenden në funksion të realizimit të reformave të gjyqësisë të parashtruara në këtë mënyrë.

Raporti Përfundimtar i Koalicionit "Të gjithë për Gjykime të drejta" i prezenton të dhënat e grumbulluara në procesin e vëzhgimit, veçmas për çdo standard ndërkombëtar, si në veprat penale, ashtu edhe në ato civile. Andaj, është kryer një pasqyrë krahasuese e rregullores vendase dhe rregullores ligjore të vendeve të tjera dhe dispozitave të dokumenteve Ndërkombëtare. Nga rezultatet dhe përfundimet janë dhënë rekomandime për zgjidhje të ardhshme të cilat do të kishin dhënë kontribut për zbatim përkatës të standardeve ndërkombëtare për gjykime të drejta.

Për prezentim më të mirë të fakteve dhe gjendjeve të caktuara, në tekst janë dhënë edhe shembuj për lëndë të vëzhguara.

¹ Ky pohim posaçërisht vjen në shprehje përmes titujve të shpallur në ndonjë mjet për informim publik: "Janë të kota ndryshimet në legjislativë pa riorganizimin e gjyqësisë" (Dnevniku i 12.05.2004); "Për pak do të shkoja në burg për shkak të gabimit gjyqësor" (Vreme e 27.04.2004); "Burg për Gjykatësin i cili ka pranuar 250 evra mito" (Vest i 19.07.2004); "Gjyqësia është pengesë për luftë kundër kriminalitetit" (Dnevniku i 05.08.2004) dhe të ngjashme

Rezime e Shkurtër

Konkluzat për gjendjet në gjyqësinë e R. së Maqedonisë, nga këndvështrimi i zbatimit të standardeve ndërkombëtare për gjykime të drejta, që i përmban Raporti Përfundimtar i Koalicionit "Të gjithë për gjykime të drejta" kanë për qëllim përparimin e sistemit gjyqësor dhe funksionimi i tij në pajtim me ato standarde.

Analizat për respektimin e të drejtës për gjykim para Gjykatës kompetente, të pavarur, të paanshme dhe ligjërisht të themeluar tregojnë se në procedurën civile dhe penale:

- Gjykatat janë formuar në pajtim me dispozitat ligjore.
- Kërkesa për përjashtim të gjykatësve dhe Gjykatësve porotë nuk përfshihet shpesh herë.
- Në numër të caktuar rastesh, sjellja e porotësve është mjaftë indiferente dhe e painteresuar.
- Në situata të jashtëzakonshme, dispozitat e Rregullores së Gjykatës për shpërndarjen e lëndëve mes Gjykatësve, nuk respektohen, me çka çështja e paanësisë vëhet në pyetje.

Në domenin e respektimit të Parimit për barazi të armëve, është konstatuar se:

- Ekziston numër i vogël i lëndëve ku ka shkelje të së drejtës që i akuzuari dhe mbrojtësi i tij të kenë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së vet.
- I akuzuari dhe mbrojtësi i tij kanë pasur shansë të ndershme të shprehin mbrojtjen e tyre, si dhe t'u kundërvihen akuzave dhe dëshmive të prokurorisë.

Gjykatat e respektojnë të drejtën e të akuzuarit të jetë prezent gjatë marrjes së veprimeve të procesit, kurse gjykimet në mungesë të mbrojtjes janë të ralla, dhe pa përjashtim caktohet mbrojtës në mënyrë zyrtare.

Nga aspekti i **të drejtës së gjyimit publik**:

- Në disa nga Gjykatat nuk shpallen orare ditore të gjykimeve para gjykatës ku ato duhet të mbahen.
- Në rast të mosprezencës së opinionit, vendimet merren nga ana e Gjykatësit në pajtim me dispozitat ligjore për vepra civile dhe penale.
- Në disa Gjykata është vërejtur mbajtje e gjykimeve nëpër Zyra të Gjykatësve, në vend në gjykatore.

Sa i përket Të drejtës për Gjykime në afat të arsyeshëm, rezultatet tregojnë se:

- Gjykimet sipas rregullit kanë kohëzgjatje të shkurtër, dhe më së shpeshti arsyet për anulimin e seancave janë nga ana e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.

- Nga parashtrimi i akuzës deri në caktimin e shqyrtimit kryesor, më së shpeshti kalon tepër kohë.
- 12,2% së seancave të vëzhguara janë shtyrë për më tepër se 30 ditë, që sjell deri tek shtyrja e panevojshme e procedurës.
- Ekziston nevoja për bashkëpunim më të madh mes Gjykatës dhe MPB në aspekt të kryerjes së urdhërave për arrestime të dhunshme.
- Gjykatësi rallë kryen urgjencë për shpejtimin e realizimit të ekspertizës.

Në parim e **drejta për heshtje** respektohet në procedurën para Gjykatave Themelore. Personat e akuzuar rallë e përdorin të drejtën e heshtjes.

Në gjykatat e RM-së ka mungesë të përkthyesëve të kualifikuar, që sjell deri tek shtyrja e procedurës deri në momentin e sigurimit të tyre, apo vjen deri tek përdorimi i shërbimit nga persona që nuk janë të kualifikuar në mënyrë përkatëse.

E drejta për mbrojtës respektohet nga ana e gjykatësve. Në numrin më të madh të rasteve akuzuesin dhe të akuzuarin i përfaqëson person i autorizuar në procedurën para gjykatës, i cili më së shpeshti është avokat. E drejta për ndihmë juridike pa pagesë shfrytëzohet shumë rallë në lëndët penale.

Sipas analizave të gjykimeve të vëzhguara nuk janë vërejtur shkelje të së **drejtës për ankesë**.

Problemi i kushteve hapësinore dhe teknike për punë, respektivisht numri i pamjaftueshëm i sallave për gjykime dhe ekipimit kompjuterik, ka ndikim të madh në funksionimin e gjyqësisë në R. e Maqedonisë.

SHKURTICAT

LPN	Ligji i procedurës ndërgjyqësore (gazeta Zyrtare e RM-së 33/98)
LPP	Ligji i Procedurës penale (gazeta zyrtare e RM-së 15/97; 44/02)
DUPNJ	Deklarata Univerzale për të drejtat e njeriut (sjellur nga Kuvendi i Përgjithshëm i OKB-së 1948)
KEDM	Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut (Këshilli i Evropës 1953)
PNDC	Pakti Ndërkombëtar për të drejta civile dhe politike (Kombet e Bashkuara 1966)
LGJ	Ligji i Gjykatave (Gazeta Zyrtare e RM-së 36/95; 45/95; 64/03)
LTGJ	Ligji i taksave Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e RM-së 46/90; 11/91; 65/92; 20/95; 48/99)
RGJ	Rregullorja Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e RM-së 9/97)
LNPLPN	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurë ndërgjyqësore (Gazeta Zyrtare e RM-së 44/02)
KP	Kodi Penal (Gazeta Zyrtare e RM-së 37/96; 80/99; 4/02; 43/03; 19/04)

KREU I Të dhëna elementare

1. Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë”

Koalicioni i shoqatës së qytetarëve “Të gjithë për gjykim të drejtë”-Shkup është organizatë në të cilën në bazë vullnetare anëtarsojnë 20 OJQ-ja nga tërë territori i Republikës së Maqedonisë:

MOST-Shkup, Forumi rinor arsimor (FRA)-Shkup, SPPMD-Kavadar, CDR-Tetovë, ARKA-Kumanovë, FEMINA-Kumanovë, ADI-Gostivar, Gra|anski pateki-Manastir, Shoqata për të drejtat e romëve ARRP-Shtip, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në R. e Maqedonisë, Shoqata për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës-Shkup, Megjashi-Shkup, PHURT-Dellçevë, ROZRR-Shkup, ASVIN-Shkup, MRRC-Shkup, GIC Spektar-Shtip dhe FOKUS-Resnjë, Temis-Shkup, ANI – Shtip dhe Meseçina – Gostivar.

Është themeluar më 12 maj të vitit 2003, me qëllim që:

- Ta shtojë respektimin e standardeve për gjykim të drejtë në gjykatat e vendit
- Ta shtojë besimin e opinionit në sistemin ligjor dhe në gjyqësinë
- T’i identifikojë problemet në sistemin gjyqësor dhe të vë në pah nevojën për një reformë juridike dhe institucionale
- Ta njoftojë opinionin me standardet e gjykimit të drejtë


Trupi më i lartë i vendosjes është Kuvendi i Koalicionit, në të cilin çdo organizatë anëtare në koalicionin ka përfaqësues të vetin.

Organi ekzekutiv i Koalicionit është Bordi Ekzekutiv i cili ka 8 anëtarë dhe kryetarin e Koalicionit z. Trajçe Pelivanov.

Drejtoreshë ekzekutive e Koalicionit është zonja Violeta Vellkoska.

Koalicioni ka 80 vëzhgues të stërvitur nga radhët e juristëve dhe avokatëve të cilët bëjnë monitorimin e lëndëve cilive dhe penale në të gjitha Gjykatat themelore në R. e Maqedonisë.

Aktiviteti i tyre koordinohet përmes 7 zyrave rajonale të cilat mbulojnë gjykata të ndryshme edhe atë:



Pasqyrë e mbulimit të Gjykatave themelore në R. e Maqedonisë nga zyrat rajonale

Zyrat rajonale angazhojnë koordinator lokal i cili e organizon dhe e mbikqyr punën e vëzhguesve dhe ekspertin juridik lokal i cili përgatit analiza mujore juridike për lëndët e vëzhguara.

Projekti pilot i Koalicionit: "Implementimi i standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë në gjykatat e vendit dhe vlerësimi i funksionimit të gjyqësisë në Republikën e Maqedonisë u realizua prej Prillit deri në Shtator të vitit 2003 me ndihmë financiare nga Agjencioni kanadez për zhvillim ndërkombëtar (CIDA) dhe me mbikqyrje nga Sektori për sundimin e drejtësisë të Misionit të monitorimit të OSBE-së në Shkup. Pas përfundimit të suksesshëm të pilot projektit, procesi i vëzhgimit të lëndëve civile dhe penale vazhdoi në kontinuitet deri në korrik të vitit 2004.

Në fillim të muajit Maj të vitit 2003 ishte përgatitur versioni punues i "Doracakut për vëzhgimin e gjykimeve" nga ekipi i përbërë prej ekspertëve juridikë, që shërbeu si bazë për stërvitjen e 108 avokatëve, juristëve, studentëve të fakultetit juridik – aktivistë nga sfera e të drejtave të njeriut.

Përveç doracakut ishin përgatitur edhe pyetsorë për vëzhgimin e lëndëve civile dhe penale të cilët shërbyen si instrumentë për grumbullimin e informatave të paanshme dhe të vërteta për implementimin e standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë në praktikën e gjykatave të vendit.

Në Qershor të vitit 2003 pas dhënies së pëkrahtjes nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe nga Ministria e drejtësisë, u njoftuan kryetarët e të gjitha gjykatave themelore në Maqedoni e përmes tyre edhe të gjithë gjykatësit për praninë e vëzhguesve nëpër gjykatore.

Prej fillimit të Korrikut të vitit 2003 në të gjitha Gjykatat themelore në R. e Maqedonisë 108 vëzhgues e filluan ndjekjen e proceseve gjyqësore.

U hartua "Rregullorja e sjelljes" dhe i njehti u nënshkrua solemnisht dhe u pranua nga të gjithë vëzhguesit e Koalicionit.

Të dhënat e grumbulluara të paanëshme për lëndët e vëzhguara civile dhe penale prej pyetësorëve u sistematizuan në bazën e të dhënave të përgatitura me qëllim që të mundësohet analizë e mëtejshme nga ekipi i ekspertëve juridikë.

Opinionit u informua për aktivitetet e Koalicionit dhe për standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë nëpërmjet pamfleteve, konferencave të shtypit, Raporteve për lëndët e zgjedhura nga Koalicioni si lëndë me interes të veçantë dhe Veb faqja e Koalicionit: www.all4fairtrials.org.mk

Koalicioni gjatë realizimit të aktiviteteve të veta bashkëpunon me fakultetin juridik "Justinian I" nga Shkupi dhe me Fakultetin juridik të Universitetit të Evropës Juglindore nëpërmjet programit për stërvitjen e studentëve për standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë.

Më 23.09.2004, në organizim të Koalicionit "Të Gjithë për gjykime të drejta", dhe sketorit për mbisundimit e të drejtës në OSBE-Misioni në Maqedoni, u mbajt një tryezë e rumbullakët për të prezantuar përfundimet dhe rekomandimet nga vëzhgimi njëvjetor i

lëndëve civile dhe penale në të gjitha Gjykatat Themelore në Maqedoni, në përputhje me raportin Përfundimtar të Koalicionit, si dhe konsultime dhe diskutim rreth tyre.²

Në tryezën e rumbullakët, përveç anëtarëve të Zyrës Nacioanale të Koalicionit si dhe ekspertëve Nacional juridik të sferës civile dhe juridike, përfaqësues të Misionit vëzhgues të OSBE-së në Shkup, morrën pjesë edhe përfaqësuesit më të lartë të gjyqësisë, Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë, Shoqatës së Gjykatësve, Shoqatës së Prokurorëve publik, Këshillit Gjyqësor Republikan, Zyrës së Avokatit Popullor, Zyrës së Këshillit të Evropës në Shkup si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të cilat punojnë në sferën e funksionimit të gjyqësisë.

2. Metodologjia, korniza kohore dhe temat

Metodologjia

Raporti përfundimtar i Koalicionit paraqet rezultat të analizës së bërë në bazë të të dhënave të fituara në pyetësorët për vëzhgimin e lëndëve penale dhe civile, përkatësisht në bazë të të dhënave të mara me përpunimin e bazës së të dhënave, si dhe të raporteve të bëra nga ekspertët juridik lokal, raporteve të koordinatorëve lokal dhe vëzhguesve.

Metoda themelore e realizimit të projektit dhe qëllimeve e detyrave të shtruarra është: Metoda e mbikqyrjes së proceseve që realizohen në gjykatat themelore të Republikës së Maqedonisë.

Në pajtim me temat e zgjedhura nga anëtarët e Koalicionit si tema me interes të veçantë, zgjedhjen e lëndëve e bën koordinatori lokal i cili Zyrës Nacionale të Koalicionit në Shkup i paraqet “propozim mujor të lëndëve për përcjellje” në rajonin përkatës për të cilin është kompetent. Pas lejitimit të të njejtit nga menaxhuesi i projektit, koordinatori lokal përgadit orarin e ekipeve të përbëra nga dy vëzhgues për lëndët dhe të njejtit i informon për gjykimet të cilat duhet të mbikqyren nga ekipet ekzistuese prej dy vëzhguesish, kurse pyetësorët i dorëzon çdonjëri prej tyre ndaras.

Selektimi lëndëve përkatësisht marrja e të dhënave për ta, në fazat e ndryshme të projektit dhe në rajone të ndryshme, zhvillohet në mënyra të ndryshme:

- sipas parimit të zgjedhjes së rastësishme nga ana e vëzhguesve – karakteristike vetëm në muajin korrik 2003, kur bashkëpunimi me administratën gjyqësore zhvillohej në nivelin fillestar
- nëpërmjet marrjes së listës së lëndëve të porositura nga ana e administratës gjyqësore
- nëpërmjet të dhënave nga kryetarët e gjykatave
- nëpërmjet marrjes së të dhënave për lëndë nga gjykatësit-kontaktit të drejtpërdrejt me ta
- nëpërmjet zgjedhjes së lëndëve nga ana e koordinatorit lokal në sekretarinë gjyqësore në bashkëpunim me administratën

² Vërejtjet që u theksuan në tryezën e rumbullakët lidhur me konkluzionet dhe rekomandimet e Koalicionit janë të përfshira në tekstin e Raportit Përfundimtar, kurse konkluzionet nga tryeza e rumbullakët janë dhënë si shtojcë e raportit.

- mjaft rallë, nëpërmjet marrjes së të dhënave nga palët, nëse lënda e tyre përkon me temat me interes për Koalicionin

Vëzhguesit pas mbikqyrjes së bërë në bazë të të dhënave për lëndën, të mara nga seanca gjyqësore, si dhe në bazë të të dhënave të mara nga koordinatori lokal, bëjnë plotësimin e pyetësorit për vëzhgimin e lëndëve civile ose penale, varësisht nga natyra e procedurës të cilën e kanë ndjekur. I njejtë, i nënshkruar i dërgohet koordinatorit lokal i cili origjinalin e mban për evidencë personale, ndërsa kopjen ia dërgon Zyrës Nacionale të Koalicionit.

Të gjitha të dhënat për lëndët e vëzhguara futen në një bazë të dhënash posaçërisht të përgatitur, në pajtim me pyetësorët për vëzhguesit, e cila mundëson rregullimin dhe sistematizimin e mëtejshëm të të dhënave.

Ekspertët juridik lokal në bazën mujore përgatisin raporte në bazë të analizave të bëra në pyetësorët e rajonit të cilin e mbulojnë dhe në bazë të informatave të mara nëpërmjet komunikimit me vëzhguesit. Këto raporte paraqesin pjesë përbërëse të raporteve mujore të cilat i përgatisin koordinatorët lokal për nevojat e Koalicionit.


Të gjithë aktorët e involvuar në procesin e lëndëve të mbikqyrura civile dhe penale janë të obliguar ta respektojnë parimin e sekretit të të dhënave të cilat merren gjatë realizimit të obligimeve.

Në pajtim me “Rregulloren për sjelljen e vëzhguesve”, mosrespektimi i këtij parimi sjell deri në përjashtimin nga monitoringu i Koalicionit.

Korniza kohore


Në periudhën prej Korrik të vitit 2003 deri në korrik të vitit 2004 janë vëzhguar gjithsej 643 lëndë, në 1010 seanca të sferës penale dhe 720 seanca të asaj civile.

Lëndë Penale



Pasqyrë e numrit të seancave të vëzhguara në sferën penale sipas muajve në gjykatat themelore në R. e Maqedonisë

Lëndë civile



Pasqyrë e numrit të seancave të vëzhguara në sferën civile sipas muajve në gjykatat themelore në R e Maqedonisë

Temat

Si tema me interes të veçantë për Koalicionin në lëminë penale janë zgjedhur:

- **Tregëtia me njerëz, dhuna familjare**
- **Fëmij dhe të rinj**
- **Korupcioni, Pronësia dhe e drejta e punës**
- **Shkelja e të drejtave të njeriut dhe shpërdorime nga ana e policisë**

Objekt interesimi për vëzhgim nga lënda civile janë:

- Lëndët nga e drejta familjare (konteste bashkëshortore, konteste atësie dhe mëmësie, konteste për kujdesin ndaj fëmijëve dhe bashkëshortit, ruajtja dhe edukimi i fëmijëve dhe kontestet për zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore të bashkëshortëve)
- Lëndët nga e drejta civile (kontestet pronësore, kontestet lidhur me të drejtën e karakterit zyrtar dhe të qeverisurit, kontestet për kompenzimin e dëmit, kontestet në mes kredituesit dhe borxhliut, kontestet ekonomike)
- Konteste nga marrëdhënia e punës

KREU 2 Implementimi i standardeve ndërkombëtare për gjykime të drejta në Gjykatat e vendit

1. E drejta e barazisë para gjykatës dhe ligjeve

...Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe të gjithëve iu takon, pa asnjëfarë diskriminimi, mbrojtje e barabartë me ligj. (neni 7 nga Deklarata Univerzale për të drejtat e njeriut)

...Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe të gjithëve u takon, pa asnjëfarë diskriminimi, mbrojtje e barabartë para ligjit. Në këtë kontekst, Ligji duhet të ndalojë çdo lloj diskriminimi dhe t'u sigurojë të gjithë personave mbrojtje të barabartë dhe të sukseshme kundër çdo lloj diskriminimi, veçanërisht mbi baza racore, të ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, përcaktimit politik, prejardhjes nacionale apo sociale, gjendjes pronësore, lindjes apo çdo baze tjetër (neni 26 nga Pakti Ndërkombëtar për të drejta civile dhe politike)

Për realizimin e parimeve të lartpërmendura, në ligjet për procedura gjyqësore janë paraparë norma përmes të cilave mund të sigurohet realizimi i tyre.

Qytetarët para Kushtetutës dhe Ligjeve janë të barabartë (neni 9, paragrafi 2 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë). Kjo normë e Kushtetutës është konkretizuar në Ligjin për Gjykatat. Gjegjesisht, në nenin 7 nga Ligji për Gjykatat janë paraparë disa parime, si: çdokush ka të drejtë për qasje të barabartë para gjykatës gjatë mbrojtjes të së drejtave dhe interesave të që kanë mbështetje ligjore; çdokush ka të drejtë për gjykim ligjor, të paanshëm, të ndershëm dhe në afat të arsyeshëm; askujt nuk guxon t'i kufizohet qasja ndaj gjykatës për shkak të mungesës së mjeteve materiale. Parimet e lartpërmendura paraqesin standarde të parapara në dokumentet³ ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe paraqesin pjesë përbërëse të Ligjdhënësisë tonë.

Procedura Civile

E drejta për “gjykime të drejta” e paraparë në nenin 6 nga Konventa Evropiane për të drejta të njeriut parasheh më tepër akpte mes të cilave edhe e drejta për qasje ndaj gjykatës. Që të mundën qytetarët e Republikës së Maqedonisë të realizojnë barazinë e proklamuar me Kushtetutë, në Ligjin për Gjykatat, në nenin 7 janë paraparë disa parime, mes të cilave edhe parimi se, askujt nuk mund ti kufizohet qasja para Gjykatave për shkak të mungesës së mjeteve materiale. Pasiqë ofrimi i mbrojtjes në Gjykatë, sipas rregullës nuk është pa pagesë, pala e cila për shkak të gjendjes së saj të pavolitshme materiale nuk është në gjendje të mbulojë shpenzimet pa e goditur mirëmbajtjen e tij të domosdoshme, dhe të familjes së vet, mund të kërkojë të jetë i liruar nga pagesa e shpenzimeve të procedurës. Të liruarit nga pagesa e shpenzimeve për procedurën (cautio iudicatum solvi), përfshinë të

³ Kështu sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive elementare, garancioni për barazi përfshin më shumë apskete:

Të drejtën e barazisë para ligjit

Të drejtën e barazisë para gjykatave


Të drejtën e qasjes së barabartë nëpër gjykata

Të drejtën e trajtimit të barabartë para gjykatave

liruarit nga pagesa e taksave dhe të liruarit nga pagesa e avansit për shpenzimet e dëshmitarëve, Ekspertëve, për këqyrje dhe për shpallje gjyqësore. Të liruarit nga pagesa e shpenzimeve të procedurës mund të përmbajë edhe të liruarit nga pagesa e harxhimeve në lidhje me përfaqësimin dhe lirim nga pagesa e shpërblimit për personin e autorizuar. Duke pasur parasysh numrin e madh të personave të papunësuar në vendin tonë, medoemos të parashtrohet pyetja se në çfarë sasive përdoret nga palët e a.q. e drejtë e të varfërve.

Hulumtimi tregon se nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve, vetëm në 30 lëndë (8,3 %) është kërkuar të liruarit nga pagesa e taksava gjyqësore dhe harxhimeve tjera gjatë procedurës, kurse në 332 lëndë (91,7 %) asnjë nga palët nuk ka kërkuar të përdoret kjo e drejtë. Vallë kjo gjendje statistikore është reflektim real i gjendjes financiare të qytetarëve mbetet pyetje e hapur. Dyshimi se qytetarët nuk dinë për të drejtën të jenë të liruar nga pagesa e shpenzimeve dhe harxhimeve tjera gjyqësore në raste kur nuk kanë mundësi t'i paguajnë bie poshtë, sepse në numrin më të madh të lëndëve të vëzhguara, palët kanë qenë të përfaqësuar nga avokatë-persona të autorizuar me kualifikime (kjo përqindje është 87,2% për paditësin, kurse 88,6% për të paditurin)⁴.

Pasqyrë për kërkesat për t'u liruar nga pagesa e taksave gjyqësore



Prej 30 lëndëve në të cilat është kërkuar lirimi nga pagesa e taksave gjyqësore, gjykata ka sjellur vendim për të liruar në 13 lëndë (43,3%). Kjo përqindje na jep të drejtën të përfundojmë se kushtet e parapara për përdorimin e kësaj të drejte në Ligjin për Procedura ndërgjyqësuese janë realisht të parashtruara, dhe sipas nesh nuk duhet të ndryshohen⁵.

Në lidhje të drejtpërdrejtë me të drejtën për qasje para gjykatës është pagesa e tatimeve gjyqësore. Pasiqë palët ndërgjyqësuese shpesh herë nuk i kanë respektuar rregullat për pagesa të taksave gjyqësore, gjegjësisht palët nuk i paguanin në kohë taksat gjyqësore, andaj shteti ishte i detyruar të ndërmerr masa për pagesë të obligueshme të tyre.


Me sjelljen e LPN u parapara një dispozitë sipas të cilës gjykata nuk do të veprojë sipas paditjes, e as do të ndërmarrë veprim tjetër për të cilën nuk është paguar taksa gjyqësore (neni 141 paragrafi 2 nga LPN).

Para Gjykatës themelore në Dibër mbahet procedurë për kompenzim të dëmit rreth kontestit në punë, ku seanca shtyhet dy herë për shkak të taksave gjyqësore të papaguara.

⁴ Shiko Pikën 9 të Kreut 2

⁵ Në tryezën e rumbullakët të organizuar nga Koalicioni “Të gjithë për gjykime të drejta” dhe Sektori për mbizotërimin e drejtësisë pranë Misionit të OSBE-së në Shkup me qëllim të prezentimit të konkluzioneve dhe rekomandimeve nga raporti përfundimtar i Koalicionit (në tekstin e mëtejshëm Tryeza e rumbullakët), si vërejtje është theksuar se çështja e lirit nga pagesa e taksave gjyqësore mund të zgjidhet edhe përmes krijimit të një Fondi të veçantë nga shteti, nga i cili do të merreshin mjete për pagimin e taksave gjyqësore poqese qytetarët nuk kanë mjete që ti paguajnë e në lidhje me të drejtën për shfrytëzimin e ndihmës gjyqësore nga avokati.

Pasqyrë për pagesën e taksave gjyqësore



Nga 720 lëndë të cilat janë vëzhguar, në 466 lëndë apo 64,7 % taksat gjyqësore janë paguar me kohë, në 208 lëndë apo 28,9% palët nuk kanë paguar taksat gjyqësore, përderisa 6,4% nga numri i përgjithshëm i lëndëve nuk ka të dhëna.

Nga e lartpërmendura mund të konkludohet se në numrin më të madh të

rasteve, palët në kohë i paguajnë taksat gjyqësore (duke e pasë të ditur se në rast se nuk paguhen taksat gjykata nuk do ta shqyrtojë lëndën).

Me rëndësi është të përmendet se mospagesa e taksave gjyqësore (28,9 %) nuk është pasojë e mospasjes së mjeteve për pagesë. Këtë e vërteton fakti se palët, që nga pranimi i procedurës gjyqësore për të cilën parashihet pagesa e taksës gjyqësore, kanë mundësi të kërkojnë të lirohen nga pagesa, kurse palët këtë nuk e kanë kërkuar. **Më së shpeshti, akuzuesi është ai i cili i paguan, respektivisht i avanson taksat gjyqësore, sepse rreth padisë zhvillohet procedura, andaj nuk do të veprojë në lidhje me padinë deri atëherë kur paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore, apo e njejta nuk paguhet me detyrim.** Përqindja 64,7% , taksat të paguara në afatin e duhur, tregon se ky përcaktim është zgjidhje e mirë për të disiplinuar palët t'i kryejnë pagesat, kurse me këtë nuk vëhet në pyetje e drejta e palëve për qasje ndaj Gjykatës.⁶

Mirëpo, nga pyetjet që kemi marrë prej pyetësorëve, mund të vihet re se ka raste kur gjykimet mbahen edhe krahas faktit se taksat nuk janë paguara.⁷

Para Gjykatës Themelore në Gostivar mbahet procedurë për borxh të pa paguar, ku gjykatësi e ka vënë në proces lëndën, kurse taksat nuk janë paguar. Para gjykatës së njejtë mbahet procedurë për dëmshpërblim, ku akuzat hyrë në shqyrtim edhe pse taksat nuk janë paguar.

⁶ Në këtë kuptim ekziston edhe një vendim i Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut. Kështu në rastin Kruz kundë Polonisë që zhvillohej në Gjykatën Evropiane për të drejtat e njeriut, aplikuesi ka pohuar se i është shkelur e drejta e qasjes para gjykatës ngase ai është dashur patjetër të heq dorë nga e drejta e tij që ti kërkojë në Gjykatë sepse nuk ka pasur mundësi ti pagujë taksat gjyqësore që i ka kërkuar Ligji i Polonisë. Me këtë ai konsideron se shteti ka shkelur nenin 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Shteti, ndërkaq, ka konsideruar se caktimi i taksave gjyqësore si formë e detyruar e përkufizimit legjitim të qasjes në gjykatë dhe se kjo nuk mund të llogaritet si shkelje e nenin 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Gjykata ka vendosur që e drejta e qasjes në gjykatë nuk është absolute dhe kjo mund të përkufizohet në mënyrë legjitime sepse edhe për nga natyra e vet, kjo duhet rregulluar nga ana e shtetit. Kështu Gjykata konsideron se kërkesa për pagimin e taksave gjyqësore nuk mund të llogaritet si përkufizim i qasjes në Gjykatë dhe në përputhje me këtë nuk mund të konsiderohet se e shkel neni 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut.

⁷ Në tryezën e rrumbullakët u theksua se, edhe pse nga njëra anë neni 141 paragrafi 2 nga Ligji për Procedurë Ndërgjyqësuese parasheh që gjykata të mos veprojë sipas padisë, apo të ndërmer ndonjë veprim tjetër për të cilin nuk janë paguar taksat gjyqësore, nga ana tjetër, sipas zgjidhjeve të tanishme të Ligjit për Taksa Gjyqësore nuk guxon të refuzojë punën me lëndë për të cilën nuk janë paguar taksat gjyqësore. Me këtë, këto dy zgjidhje gjenden në kolizion.

Rekomandim:

Të gjitha gjykatat duhet të zbatojnë në mënyrë përkatëse parimin e LPN për pagesën e taksave gjyqësore, me çka qytetarët do të vehen në gjendje të barabartë, gjë që edhe ligji e parasheh. Duhet bërë me dije këtë fakt gjykatave që nuk e zbatojnë këtë parim në mënyrë përkatëse.

2. E drejta për gjykim para gjykatës kompetente, të pavarur e të paanshme dhe të themeluar me ligj

E drejta për gjykim para gjykatës kompetente, të pavarur e të paanshme dhe të themeluar me ligj është garancion i përmbajtur në nenin 6 (1) nga Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut dhe në nenin 10 nga Deklarata Univerzale e KB-së, që paraqet një nga parakushtet kryesore për gjykime të drejta.

Kompetenca e gjykatës është kompleks i kualifikimeve të cilat kanë të bëjnë me relacionin e gjykatësit ndaj punës, kurse në thelb qëndron kujdesi për kompetencën mbi lëndën, pavarësi dhe paanësi gjatë vendimeve.

Kushtetuta dhe Ligji për gjykatat përmbajnë norma juridike që garantojnë parimin kushtetues për pavarësi dhe mëvetësi të gjykatave. Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, neni 98, pushtetin gjyqësor e zbatojnë gjykatat, kurse kompetencat, llojet, themelimin, ndërprerjen, organizimin dhe përbërjen e gjykatave, si dhe qasjen ndaj tyre e rregullon ligji. Sipas kësaj, kompetencën për të gjykuar, gjykatësi e merr sipas Ligjit për Gjykatat. Në Ligjin për gjykatat, posaçërisht e paraparë është që gjykatat të jenë organe shtetërore të pavarura dhe të mëvetësishme të cilat gjykojnë në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën, sigurojnë zbatimin e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Edhe krahas faktit se parimi për ndarjen e qeverisjes në mënyrë formale pranohet, kurse tekstet ligjore japin garanca të përgjithshme për pavarësinë e gjykatave, në praktikë këto garancione mbeten pa rëndësi të veçantë, për shkak të mangësive të mekanizmave për realizimin e tyre. Normat juridike relativisht mirë të përpunuara me të vërtetë në aspektin formalo juridik respektohen, mirëpo ka hapësirë të mjaftueshme për ndikim nga jashtë. Gjyqësia si tërësi, ende pjesërisht trajtohet si pjesë e Administratës shtetërore. Kontrolli financiar dhe formimi i të ardhurave të gjykatave dhe buxheti i tyre është i përqëndruar tek organet ekzekutive, në radhë të parë tek ministritë e resorit. Prej këtij, projekti për buxhet të veçantë gjyqësor paraqet hap të rëndësishëm për pavarësi thelbësore të gjyqësisë.

Rekomandim:


Çështja e pavarësisë së gjyqësisë në Republikën e Maqedonisë është materie komplekse dhe ka nevojë për qasje më të ndërlikuar gjatë Strategjisë për reforma të gjyqësisë me vendosjen e kahjeve të qarta në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, e pastaj edhe në të gjitha ligjet tjera me të cilat zgjidhet puna, gjendja, funksionimi dhe organizimi i gjyqësisë.

Procedura Penale

Komponentë e rëndësishme e kompetencës së gjykatës dhe përbërjes së tij të bazuar në ligj është mënyra e përbërjes së gjykatës në varësi nga rëndësia e lëndës.

Në pajtim me nenin 22 nga LPP, në procedurën penale të shkallës së parë, për vepra penale për të cilat parashihet dënim me të holla apo dënim me burg deri më tre vjet, gjykon vetëm një gjykatës. Gjykatat gjykojnë në këshille të përbëra prej dy gjykatësve dhe tre gjykatësve porotë për vepra penale për të cilat me ligj është i paraparë dënim me burg me kohëzgjatje prej 15 vjetësh apo dënim me burg të përjetshëm, kurse gjykatat gjykojnë në këshill të përbërë prej një gjykatësi dhe dy gjykatësve porotë për vepra penale për të cilat me ligj parashihet dënim më i butë.

Pasqyrë për përbërjen e gjykatave



Nga gjykimet e vëzhguara, në 38,7 % ka gjykuar një gjykatës i vetëm, në 54,1 % këshill gjyqësor, kurse në 7,2 % këshill gjyqësor 2+3.

Analiza na tregon se gjiththeherë në përputhje me peshën e veprës penale dhe dënimin e paraparë gjykatat janë formuar në mënyrë ligjore dhe në këtë drejtim nuk janë vërejtur lëshime dhe dobësi. Parimi që gjykata të formohet në mënyrë të ligjshme është zbatuar me konsekuencë. Struktura e gjykatës e formuar në këtë mënyrë i

përgjigjet edhe llojit edhe natyrës së veprave penale.

Përbërja e këshilleve gjyqësore duhet të ruhet, që don të thotë se e tërë procedura duhet të realizohet para përbërjes së njejtë. Gjatë analizës së pyetësorëve mund të përfundohet se në raste të mungesës së ndonjë anëtarit të këshillit gjyqësor, procedura shtyhet për shkak të përbërjes jo të tërësishme, përveç në raste kur vjen deri tek ndryshimi i këshillit gjyqësor.

Në lëndën e vëzhguar në Gjykatën Themelore në Tetovë për veprë penale Grabitje, më 15.03.2004 seanca kryesore është shtyrë për shkak të mosprezencës së një gjykatësi porotë, kurse gjykata ka konstatuar se nuk është e arsyeshme të bëhet ndryshimi i këshillit, për këtë shkak gjykimi është shtyrë.

Më 24.09.2003 para Gjykatës Themelore në Tetovë është vëzhguar lëndë për veprë penale vrasje, ku gjykimi është shtyrë për shkak të mosprezencës së gjykatësi t të tretë porotë.

Në lëndën për veprë penale Ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit, e cila mbahet para Gjykatës Themelore në Tetovë, seanca është caktuar për datën 03.03.2004, është shtyrë për shkak të mosprezencës së gjykatësve porotë.

Ky parim është shkelur në një lëndë.

Në lëndë që mbahet në Gjykatën Themelore në Kumanovë, për vepër penale vrasje, lëndë për të cilën është caktuar këshill me përbërje 2+3, në seancën e vëzhguar Kryetari ka mbajtur gjykimin një orë në mosprezencën e gjykatësit tjetër, me praninë e vetëm tre gjykatësve porotë.

Si garancë për gjykim të paanësishëm, LVP parasheh mundësi që të kërkohet përjashtim të gjykatësit apo gjykatësit porotë.

Përjashtimi mund të kërkohet në pajtim me ligjin, por edhe me kërkesën e palëve. Palët medoemos të parashrojnë kërkesë për përjashtim deri në fillimin e seancës kryesore, dhe nëse arsyen për përjashtim e kanë kuptuar më vonë, kërkesën e parashtrojnë menjëherë pas kuptimit (neni 38 paragrafi 2 nga LVP).

Me qëllim që kërkesat për paanësim të gjykatësit të plotësohen në mënyrë më adekuate, në pajtim me praktikën e organeve në Strazbur, LVP (1997) parasheh përjashtim edhe për gjykatësin që ka marrë pjesë gjatë shqyrtimit të akuzës para seancës kryesore (neni 36 q.4). Disa gjykata më të vogla ankohen se kjo u shkakton probleme për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gjykatësve.

Përjashtimi i gjykatësit për shkak të rrethanave që shkaktojnë dyshim për anësimin e tij nuk është zgjidhje jo parimore (neni 36 q.6), sepse mund të parashtrohet vetëm deri në fillimin e shqyrtimit kryesor, që ska logjikë, sepse indikacionet për anësim në atë moment dalin në pah. Propozimet më të reja për ndryshime të LVP këtë çështje e përmirësojnë në një masë, por nuk i plotësojnë kërkesat e Konventës, pasi që kërkohet që për anësimin të vehen dëshmi! Kjo, patjetër është larg "doktrinës së indikacioneve" të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.

Gjegjësisht, edhe pse paanësia, normalisht do të thotë mosekzistimi i anësisë, paragjykimëve, joobjektivitetit, prejudikimit, ekzistimi apo mosekzistimi i saj, sipas gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, mund të testohet në mënyra të ndryshme, Duhet bërë dallim mes qasjes subjektive, ku ka tendenca për të përcaktuar vendosshmërinë personale të një gjykatësi në momentin e caktuar (me çka paanësia subjektive supozohet deri atëherë kur nuk konstatohet e kundërta) dhe qasja objektive, ku konstatohet vallë ka garancione të mjaftueshme të përjashtohet çdo dyshim i bazuar, duke pasur parasysh se edhe indikacionet mund të kenë ndonjë rëndësi. Dmth, bëhet fjalë për besimin që në një shoqëri demokratike gjykatat duhet të mbjellin në opinion, dhe para së gjithash nëse bëhet fjalë për procedurë penale, ky besim duhet ushtruar tek i akuzuari. Prandaj, çdo gjykatës mbi të cilin ekziston arsye për dyshim të bazuar për anësim, duhet të tërhiqet.

Rekomandim :

Duhet të lejohet që kërkesa për përjashtim të mund të parashtrohet edhe pas fillimit të seancës kryesore, sepse nuk përjashtohet mundësia që rrethanat që shkaktojnë dyshim në paanësimin e gjykatësit apo gjykatësit porotë të dalin në pah gjatë procedurës. Por, duke pasur parasysh faktin se seanca kryesore është në zhvillim e sipër, në ligj duhet të parashihen afate të shkurta në të cilat duhet të vendoset sipas kërkesës për përjashtim.

Prej të dhënave të fituara gjatë vëzhgimit, në 20 lëndë është kërkuar përjashtimi i gjykatësit. Në 8 prej këtyre lëndëve është kërkuar edhe përjashtimi i gjykatësit porotë; në një lëndë është kërkuar përjashtimi i Kryetarit të gjykatës së Apelit pasi vendimin që e ka marrë, me të cilin refuzohet kërkesa e të akuzuarve për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Themelore, konsiderohet se është i pabazë dhe në një lëndë është kërkuar përjashtimi i Kryetarit të gjykatës themelore.⁸

Në përputhje me këto rezultate kërkesa për përjashtimin e gjykatësve dhe gjykatësve porotë nuk është bërë shpeshherë, që është një fakt pozitiv nga se kjo tregon se ky mjet si instrument për vlerësimin e dyshimit në anësinë e gjykatësit nuk ka ndodhur shpeshherë, e nga ana tjetër kjo ndikon që procedura të mos zhagitet.

Më 22.10.2003 është vëzhguar edhe një lëndë që zhvillohet në Gjykatën themelore në Tetovë për vepër penale fshehje tatimi sipas nenit 279, alineja 2 të KP, në të cilën nga të akuzuarit është kërkuar përjashtimi i tërë këshillit gjyqësor (trupit gjykues) dhe ai është përjashtuar. Gjykimi është shtyrë gjithsej 28 herë. Më 18.12.2003 është sjellë aktgjykimi.

Rekomandim:

Me qëllim që të pengohet keqpërdorimi i mundësisë që të kërkohet përjashtimi i gjykatësve vetëm për shkak të zhagitjes së procedurës, duhet të pengohet riparazitja e kërkesës për përjashtimin e gjykatësit të njëjtë për shkak të rrethanave të njëjta të paraqitura në kërkesën paraprake për përjashtim, e cila ka qenë e vlerësuar si e pa bazë.

Vlerësimi për sjelljen e paanshme të gjykatësit mbeti të nxirret nga përshtypja që vëzhguesit do ta fitojnë duke ndjekur një rast një kohë më të gjatë. Sipas vlerësimit të tyre, gjykatësi është sjellur me paanësi në procedurën, që do të thotë: se aktgjykimi është marrë në bazë të dëshmvive të marra në mënyrë të drejtë; gjykatësi ka vendosur në bazë të fakteve të konstatuara në mënyrë objektive, ka pasur një raport të njëjtë ndaj palëve dhe u është shmangur shtyrjeve të panevojshme të shqyrtimeve gjyqësore.

Gjatë realizimit të projektit nuk është vërejtur ndonjë rast i rezikimit të paanësisë së gjykatësve në zbatimin konkret të normave juridike përmes përzierjes në punën e gjykatësit, paraqitjes së interesit për ndonjë rast të caktuar, ushtrimin të ndikimit ose presionit, dhënies së sygjerimeve për kahjen e cila do të duhej të merrej gjatë vendosjes ose gjatë veprimeve të ngjashme.

Rekomandim:

Paanësia duhet të ndiqet vazhdimisht nëpërmjet institutit për përjashtimin e gjykatësve dhe gjykatësve porotë, mënyrës së shpërndarjes së lëndëve mes gjykatësve dhe sa më herët duhet të punohet rreth sjelljes së Ligjit të veçantë për organizimin e gjyqësisë i cili duhet ta plotësojë Ligjin për Gjykatat.

⁸ Me propozimin për ndryshim dhe plotësim të LPP, për kryetarin e gjykatës nuk mund të parashtrohet kërkesë për shkarkim, përveç në raste kur ai vepron si gjykatës, kurse për shkarkimin e tij vendos Kryetari i Gjykatës më të lartë të radhës.


Procedura civile

Sipas Ligjit për procedurë ndërgjyqësore (në tekstin e mëtejshëm LPN) gjykatat gjykojnë nëpërmjet këshillave, kurse Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë edhe me seanca të përgjithshme (neni 35 paragrafi 1 nga LPN). Rastet në të cilat gjykon një gjykatës individ janë të përcaktuara me LPN (neni 35 paragrafi 2 i LPN). Në nivelin e parë kontestet i gjykon këshilli ose një gjykatës individ. Kur gjykon në shkallën e parë, këshilli përbëhet prej një gjykatësi i cili është edhe kryetar i këshillit dhe 2 gjykatës porotë (neni 36 nga LPN). Gjykaqtësi individ gjykon konteste për kërkesa pronësore-juridike kur vlera e lëndës së kontestit nuk tejkalon 300.000 denarë (neni 37 paragrafi nga LPN) kurse në kontestet ekonomike 600.000 denarë (neni 466 nga LPN). Në LPN parashihen edhe raste të tjera kur gjykon një gjykatës individ.

Gjatë procedurës palët mund të arrijnë marrëveshje që kontestet pronësore juridike t'i gjykojë një gjykatës individ, pa marrë parasysh vlerën e kontestit (neni 37 paragrafi 2 nga LPN).

Në lëndën e cila zhvillohet në Gjykatën themelore Vinicë, vlera e kontestit është 700.000 denarë, për ç'arsye lënda do të duhej të zgjidhet në këshillë, mirëpo pala ka dhënë deklaratë në procesverbal se pajtohet që gjykimin ta vazhdojë një gjykatës individ..

Pasqyrë për përbërjen e gjykatës



Sipas analizës së pyetësorëve, në 51,7% ka gjykuar gjykatës individ, përderisa në 48,3% ka gjykuar këshill gjyqësor. Kjo tregon se në kontestet civile në mënyrë të barabartë kanë gjykuar gjykatës individ dhe këshille gjyqësore.

Megjithatë, nëse merren parasysh të dhënat për vlerën e kontesteve (shiko tabelën 1) të cilat janë vëzhguar mund të konkludohet se palët nuk e kanë përdorur, apo shumë rrallë e kanë përdorur mundësinë që t'iu gjykojë gjykatës individ në kontestet pronësore edhe në rastet kur për gjykim është kompetent këshilli gjyqësor.

Tabela 1. Vlera e lëndës së kontestit

Vlera	Numri i lëndëve	përqindje
deri.000 den.	Në 35 lëndë	20.2%
30.001-100.000 den.	Në 206 lëndë	30.8%
100.001-500.000 den.	Në 62 lëndë	9.3%
500.001-1.000.000 den.	Në 11 lëndë	1.6%
1.000.001-10.000.000 den.	Në 24 lëndë	3.6%
50.000.001-100.000.000	Në 2 lëndë	0.3%

100.000.001-1.000.000.000	Në 4 lëndë	0.6%
mbi 1.000.000.000	Në 1 lëndë	0.1%
e papërcaktuar	Në 224 lëndë	33.5%

Parimi i pjesëmarrjes së gjykatësve-porotë si postulat universal zbatohet që nga revolucioni borgjez francez, që sot të marrë karakterin e parimit kushtetues (neni 103 i Kushtetutës së RM). Vetë pjesëmarrja e gjykatësve porotë në procedurën gjyqësore, sqarohet si pjesëmarrje e “elementit laik” në gjykimin me të cilin do të ishte shmangur krijimi i “gjyqësisë profesionale”.⁹

Analiza e përgjigjeve të mara nga hulumtimi tregon se në një numër të caktuar të rasteve, sjellja e porotëve është tepër indiferente kurse pjesëmarrja e tyre gjatë kohës së shqyrtimit është sjellur në minimum.

Rekomandim:

Në përputhje me rezultatet e analizës, duhet të ndryshohen dispozitat e LPN-së për vlerën e lëndës së kontestit për gjykim nga gjykatësi individ dhe të rritet vlera e lëndës së kontestit për gjykim nga gjykatësi-individ (edhe për kontestet e kërkesave pronësore juridike në procedurë të rregullt edhe për kontestet ekonomike).

Ndërkaq, nga të dhënat e lartpërmendura mund të nxjerret përfundim se gjykatat janë formuar në mënyrë të rregullt.

Në pajtim me parimin e drejtpërdrejtshmërisë në procedurën civile, ekziston pamundësia për ndryshimin e përbërjes së gjykatave, respektivisht nuk ekziston mundësia që procedura të zhvillohet në një përbërje kurse vendimin ta sjellë ndonjë përbërje tjetër. Nëse ndodh ndryshimi i përbërjes së gjykatës për çfarëdo arsye në atë rast procedura duhet të fillojë rishtazi, ashtu që mund të merret vendim, nëse palët pajtohen që dëshmitë të mos jepen përsëri, që të lexohen procesverbalet nga deklaratat e dhëna më herët.

Të dhënat nga gjykimet e vëzhguara parimisht tregojnë se është respektuar ky parim, dhe nëse ka ndodhur ndryshimi i përbërjes së gjykatës, procedura ka filluar rishtazi.

Në lëndën e cila zhvillohet në Gjykatën themelore në Gostivar sipas bazës juridike anulim i vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies në punë, ndodh ndryshimi i përbërjes së gjykatës me çka procedura ka filluar rishtazi.

Në Gjykatën themelore në Veles zhvillohet lëndë për kontest pune, në të cilën ka ndodhur ndryshim në këshillin e gjykatës. Procedura ka filluar rishtazi.

Përbërja e gjykatës varet edhe nga vlera e lëndës së kontestit. Nëse merren parasysh të dhënat e paraqitura për vlerën e lëndës së kontestit (shiko tabelën 1), befason numri i lëndëve në të cilat vlera e lëndës së kontestit është e papërcaktuar, nga 720 lëndë të vëzhguara, 224 janë lëndë me vlera të papërcaktuara, ose 33,5%. Fakti se 224 lëndë nuk

⁹ Në disa nga ligjet që janë sjellë në kohën e fundit, siç është Ligji për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurë Ndërgjyqësuese të Republikës së Kroacisë (Narodne Novine nr.117/03), gati të gjitha lëndët në radhë të parë i gjykon gjykatës individ. Kështu sipas nenit 20 nga LPN i R.së Kroacisë “Në Procedurën ndërgjyqësuese në shkllën e parë, kontestet i gjykon gjykatës individ, nëse me ligj nuk është paraparë që ti gjykojë Këshill Gjyqësor. Në shkallën e dytë, Gjykatat gjykojnë me Këshill, nëse me ligj nuk është e paraparë në mënyrë tjetër. Pas revizionit, gjykatat vendosin në Këshill, nëse me ligj nuk parashihet ndryshe.

kanë vlerë të përcaktuar tregon se palët kanë tendencë që në momentin e parë t'i shmangen taksave gjyqësore, duke paguar një shumë të vogël paushale gjatë parashtrimit të ankesës, deri në momentin kur gjykata sipas detyrimit zyrtar, e përcakton vlerën e lëndës së kontestit e cila në ankesë është çmuar shumë ulët për t'iu shmangur pagesës së taksave gjyqësore të përcaktuara fillimisht me qëllim që gjykata të fillojë punën rreth lëndës¹⁰

Rekomandim:

Për përqindjen e lartë të lëndëve në të cilat vlera e lëndës së kontestit nuk është përcaktuar, duhet t'u bëhet me dije gjykatave që të zbatojnë me konsekuencë dhe në mënyrë përkatëse dispozitat ligjore, sepse kjo mund të shkaktojë keqpërdorime serioze gjatë pagesës së taksave gjyqësore.

Në kryerjen e funksionit të vet, gjykatësit janë të pavarur. Njëra prej garancioneve për pavarësinë e tyre është mandati i përhershëm i gjykatësit. Gjithashtu edhe imuniteti¹¹ i gjykatësit është garancë për pavarësinë e tyre. Përkundër kësaj, mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit të tyre (zgjedhjen dhe shkarkimin i bën Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me propozim të Këshillit gjyqësor republikan) mund të jetë kanosje për pavarësinë e gjykatësit në kryerjen e funksionit të tij.

Në analizën e përgjigjes në pyetësorët vërehen raste të cilat, nuk është e thënë të jetë patjetër ashtu, por megjithatë janë indicie për rrezikun nga sulmi politik ndaj pavarësisë së gjykatësve. Nuk janë të rralla shtyrjet e seancave të gjykimit për shkak të angazhimit të gjykatësve gjatë mbajtjes së zgjedhjeve.¹²

Rekomandim:

Që të evitohen të gjitha dyshimet e mundëshme për çfarëdo ndikimi ndaj pavarësisë së funksionit të gjykatësit do të duhet të ndërmerren masa dhe të shqyrtohet mundësia për ndryshimin e dispozitave që i rreglojnë procedurën dhe mënyrën e zgjedhjes dhe shkarkimit të gjykatësve.


Kërkesa për përjashtimin e gjykatësit përkatësisht gjykatësit porot është njëra prej çështjeve përmes të cilave fitohet një pasqyrë për besimin, përkatësisht mosbesimin e palëve ndaj gjykatës (këshillit gjyqësor përkatësisht gjykatësit individ). Qëllimi i kërkesës për përjashtimin e gjykatësit, përkatësisht gjykatësit-porot është që të eliminohet të gjitha dyshimet në anësinë e gjykatësit, përkatësisht që palëve tu gjykojë gjykatë e paanshme.

¹⁰ Në tryezën e rumbullakët që theksuar se ekziston një paragraf në Gjykatë Kushtetuese të vitit 1980, sipas të cilit, padinë, vlera e së cilës është e pacaktuar, Gjykata duhet t'ahedh poshtë si të pa arsyeshme.

¹¹ Gjykatësi (dhe gjykatësi porotë) nuk mund t'lemeret në përgjegjësi për mendimin dhe vendosjen gjatë marrjes së vendimeve gjyqësore; Gjykatësi nuk mund të paraburgoset pa lejen e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, përveç kur ka bërë vepër penale për të cilën është caktuar dënim me burg prej të paktën pesë vjet; procedura e vendosjes për imunitetin e gjykatësit është urgjente dhe zbatohet pas mendimit paraprak nga Këshilli Gjyqësor Republikan (neni 65 i LGJ)

¹² Në Gjykatën Themelore në Kavadarë gjatë Zgjedhjeve Presidenciale kanë qenë të angazhuar në zgjedhje edhe dy gjykatës të cilët gjykojnë lëndë penale.

Pasqyrë e kërkesave për shkarkim



përkatësisht në gjykatësin-individ i cili zhvillon gjykimin rreth lëndës. Pra, kërkesa për përjashtim nuk është shfrytëzuar shpesh që, sidoqoftë, është mirë.

Nëse ndodh që të kërkohet përjashtim gjatë procedurës ndërpritet puna rreth lëndës (neni 69 i LPN); përderisa Kryetari i gjykatës nuk vendos rreth kërkesës për përjashtim. Në LPN nuk janë përcaktuar afatet brenda të cilave Kryetari i gjykatës duhet të vendosë rreth kërkesës për përjashtim. ky mund të jetë faktor i cili mund të ndikojë në kohëzgjatjen e procedurës.

Rekomandim:

Përcaktimi i afateve në LPN, brenda të cilave Kryetari i gjykatës mund të vendosë rreth kërkesës për përjashtim, mund të ndikojë që procedura të mos zhagitet.

Të dhënat nga hulumtimi tregojnë se ky institut nuk është keqpërdorur. Të dhënat e fituara nga hulumtimi tregojnë se janë të pa baza pohimet se palët në lëndët civile me qëllim që ta zhagisin procedurën shpesh herë e përdorin përjashtimin edhe atëherë kur për këtë nuk kanë arsye me bazë.

Përveç palëve, kërkesë për përjashtimin e gjykatësit, gjatë procedurës mund të bëjë edhe vetë gjykatësi.

Shqyrtimi i vëzhguar më 29.09.2004 në Gjykatën themelore në Manastir, është shtyrë për kohë të pacaktuar që të mos ndodhë anësi nga gjykatësi sepse ai është në marrëdhënie të mira me paditësin. Ai e shtyn shqyrtimin për një kohë të pacaktuar ndërsa Kryetarit të gjykatës ia ka paraqitur vetë kërkesën për përjashtim..

3. Barazi armësh

Parimi i barazisë procedurale është një element kyç i konceptit për gjykim të drejtë. Edhe pse nuk haset në mënyrë të prerë në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, besohet se ai paraqet një parim të përgjithshëm juridik. Në Evropë, koncepti i cili qëndron prapa kësaj shprehjeje, shfaqet *si parim kundërthëniesh*. Ky është njëri prej parimeve themelore të procedurës penale por thelbësisht përkufizohet nga i ashtuquajtura parim hetimor (roli aktiv i gjykatës).

Problemi i sigurimit të barazisë ndërmjet palëve në sistemin tonë është i një natyre tjetër, që është plotësisht e kuptueshme, ngase sistemi i përzier me rol aktiv i gjykatës, sipas karakterit të vet na inklinon kah parimi i barazisë ndërmjet palëve. Në të vërtetë, për përcaktimin e të vërtetës sipas detyrimit zyrtar është e ngarkuar, pik së pari, gjykata kurse palët, më pak ose më shumë, vetëm i ndihmojnë në këtë. Me këtë rast, njëri prej problemeve kryesore është fakti që gjykatësi është hollësisht i njoftuar me shkresat e organeve të ndjekjes, bile edhe me dëshmitë që formalisht nuk janë nxjerrë në gjykatë.

Në praktikë prokuroria dhe gjykata bashkëpunojnë shumë më ngusht se në sistemet akuzatore, thjesht për arsye se në thelb ata kanë hipoteza dhe interesa të afërta nisëse. Ndonëse nga pikëpamja teorike kjo nuk luan rol të rëndësishëm - sepse gjykata aktgjykimin e vet mund ta mbështesë vetëm në dëshmitë e paraqitura drejtpërdrejtë në shqyrtim gojor dhe kontradiktor – efekti i tërthortë nga njohja e dosjes nga procedura paraprake, mund të ketë ndikim të dëmshëm në pozitën e të akuzuarit. Ndërkaq, problemi me ekspertët është zgjidhur më ndryshe ashtu që ata i cakton gjykata dhe ata llogaritet si neutralë dhe objektivë. Sëkëndejmi, mbrojta ballafaqohet me vështirësi kur duhet të kontestohen konstatimet dhe mendimet e ekspertëve të këtyllë zyrtarë, të cilët gëzojnë një respekt të caktuar që shkon me vetë pozitën e tyre. Kjo siguron një pavarësi parimore të ekspertëve por mund të jetë një problem i madh për mbrojtjen atëherë kur ekspertizat në fakt janë në favor të akuzës. Pikërisht për këtë, ka rëndësi të madhe qëndrimi i Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, e cila vë në pah se atëherë akuzat mbështetë në konstatimet dhe mendimet e ekspertëve të këtyllë “neutral” gjyqësor, për qëllimet e nenit 6 të Konventës, ata trajtohen si “dëshmitarë kundër të akuzuarit”, që mbrojtjes ia jep të drejtën që t’i sigurohet prania dhe dëgjimi i ekspertëve në favor të saj. Është një pyetje më delikate se kush do t’i mbulojë shpenzimet për këta ekspertë. Sido që të jetë, ideja për caktimin e ekspertëve zyrtarë si persona të shkathtë nga ana e gjykatës, edhe më tutje llogaritet si e pranueshme përderisa garantohen standarse të larta sa i përket ekspertizës së tyre. Sdo që të jetë, mbrojtja duhet të ketë mundësi reale që ti kontestojë konstatimet dhe mendimet e ekspertëve të caktuar nga gjykata, që jo gjithëherë garantohet në procedurat tona gjyqësore.

Kohë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes është njëra prej të drejtave minimale për çdo të akuzuar nga paragrafi 2 i nenit 4 të LPN. Kohë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes i lehet të akuzuarit gjatë zgjatjes së tërë procedurës, por vemendje e veçantë i kushtohet përgatitjes për shqyrtimin kryesor (thirja të akuzuarit duhet t’i dorëzohet ashtu që prej dorëzimit të thirrjes deri në ditën e mbajtjes së shqyrtimit kryesor të mbetet një kohë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, e të paktën 8 ditë, përveç në rastet e procedurës së shkurtuar, për çka është caktuar një periudhë prej 3 ditësh). I akuzuari i cili thirrjen për shqyrtimin kryesor nuk e ka pranuar në kohë, nuk është i obliguar të paraqitet

kurse mosshkuarja e tij nuk tërheq kurrfarë sanksionesh. Mëtuftje, për shkak të përgatitjes së mbrojtjes, gjykata mund ta ndërpresë shqyrtimin nëse akuzuesi gjatë shqyrtimit kryesor gojarisht ndryshon akuzën (neni 329 paragrafi 2 të LPP) apo parashtron akuzë për veprë penale të kryer ose zbuluar gjatë shqyrtimit kryesor (neni 330 paragrafi 2 të LPP)

Sipas analizës së pyetësorëve për atë se sa kohë ka kaluar nga marrja e thirrjes deri në seancën e parë të shqyrtimit kryesor, rezultatet janë prezantuar në Tabelën 2.

Tabela 2. Sa kohë ka kaluar prej pranimit të thirrjes deri në seancën e parë të shqyrtimit kryesor

Koha	Numri i lëndëve
3 ditë	Në 26 lëndë
8 ditë	Në 61 lëndë
15 ditë	Në 141 lëndë
Më tepër se 15 ditë	Në 148 lëndë
Nuk ka të dhëna	Në 267 lëndë

Mund të vërehet se në 26 raste kanë kaluar tre ditë, prej të cilëve në 12 lëndë nuk bëhet fjalë për vepra penale për të cilat parashihet procedurë e shkurtuar.

Nga ana tjetër, në 175 lëndë kjo periudhë zgjet 15 ditë, që objektivisht paraqet periudhë të gjatë dhe mund të shkaktojë zgjatje të panevojshme të procedurës.

Këqyrja e akteve. Në ligjin e vitit 1997, të drejtat e mbrojtjes janë forcuar me eliminimin e më tepër kufizimeve që kanë të bëjnë me këqyrjen e mbrojtjes së akteve dhe kontrollin e komunikimit mes mbrojtësit dhe të akuzuarit që gjendet në paraburgim. Në të vërtetë, në të dyja rastet është eliminuar kushtëzimi i të drejtave të mbrojtjes me ekzaminimin paraprak të të akuzuarit, kurse mbrojtësi ka të drejtën që *t'i shryrtojë shkresat dhe lëndët që shërbejnë si dëshmi* që nga momenti kur është dorëzuar kërkesa për zhvillimin e procedurës penale, si dhe kur gjykatësi i hetimit para marrjes së vendimit për fillimin e hetimit do t'i kryejë veprimet e nevojshme hetimore (neni 69 i LPP).

Ndërkaq, i akuzuari mund t'i analizojë aktet dhe lëndët që shërbejnë si dëshmi, atëherë kur ai do të merret në pyetje (neni 124, paragrafi 5 i LPP), që, gjithashtu, mund t'i nënshtrohet kritikës. Megjithatë, në rastet *Jespers dhe Kamasinski*, organet në Strazbur kanë vërejtur se qasja në aktet për këqyje të mbrojtësit të të akuzuarit i kënaq kërkesat e Konventës: Vetë i akuzuari nuk e gëzon të drejtën autonome që t'i analizojë aktet.

Në këtë mënyrë e drejta e këqyrjes së akteve në legjislativën e vendit i tejkalon kërkesat e vendosura në praktikën e organeve të Konventës, sepse ata nuk e njohin të drejtën e qasjes në aktet në fazën e hershme të procedurës. Kërkesat që të njihet një e drejtë e këtillë në fazat që i paraprijnë akuzës, Komisioni Evropian i hodhi poshtë në raste të shumta, duke u kënaqur me atë që i akuzuari e ka pasur të drejtën e këtillë pas ngritjes së aktakuzës.

Në të gjitha lëndët për të cilat ka të dhëna (30,1% nga gjithsej të vëzguarat), mbrojtja ka realizuar këqyrje në aktet e lëndës me çka kanë mundur të njihen me të gjitha dëshmitë dhe shkresat që kanë ekzistuar në lëndë.

Rregulla dhe zbulime të dëshmive. Për dallim nga këqyrja në aktet, duhet pranuar se tek ne nuk ekzistojnë standarde që do të mbështesnin rregullat e zbulimit nga ana e gjykatavedhe organeve të tjera shtetërore që arrin pjesë në procedurën dëshmuese, posaçërisht atyre në favor të mbrojtjes. Në pajtim me raportin e Komisionit në rastin *Jespers kundër Belgjikës*, organet e ndjekjes dhe autoritetet hetimore janë të obliguar që ta zbulojnë materijalin që e posedojnë, nëse është e mundur mbrojtjes t'i ndihmojë në kuptim të asaj që është theksuar më lartë.

Në nenin 166 nga LPP në të vërtetë parashihet se “nëse gjykatlsi hetuas para hetimit të kryer mendon se është në interes të mbrojtjes që i akuzuari dhe mbrojtësi i tij të njihen me dëshmitë e rëndësishme të grumbulluara gjatë hetimit, do ti njoftojë se në afatin e caktuar mund ti analizojnë lëndët dhe aktet që kanë të bëjnë me ato dëshmi”. Megjithatë, e drejta dhe praktika e vendit nuk njihin rregulla që do ta obligonin *Prokurorinë* që t'ia zbulojë mbrojtjes njohuritë, përkatësisht dëshmitë që i posedon në favor të saj, edhe pse nuk duhet të lehet anësh obligimi ' tyre për objektivitet (me vëmendje të njejtë t'i shqyrtojnë dhe përcaktojnë edhe faktet që e ngarkojnë të akuzuarin por edhe ata që janë në favor të tij nga neni 14, paragrafi 2 të LPP).

Gjatë analizës së pyetësorëve nuk është vërejtur shkurtimi i garancionit që supozon ekzistimin e mundësive të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes. Në përputhje me të dhënat që i disponojmë, vëzhguesit kanë vlerësuar se i akuzuari dhe mbrojtësi i tij kanë pasur mundësi të ndershme të paraqesin mbrojtjen e vet dhe ti kontestojnë konstatimet dhe dëshmitë e Prokurorisë.

Në të gjitha lëndët për të cilat ka të dhëna (29,5% nga gjithsej të vëzguarat) i akuzuari dhe mbrojtësi i tij kanë pasur mundësi që ti kontestojnë dëshmitë e akuzës dhe të propozojnë dëshmi në favor të vet.

E drejta e ekzaminimit të dëshmitarëve. Në përputhje me neni 6, paragrafi 3(g) të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, çdo person i akuzuar për vepër penale ka të drejtë që t'i dëgjojë ose të kërkojë dëgjimin e dëshmitarëve kundër tij dhe t'i sigurohet prani dhe marrje në pyetje e dëshmitarëve në favor të tij.

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut niset nga konstatimi se është thelbësore që mbrojtjes t'i jepet mundësia t'i kontestojë të gjitha dëshmitë që janë paraqitur në gjykatë dhe në të cilat ajo e mbështet aktgjykimin e vet. Në parim, të gjitha dëshmitë duhet të nxjerren në prani të të akuzuarit në shyrtrimin kryesor në gjykatë me mundësi për kundërshtim të argumenteve në shqyrtim kundërvënës. Përveç në rrethana të jashtzakonshme (që kërkojnë arsyetim të veçantë), dëshmitarët duhet të ndëgjojnë në prani të të akuzuarit në shqyrtimin kryesor, me çrast të dyja palët jo vetëm që do të mund ti paraqesin argumentet e veta por ky shyrtrim edhe për shkak të nënshtrimit të vetë kontrollit të opinjonit ofron garanci të qarta për një procedurë të drejtë. Sido që të jetë, kjo megjithatë "nuk do të thotë se që të shfrytëzohen si dëshmi deklaratat e dëshmitarëve duhet gjithmonë ata të jepen në shqyrtimin publik në gjykatë. Përdorimi si dëshmi i deklaratave të marra në procedurën paraprake, vetëvetiu nuk llogaritet se është në kundërshtim me Konventën Evropiane.", "me kusht të respektohen të drejtat e mbrojtjes. Sipas rregullës, këto të drejta kërkojnë që të akuzuarit ti jepet rast adekuat dhe i duhur që ti kontestojë dhe t'i dëgjojë

dëshmitarët kundër tij, qoftë në kohën kur dëshmitari e ka dhënë deklaratën ose në ndonjë fazë të më vonshme të procedurës, poqese kjo dëshmi është vendimtare".

LPP, vërtetë, kërkon që të gjitha dëshmitë që kanë rëndësi për një vendosje të drejtë të nxirren në gjykatë (parimi i drejtpërdrejtshmërisë), dhe parasheh kushte nën të cilat proceverbale të dëshmitë e dëshmitarëve mund të lexohen. Siç duket, e tërë kjo është paraparë vetëm nga aspekti i rolit dhe detyrës së gjykatës në funksion të përcaktimit të së vërtetës e jo si garanci për të akuzuarin. Kjo bëhet e qartë veçanërisht kur të merret parasysh se kusht për të lejuar këta deklaratave nuk është ekzistimi i rastit adekuat dhe të nevojshëm që dëshmitari të dëgjohet nga mbrojtja. Lejimi i deklaratave të dhëna jashtë shqyrtimit kryesor shqyrtohet (në mënyrën karakteristike për sistemet kontinentale) vetëm nga aspekti i *parimit të drejtpërdrejtshmërisë*. Parimi e reflekton rëndësinë që i kushtohet përcaktimit të drejtpërdrejtë të fakteve dhe dëshmimeve nga gjykatësi. Llogaritet se është e rëndësishme që gjykata vetë në shqyrtimin kryesor ta dëgjojë dëshmitarin, që të mundet ta vëzhgojë sjelljen e tij dhe duke marrë parasysh qëndrimin dhe elemente të ngjashme psikike, të vlerësojë vërtetësinë e deklaratës së tij. Leximi i procesverbaleve nga procedura paraprake sipas rregullit, nuk është e lejueshme pikërisht nga aspekti që gjykata ta përcaktojë të vërtetën, e jo për arsye se mbrojtja nuk ka pasur rast që dëgjojë dëshmitarin.

Ngjashëm me procedurat tjera kontinentale, me LPP-në ndalohen vetëm leximi i deklaratave të dhëna në procedurën paraprake, pa u interpretuar me këtë rast, ndalimi i këtillë eksplisit, në mënyrën që do të përfshinte edhe deklaratat jashtë gjyqësore të transmetuara përmes dëshmimeve "nga dëgjimi".

Përveç moszbatimit ose zbatimit të gabueshëm të dispozitave të LPP-së, si bazë për marrjen e aktgjykimit me ankesë, neni 364, paragrafi 2 i LPP-së (shkelje relative e procedurës) parasheh edhe shkelje të së drejtës që mbrojtja në shqyrtimin kryesor, nëse ajo ka qenë ose ka mundur të jetë nën ndikimin e zbatimit ligjor dhe të drejtë të ligjit.

Propozimet për vendosjen e ekzaminimit të kryqëzuar të dëshmitarëve nuk gjetën vend në projektin e fundit të ligjit për procedurë penale dhe lehen për fazën e themeltë të reformave të së drejtës penale të vendit. Në të vërtetë, ndryshimi i mënyrës së nxjerrjes së dëshmimeve kërkon një rol tërësisht të ndryshëm nga të gjitha subjektet në procedura, që kërkon më tepër kohë dhe përgatitje të caktuara paraprake. Megjithatë, standardet e vendosura në jurisprudencën e Gjykatës në Strazbur doemos t'i arrijë edhe praktika gjyqësore e vendit. Kjo aq më tepër pse të drejtat elementare të mbrojtjes (ndër të cilat edhe e drejta që i akuzuari të jetë i pranishëm gjatë ekzaminimit të dëshmitarëve dhe të mundet t'u parashtrijë pyetje nga neni 4 i LPP) janë përfshirë si të drejta fundamentale në parimet elementare të procedurës penale. Përveç kësaj, parimi i drejtpërdrejtshmërisë është përforcuar me kërkesën që nëse vërtetimi i një fakti mbështetet në atë se është vërejtur ndonjë person, ai personalisht të merret në pyetje në shqyrtimin kryesor. Marrja në pyetje (përpos në rastet e theksuara në mënyrë eksplícite) nuk mund të zëvendësohet me leximin e procesverbalit nga deklaratat e dhëna më herët, e as me deklaratë me shkrim (neni 328).

Dëshmitarët në favor të mbrojtjes. Ky garancion të akuzuarit nuk i jep të drejtë të pakufizuar (absolute) që të thirrë dëshmitarë. Gjykatat nacionale lirisht mund të vendosin se vallë dëgjimi i dëshmitarëve të mbrojtjes do të mund të kontribonte për përcaktimin e të vërtetës, dhe në të kundërtën, të refuzojnë që t'i dëgjojnë përderisa respektohet Konventa, posaçërisht parimi i barazisë.

Në vend të së drejtës që të akuzuarit t'i sigurohet prani dhe ekzaminim e dëshmitarëve në favor të tij, si një prej të drejtave themelore personale dhe afirmative të garantuara me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut LPP-ja e re personit ët akuzuar për vepër penale ia garanton vetëm të drejtën që të jetë i pranishëm gjatë ekzaminimit të dëshmitarëve dhe të mund t'u shtrojë pyetje (neni 4 paragrafi 2). Sidoqëftë, nuk duhet haruar se në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, garancioni nga neni 6 paragrafi 3(g) të Konventës Evropiane është inkorporuar edhe në legjislativën e vendit. Përveç kësaj dispozita është mjaftë e qartë dhe e përshtatshme që të zbatohet drejtpërdrejt pa pasur nevojë që të rregullohet në mënyrë të veçantë me ligj.

Nga ana tjetër me qëllim që të përkufizohet autorizimi i gjërë i diskrecionit të gjykatës, në dispozitat që e rregullojnë procedurën e dëshmisë është numëruar në mënyrë ekspicite se kur mund të refuzohet propozimi i palëve për sigurimin e dëshmimeve në shqyrtimin kryesor. Kësht, propozimi mund të refuzohet nëse : 1). I përket mënyrës së grumbullimit të dëshmimeve, të ndaluar me ligj, të dëshmisë përdorimi i së cilës nuk është lejuar me ligj, ose të faktit që sipas ligjit nuk mund të dëshmohet (propozim i palejuar); 2). Fakti tanimë është përcaktuar ose është i parëndësishëm (propozim i parëndësishëm); 3). Ekzistojnë mënyra për të dyshuar se me dëshminë e propozuar, ndonjë fakt i rëndësishëm aspak nuk do të mund të përcaktohej ose kjo do të mund të bëhej me vështirësi të mëdha, përkatësisht, nëse ajo dëshmi në rrjedhën paraprake të procedurës nuk ka mundur të sigurohet dhe është e sigurtë se nuk do të mund të sigurohet në një afat të arsyeshëm (propozim i pavend), nëse është i paqartë, jo i plotë ose sipas rrjedhës së punës dhe veprimeve të deriatëhershme që i ka ndërmarrë propozuesi në procedurë, është e qartë se propozimi është drejtuar kah anulimi i dukshëm i procedurës. Një rregullativë e këtillë do të thotë se tani sipas rregullës të gjitha dëshmitë e propozuara duhet të miratohen, e si përjashtim janë parashikuar qartë rastet kur këshilli mund të refuzojë nxjerrjen e dëshmimeve të reja.

Në kuptim të jurispodencës së paraqitur më parë të Gjykatës Kushtetuese dhe Komisionit për të drejtat e njeriut, përveç obligimit së gjykatës që në aktgjykim të theksojë posaçërisht pse nuk i ka përfillur propozimet e caktuara të palëve (neni 348 paragrafi 7 i LPP), tani kërkohet që vendimi me të cilin refuzohet propozimi për nxjerrjen e dëshmimeve të reja të mund të arsyetohet (neni 314 paragrafi 8 i LPP). Vendimin, Këshilli mund ta ndryshojë ose ta revokojë në rrjedhën e mëvonshme të procedurës.

Në Gjykatës Themeore Shkup 1 është vëzhguar një lëndë penale për vepër penale Ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit. Avokati i të akuzuarit ka kërkuar përjashtimin e Kryetarit të Këshillit gjyqësor nga se ai ka refuzuar propozimin e mbrojtësit për nxjerrjen e dëshmimeve të reja sepse ka konsideruar se ata nuk janë relevante për procedurën.

Edhe qëndrimi i marrë nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë është se nuk shkilet e drejta e barazisë së mjeteve atë që nuk janë nxjerrë të gjitha dëshmitë e propozuara nga i akuzuari poqese nga dëshmitë e paraqitura padyshim është përcaktuar pozita faktike e aktorit të veprës (Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë AP nr.98/95 të 04.10.1995).

Rekomandim:

Sa u përket dëshmitarëve të mbrojtjes mund të propozohet miratimi i vendimit gjerman, sipas të cilit kur gjykata do të refuzojë të thirë ndonjë person, mbrojtja mundën vetë, drejtpërdrejtë të thirë dëshmitarë. Personi i thirur në këtë mënyrë të

drejtpërdrejtë është i obliguar të vijë në gjykatë, vetëm nëse merr kompensim për shpenzimet. Nëse në shqyrtimin kryesorë dëshmohet se dëgjimi i personit të thirrur drejtpërdrejtë ka qenë i dobishëm për nriçimin e rastit, shpenzimit mbulohet nga arka shtetërore.¹³

Prej të dhënave të grumbulluara empirike mund të konkludohet se 174 raste ose 27,1% të lëndëve të përgjithshme të vëzhguara, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij e kanë shfrytëzuar të drejtën që të propozojnë dëshmitarë në favor të vetë dhe kjo e drejtë e tyre është pranuar pa përjashtim.

Në gjithsej 169 raste ose 26,3 % mbrojtja ka propozuar nxjerrje të dëshmive të reja të cilat kanë qenë të pranuar kurse dëshmitë të nxjerra në Gjykatë.

4. E drejta për të qenë i pranishëm në gjykim

Gjykimi në mungesë është i padëshirueshëm nga aspekti i të drejtës për të qenë i pranishëm gjatë gjykimit si element i së drejtës për gjykim të drejtë, por tolerohet për arsye se shtyrja e gjykimit ndonjëherë mund të sjellë humbjen e dëshmive, zbehjen e kujtesës së rrethanave relevante, vjetërmin e mundësisë për ndjekje e të ngjashme.

Megjithatë, në përputhje me praktikën e vendosur me Konventur evropiane, mundësia për gjykim në mungesë nga neni 292 të LPP nuk do të paraqesë problem, veçanërisht për arsye se në këto raste parashihen garancitë e kërkuara, e pikë së parit sigurimi i mbrojtjes (neni 66 i LPP), si dhe parashikimi i mundësisë për përsëritjen e procedurës nëse i akuzuari dhe mbrojtësi i tij parashitjnë kërkesa në afat prej një viti nga dita kur i dënuari ka kuptuar për akuzën me të cilën është dënuar në mungesë (neni 398 i LPP).

Në Gjykatën themelore Shkup 1 në Shkup, është vëzhguar lëndë për veprë penale grabitje në përputhje me nenin 237 paragrafi 3 i KP, i cili zhvillohet me kërkesën për përsëritjen e procedurës. Në të vërtetë, paraprakisht është sjellur akuzë për veprën e njejtë në mungesë të njërit nga dy të akuzuarit. Kjo është përsëritje e procedurës vetëm për njërin prej të akuzuarëve.

Mundësia që i akuzuari përkohësisht të largohet nga shqyrtimi kryesor nëse e prish rendin në gjykatore (neni 287 i LPP) është përjashtim i cili lejohet edhe nga organet e Konventës.

Vëzhguesit kanë vërejtur një rast kur rendi në gjykatore është prishur nga të akuzuarit dhe në këtë rast gjykatësi ua ka tërhequr vërejtjen. Nuk është vërejtur rast që i akuzuari të përjashtohet nga gjykimi për shkak të prishjes së rendit në gjykatore.

Ngjashëm me këtë është edhe përjashtimi i të akuzuarit nga gjykimi në rastet kur ndonjëri prej të bashkëakuzuarëve apo dëshmitarëve refuzon të japë deklaratë në praninë e

¹³ Si vërejtje në tryezën e rumbullakët është theksuar se ky vendim do të mund të ishte edhe kundër produktiv sepse mund të shpiej në zhagitjen e panevojshme të procedurës.

tij ose nëse rrethanat vënë në pah se në praninë e tij nuk do të flasin të vërtetën, që gjithashtu, tolerohet me kusht që mbrojtësi të jetë i pranishëm kurse i akuzuari të jetë i njoftuar me përmbajtjen e deklaratave.

Nga aspekti i përputhjes me Konventën mund të jetë problematike mundësia për gjykim në mungesë të të akuzuarit në procedurën e shkurtuar nëse ai nuk vjen në shqyrtimin kryesor, edhe pse ka qenë i thirrur në mënyrë të rregullt, ose thirrja nuk ka mundur t'i dorëzohet për shkak të mosparaqitjes në gjykatë, ndërimit të adresës ose vendbanimit, me kusht që prania e tij të mos jetë e domosdoshme dhe para kësaj të ketë qenë i ekzaminuar (neni 428 i LPP).

Praktika e organeve në Strazbur kërkon që i akuzuari të informohet (thirret) paraprakisht për gjykimin, që do të thotë të jetë i informuar me kohë dhe në gjuhën që e kupton. Lidhur me këtë çështje, në ratin Kolloza dhe Rubinat kundër Italisë (Kolozza and Rubinat v. Italy, Series A, No. 89, 1985), Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut ka konstatuar se autoritetet nuk kanë bërë çka kanë mundur që të gjejnë adresën e tij të re dhe se gjykimi në mungesë është dënim joproporcional për lëshimin që të informohet për ndërimit të adresës.

Këto raste janë të rralla në praktikë, duke pasur parasysh se shumë rrallë ndodh që i akuzuari më parë të ketë qenë i ekzaminuar në procedurë të shkurtuar. Duhet të kemi parasysh edhe faktin se në këto raste nuk ekziston mundësia për përsëritjen e procedurës, e as që sigurohet mbrojtës sipas detyrimit zyrtar. Çdo i akuzuar ka të drejtë të jetë i pranishëm gjatë gjyqimit me qëllim që të dëgjojë akuzën dhe të prezentojë mbrojtjen e tij. Kjo nënkupton se gjykata është e obliguar ta informojë të akuzuarin për akuzën, ta thërrasë në shqyrtimin kryesor dhe të kërkojë prezencën e tij, si dhe mos ta përjashtojë qëllimisht të akuzuarin nga gjykimi.

Rekomandim:

Duhet përjashtuar mundësia e gjyqimit në mungesë në rastet kur thirrja nuk ka mundur të dorëzohet për shkak të mosparaqitjes së ndërimit të adresës në gjykatë.

Në përputhje me nenin 292 paragrafi 3 i LPP i akuzuari mund të gjykohet në mungesë vetëm nëse është në arati, ose në rastet tjera kur organet shtetërore nuk mund ta gjejnë, kurse ekzistojnë arsye jashtëzakonisht të rëndësishme që të gjykohet edhe pse nuk është i pranishëm.¹⁴

Prej lëndëve të vëzhguara, në 21 lëndë të akuzuarit janë gjykuar në mungesë. Nga këto lëndë, në 15 prej tyre për shkak të pamundësisë që të gjehet (me adresë të panjohur ose gjendet jashtë vendit), në 3 lëndë i akuzuari është gjykuar në mungesë pasi që ka qenë në arrati, kurse në 3 lëndët tjera për arsye të tjera.

Nga analiza e rasteve kur i akuzuari është gjykuar në mungesë, në 11 lëndë bëhet fjalë për vepra penale me më tepër bashkëkryes.

¹⁴ Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut ka konstatuar se poseqe i akuzuari e ka pranuar thirrjen dhe nuk është paraqitur në gjykim dhe nëse është i informuar për procedurën e cila zhvillohet kundër tij, nuk ekziston shkeje e të drejtës për gjykim të drejtë.

Rekomandim:

Në rastet kur ka më tepër bashkëkryes duhet sjellur vendim për ndarjen e procedurës, nëse gjykatësi këtë e vlerëson si të arsyeshme, në vend të sjelljes së vendimit për gjykim në mungesë.

Në përputhje me dispozitat e LPP në të gjitha lëndët kur i akuzuari është gjykuar në mungesë gjykata i ka caktuar mbrojtës sipas detyrimit zyrtar.

5. E drejta për gjykim publik

E drejta për gjykim publik¹⁵ është e drejtë e garantuar për çdo qyttarë me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë e njëherit e inkorporuar në Ligjin për procedurë penale dhe në Ligjin për procedurë ndërgjyqësore.

Vetë parimi i gjykimit publik realizohet në disa forma:

a) prania e opinionit në shqyrtimin kryesor/diskutimin kryesor

Prania e opinionit në shqyrtimin kryesor, respektivisht diskutimin kryesor, nënkupton praninë e të gjithë personave të interesuar, që të mundësohet prania e tyre e papenguar, orari i lëndëve duhet të shpallet dhe të publikohet në vend të dukshëm¹⁶.

Më 24.09.2003 për lëndën e cila zhvillohet në Gjykatën themelore Shkup 1 vëzhguesit kanë regjistruar: “Para gjykimit si dhe pas tij gjatë kohës që ishim të pranishëm në sallë nuk ishte vënë lista e lëndëve për të cilat ishte caktuar gjykim sot.

Më 04.12.03 për lëndën e cila zhvillohet në gjykatën themelore Shkup 1 vëzhguesit kanë regjistruar se në tabelën para gjykatës ku shpallet orari i gjykimeve, nuk ka qenë orari i gjykimeve për tërë ditën.

¹⁵ Në rastin Ahen kundër Republikës Federale të Gjermanisë, Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut thotë: “Karakter i publik i procedurës para trupave gjyqësore i theksuar në nenin 6(1) të Konventës i mbron palët nga ndarja sekrete e drejtësisë pa mbikqyrës nga opinioni; Kjo gjithashtu është një prej mjeteve me të cilat mund të fitohet besimi në gjykatat të instancave më të ulta dhe të atyre më të larta. Duke bërë ndarjen e drejtësisë në mënyrë të dukshme, opinioni kontribuon në arritjen e qëllimit të nenit 6(1), në të vërtetë gjykim të drejtë, garancion i cili është njëri prej parimeve themelore në një shoqëri demokratike, në përputhje me Konventën.”

¹⁶ Në përputhje me nenin 57 paragrafi 2 të Rregullores Gjyqësore, çdo ditë para fillimi të orarit të punës, në hyrje të lokaleve në të cilat zhvillohet gjykimi dhe në drasën e shpalljes shpallet lista e gjykimeve të caktuara për atë ditë, kurse lista e gjykmieeve të mbajtura hiqet.

Përqindja e shpalljes së orarit të gjykimeve



Në më shumë se gjysma e gjykatave themelore në Republikën e Maqedonisë orari i gjykimeve nuk ka qenë i vënë në vend të dukshëm.

Me ndryshimet e Ligjit për procedurë penale futet një nen i ri 123-a, në të cilin është caktuar se gjykata është e obliguar që çdo ditë pune të gjithë pjesëmarrësve në procedurë, në formë elektronike ose në tjetër mënyrë, tu mundësojë qasje në evidencën për shqyrtimet e caktuara. Për zbatimin e kësaj dispozite është i rëndësishëm edhe kompjutorizimi i gjyqësisë i cili do të sjellë gjyqësi më efikase.¹⁷

Rekomandim:

Që të mundësohet prania e opinionit të gjërë, gjykatat doemos, në mënyrë organizative ta zgjidhin problemin për atë se si informatat e ditës dhe terminet e gjykimeve të caktuara në kohë do t'i bëjnë të njohura për ata që do të tregojnë interesim.¹⁸

Gjykatat doemos të kompjutorizohen sa më shpejtë me çka do të mundësohet informimi në kohë për ditën dhe orën e gjykimit por edhe për stadiumin në të cilin ka arritur ndonjë lëndë e caktuar. Në këtë mënyrë do të lehtësohet komunikimi edhe me palët edhe me mbrojtësit dhe personat tjerë të interesuar.

Kushtet nën të cilat mund të përjashtohet opinionin tërësisht ose pjesërisht janë të parapara dhe të caktuara me ligj.

Në **procedurën penale**, këshilli gjyqësor mund të përjashtojë opinionin nga tërë shqyrtimi kryesor ose nga ndonjë pjesë e tij nëse është e nevojshme për shkak të ruajtjes së sekretit, ruajtjes së rendit publik, mbrojtjes së moralit, mbrojtjes së jetës personale dhe intime të të akuzuarit, dëshmitarit ose të dëmtuarit dhe për mbrojtjen e interesave të të miturit (neni 280).

Nga analiza e pyetësorëve, mund të konkludohet se në këtë aspekt parimi i pranisë së opinionit respektohet nga ana e gjykatave. Në të vërtetë, në procedurën penale vetëm në 5 lëndë ka përjashtim të pjesërishtëm ose të tërësishtëm të opinionit me vendim të gjykatës:

- në një lëndë penale ka pasur përjashtim të pjesërishtëm të opinionit sepse në gjykatë nuk ka pasur vende
- në një lëndë penale opinionin ka qenë i përjashtuar për shkak të mbrojtjes së jetës intime të të akuzuarit, dëshmitarit ose të dëmtuarit

¹⁷ Shiko Pikën 9 të Kreut 3

¹⁸ Në tryezën e rumbullakët u theksua shembulli i praktikës sllovene ku gjykatat çdo të premte deri në orën 14 duhet t'ia dorëzojnë Gjykatës Supreme orarin e gjykimeve për javën e ardhshme. Kështu çdonjëri mund të shoh se kur është caktuar ndonjë gjykim.

- në tre lëndë penale opinioni është përjashtur për shkak të mbrojtjes së interesave të të miturit.

Në një lëndë penale, e ndjekur në gjykatën themelore Shkup 1, në seancën e mbajtur më 27.02.04 ekziston përjashtim i pjesërishëm i opinionit sepse nuk ka pasur vend në gjykatore.

Në disa gjykata është vërejtur zhvillimi i gjykimeve në zyrat e gjykatësve në vend kjo të bëhet në gjykatore, me çka mund të shkelet parimi i pranisë së opinionit pasi që zyrat nuk japin mundësi për prani të të gjithë personave të interesuar.

Kjo është brengosëse veçanërisht nëse kemi parasysh se gjykatat themelore në Vinicë, Sveti Nikole, Strugë dhe Shtip numëri i lëndëve të vëzhguara të cilat janë zhvilluar në zyrat e gjykatësve është më i madh se numëri i gjykimeve në gjykatore.


Rekomandim :

Duke pasur parasysh natyrën e lëndëve penale duhet bërë përpjekje (bile edhe të insistohet) që gjykimet të mbahen në gjykatore, e jo në zyrat e gjykatësve ku nuk ka kushte për zhvillim normal të gjykimit, për prani të të gjithë personave të inetersuar, për zhvillimin e veprimeve procedurale si, dëgjimi i dëshmitarëve, ekspertëve etj.¹⁹

Në **procedurën civile**, opinioni mund të përjashtohet sipas ligjit, në kontestet e statusit (kontestet atësore, amësore dhe martesore) kurse gjykata mundet edhe me vendim ta përjashtojë opinionin nëse këtë e kërkojnë interesat e rendit publik ose për arsye morali dhe kur me masat për ruajtjen e rendit të parapara me LPN, nuk mund të sigurohet zhvillim i papenguar i diskutimit.

Por, edhe atëherë kur opinioni ka qenë i përjashtuar prej shqyrtimit kryesor, vendimi duhet të kumtohet publikisht, kurse për arsyet pse ka marrë vendim të tillë gjykata vendos se a do t'i shpallë ose jo. Edhe pse format përmes të cilave arrihet prania e opinionit mund të jenë të ndryshme, prap se prap në numërin më të madh të rasteve, prania e opinionit arrihet përmes diskutimit kryesor.

Përqindja e përjashtimit të opinionit nga diskutimi kryesor



Prej gjithsej 720 lëndëve të vëzhguara, në 696 lëndë ose 96,7% shqyrtimi kryesor ka qenë publik kurse vetëm në 24 lëndë ose 3,3 % opinioni në shqyrtimin kryesor ka qenë i përjashtuar. Numri kaq i vogël i lënëve (vetëm 24 prej 72) në të cilat opinioni ka qenë i përjashtuar është bërë për faktin që është shumë i vogël numri i lëndëve të vëzhguara në të cilat sipas ligjit opinioni është

¹⁹ Në tryezën e rumbullakët u theksua problemi i vendosjes hapësinore dhe numri i pamjaftueshëm i gjykatoreve për ç'arsye gjykatësit gjykimin e zhvillojnë nëpër zyra.

dashur të përjashtohet (gjithsej 42 prej të cilave 38 konteste martesore dhe dy konteste lidhur me kontestimin e ytërisë dhe dy për përcaktimin e atësisë). Mosharmonizimi i numrit të lëndëve në të cilën është dashur patjetër të përjashtohet opinjoni (42) në numrin e lëndëve në të cilën ka qenë i përjashtuar opinjoni (24) është rezultat i asaj që sipas LPN (neni 293 paragrafi 2) dhe në rastet kur opinjoni duhet të jetë i përjashtuar me forcën e ligjit, Këshilli mund të lejojë në shqyrtimin kryesor të marrin pjesë persona ë caktuar zyrtar, si dhe punëtorë shkencor dhe publik, nëse kjo është në interes për shërbimin e tyre përkatësisht për veprimtarinë shkencore dhe publike. Në këto konteste procedura, në raste të caktuara mund të përfundojë me seance përgaditore pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor. Në të 24 lëndët në të cilët ka qenë i përjashtuar opinjoni është fjala për procedura për shkurorezim të martesës²⁰. Sidoqoftë, të dhënat e marra nga hulumtimi tregojnë se parimi i opinjonit në shqyrtimin kryesor rrepsktohet me konsekuencë.

Shkelja e vetme e parimit të opinjonit ka ndodhur në rastet në të cilat vëzhguesve u është kufizuar prania në gjykim, përkatësisht janë penguar që të jenë të pranishëm.

Më 26.01.2004, gjatë orvajtjes që vëzhguesit të vëzhgojnë një lëndë civile e cila zhvillohet në Gjykatën Themelore Kumanovë, kjo u është pamundësuar nga gjykatësi me arsyetim se është dashur të kenë letër nga Gjykata Supreme e R.së Maqedonisë, nga Ministria e Drejtësisë dhe nga Kryetari i Gjykatës. Pas seancës së mbajtur, gjykatësi nuk i ka dorëzuar lëndët në sekretarinë e gjykatës.

Sa i përket opinjonit në procedurën gjyqësore, vëmendje të veçantë merrton prania e mediave në gjykime. Tendencat për senzacione të dukshme të mediat e shkruara e rezikojnë dukshëm procedurën e pafajësisë dhe kushteve për gjykim të drejtë. Është e domosdoshme që të ligjërisht të rregullohet cilat media dhe në cilat mjete të informimit publik mund t'i ndjekin gjykimet dhe çka mund të xhirojnë dhe transmetojnë. Lidhur me këtë çështje është e nevojshme të organizohet edhe edukim i gazetarëve që e ndjekin kronikën gjyqësore me qëllim që të mos ndodhin raste të shkeljes së drejtësisë, dinjitetit dhe nderit të palëve posaçërisht të të akuzuarve përkatësisht personave të dënuar.

b). Me dhënien e informatave për rrjedhën e procedurës personave të interesuar që e kërkojnë këtë.

Në pikëpamje të kërkesave që të marrin informata për rrjedhën e procedurës si dhe të dhëna plotësuese për lëndët e vëzhguara, vëzhguesit në parim hasin në një raport korekt nga ana e gjykatësve dhe në të shumtën e rasteve ata i marrin në tërësi informatat e nevojshme.


Megjithatë janë vërejtur situata të caktuara kur vëzhguesve nuk u janë dhënë informatat e nevojshme.

Më 28.11.03 në Gjykatën themelore Strumicë, për procedurën me bazë juridike kompenzim të dëmit, gjykata ka refuzuar që vëzhguesve t'u japë informata nga aktet e tyre.

Në Gjykatën Themelore në Shkup 1 gjatë vëzhgimit të një lënde penale për vepër penale Prodhim i paautorizuar dhe dhënie në qarkullim të drogave narkotike, substancave

²⁰ Përkundër asaj që në këto raste me forcën e ligjit ka qenë i përjashtuar opinjoni nga shqyrtimi kryesor – diskutimi kryesor, vëzhguesve u ishte lejuar që të marrin pjesë në gjykim.

Pasqyrë e kohës për të cilën është kumtuar aktgjykimi



psikotropike dhe prokurësorëve nga neni 215 i KP, vëzhguesit kanë vërejtur se gjykatësi ka pasur raport jo korrekt, nuk ka dashur kurrëfarë informatah me arsyetim se ka qenë tejet i ngarkuar me punë.

Nëse mirrft parasysht fakti se këta kanë qenë përjashtime, lirisht mund të përfundohet se këtë parim e respektojnë me konsekuencë.

c) shpallja e aktgjykimit

Një pjesë e rëndësishme e opinjonit në gjykim është shpallja e aktgjykimit.

Në **procedurën Penale**, në 160 lëndë të vëzhguara aktgjykimi është shqiptuar menjëherë, në 11 lëndë pas 3 ditësh, në 8 lëndë pas 8 ditësh, në 4 lëndë pas 15 ditësh, në një lëndë pas 30 ditësh dhe në një lëndë pas 90 ditësh.

Sa i përket shpalljes së aktgjykimit, afati i shpalljes së aktgjykimit është të paktën 3 ditë, kur është fjala për raste më të ndërlikuara, ndonëse është intruktiv, duhet pasur ndërmend. Është e palejueshme që për shpalljen e aktgjykimit të priten 30 ditë e madje edhe 90 ditë, siç ka pasur raste të regjistruara. Me këtë rast, kryetari i gjykatës duhet të kërkojë që gjykatësi të sqarojë arsyet për mosshpalljen e aktgjykimit në një afat kohor kaq të gjatë, kurse do të duhej të informohet edhe Këshilli Gjyqësor Republikan për profesionalizmin dhe cilësinë e punës së çdo gjykatësi. Kjo aq më tepër që i akuzuari pas përfundimit të seancës kryesore deri në shpalljen e aktgjykimit vazhdon të jetë në pozitë të pasigurt për fatin e vet, nuk ka në disponim asnjë mjet juridik për mbrojtjen e të drejtave të veta, është i pafuqishëm të ndër marrë çkadoqoftë, përveç që me parashtresë ta informojë Kryetarin e gjykatës.

Në **procedurën civile** sipas LPN, aktgjykimi sjellet menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe ai shpallet menjëherë, përveç në lëndët më të ndërlikuara kur gjykata mund ta shpallë menjëherë aktgjykimit për 15 ditë llogaritur nga dita e përfundimit të shqyrtimit kryesor. Në raste të tilla aktgjykimi nuk do të shpallet por palëve do t'u dorëzohet shkresë.

Nga lëndët e vëzhguara sipas të dhënave në 58 lëndë aktgjykimi është sjellë menjëherë pas mbylljes së diskutimit kryesor. Në 37 nga këto 58 lëndë, aktgjykimi u është shpallur menjëherë palëve.

6. E drejta e gjykimimit në afat të arsyeshëm

Me ratifikimin e Konventës Evropiane, Mqedonia merr obligim serioz që sistemin juridik ta organizojë në atë mënyrë që do të sigurojë gjykim në “afat të arsyeshëm”. Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut shpeshherë është orvatur ta kthejë vëmendjen në rëndësinë e jashtëzakonshme të kësaj kërkesë për një legjislativë. Zaten, një numër tejet i madh i aktgjykimeve të kësaj gjykate i përkasin pikërisht të drejtës së të akuzuarit në procedurë penale, për vendim përfundimtar në afat të arsyeshëm.

Procedura penale

Në procedurën penale garancia për gjykim në afat të arsyeshëm ka për qëllim që personi i akuzuar për vepër penale të mos vohet në situatë që një kohë shumë të gjatë në gjendje pasigurie për fatin e vet ose t'u nënshtrohet një varg privimesh lidhur me zhvillimin e procedurës penale kundër tij. Veprimi i shpejtë do të duhej t'ia mbrojë të drejtën e të akuzuarit për mbrojtje efikase, meqenëse kalimi i kohës mund të rezultojë me humbjen e dëshmive në favor të mbrojtjes, kurse objektiviteti i aktgjykimit, i sjellur për një kohë më të gjatë pas kryerjes së veprës, bëhet temë konraverzesh me çka gëryhet zvogëlohet besimi i opinjonit në legjislativën penale.

Periudha që është duke u shqyrtuar përfshin tërë procedurën penale. Praktika Evropiane zbaton një qasje fleksibile. Si relevant e mer stadiumin kur pozita e personit është dukshëm e ndjeshme, si pasojë e dyshimeve kundër tij. Parimin e njejtë të përgjithshëm që ka të bëjë me fillimin e periudhës relevante, organet në Strazbur e zbatojnë edhe në viset e veta. Në këtë kuptim periudha e shqyrtuar zgjet përderia pozita e personit nuk pushon të jetë e ndjeshme si rezultat i akuzës së ngritur kundër tij. Prandaj, periudha që shqyrtohet e mbulon tërë procedurën penale, përfshirë edhe procedurën rreth mjeteve juridike.

Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës nuk ekzaminohet in abstracto, por në dritën e rrethanave të veçanta të rastit. Nga ana tjetër kalimi i afateve për ndërmarjen e veprimeve të caktuara rreth proceseve të parapara me ligjet e vendit, nuk ka rëndësi më të madhe gjatë vlerësimit se a është plotësuar kërkesa nga neni 6(1) të Konventës Evropiane.

Në rastet penale merren parasysh posaçërisht: 1) Kompleksiviteti i rastit (Natyra dhe numri i aktakuzave) në tërësi (si çështje faktike ashtu edhe juridike), 2) Sjellja e të akuzuarit dhe 3) Mënyra se si është zhvilluar rasti nga autoritetet kompetente nacionale. Asnjë prej këtyre elementeve, me këtë rast, nuk është vetëvetiu vendimtar, por të gjithë konsiderohen si faktorë që do të mund ta sqaronin kohëzgjatjen e tepër të procedurës penale në rastin konkret. Në këtë kuptim, çdonjëri prej tyre ekzaminohet në mënyrë veçmas dhe vlerësohet kontributi i tyre për kohëzgjatjen e procedurës. Në fund, duke i përmbledhur të gjithë faktorët relevant bashkë, vlerësohet se vallë periudha e ekzaminuar mund të llogaritet si e arsyeshme. Gjykata për të drejtat e njeriut ka një mirëkuptim dhe tolerancë përderisa autoritetet nacionale merren me rastin por, posaçërisht në mënyrë negative shihet periudhat e gjata të joaktivitetit.

LPP vendor nuk e shtron problemin e punës ekspeditive si e drejtë e të akuzuarit, por si obligim ndaj subjekteve procesuese. Këtu, “gjykata është e detyruar që të bëjë përpjekje që procedura të zbatohet pa zhagjitje të gjatë dhe të pengohet çdo lloj keqpërdorimi të të drejtave që (u) takojnë personave që marrin pjesë në procedurë” (neni 14 i LPP). Formulimi i këtillë në njëfarë mënyre sikur e relativizon përgjegjësinë e gjykatës, duke i obliguar më shumë subjektet e tjera se sa vetë gjykatën. Obligimi kryesor i LPP-së ka të

bëjë me sferën e veprimt të lirë të gjykatës jashtë afateve të caktuara me norma të veçanta. Ai do të duhej ta shtynte gjykatën që të ketë një vetëdisiplinë gjatë udhëheqjes së procedurës pa digresione të panevojshme dhe disiplinimin e pjesëmarrësve të tjerë në përputhje me rregullat e procedurës. Shumë norma të tjera kanë për qëllim shpejtimin e procedurës (për shembull: procedura e shkurtuar, shkurtimi i së drejtës për përjashtim për shkak të dyshimit në anësinë e gjykatësit ose të gjykatësit porotë, në fillimin e shqyrtimit kryesor, mundësia që të Prokurori të disponojë me aktakuzën edhe në procedurën e shkallës së dytë, mundësia e shkurtimit të afatit në mes të dorëzimit të thirrjes dhe shqyrtimit kryesor me pëlqimin e të akuzuarit, pamundësia e ankesës kundër akuzës së ngritur në shqyrtimin kryesor etj.).


Duhet pasur parasysh edhe atë se kohëzgjatja e procedurave në masë të madhe varet nga organizimi dhe pajisja kadrovike dhe teknike e gjyqësisë.

Ligji i Procedurës Penale ka caktuar disa afate në të cilat duhen të ndërmeren veprimet e caktuara në procedurën penale.

Sa u përket fazave të caktuara të procedurës penale, në të cilat gjatë analizës së pyetësorëve të plotësuar është vërejtur një zhagitje e panevojshme e procedurës, së pari mund të bëhet analizë e **periudhës prej paraqitjes së akuzës deri në seancën e parë të shqyrtimit kryesor.**

Sipas 271 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurë Penale, krytari i këshillit do ta caktojë shqyrtimin kryesor në afat prej më së voni 30 ditëve nga pranimi i aktit akuzues në gjykatë, e nëse është bërë kërkes sipas nenit 269 të këtij ligji-me vendimin e këshillit, do të mund të caktohet shqyrtimi kryesor. Nëse në këtë afat nuk e cakton shqyrtimin kryesor kryetari i këshillit do ta njoftojë kryetarin e gjykatës për arsyet e mospërkatimit të shqyrtimit kryesor. Kryetari i gjykatës, sipas nevojës, do të ndërmarë masa që të caktohet shqyrtimi kryesor.

Periudha kohore prej paraqitimit të padisë deri në seancën e parë të shqyrtimit kryesor




Sipas analizës së rezultateve mund të konstatohet se në 239 pyetësore të plotësuar, vetëm në 46 ose 19,2% është vërejtur respektimi i afatit për caktimin e seancës së parë për shqyrtim kryesor në afat prej 30 ditësh nga pranimi i akuzës. Përqindja është e madhe në rastet kur seanca ka qenë e caktuar në periudhë prej mbi 12 muaj. Prej 24 rasteve të këtilla të

regjistruara, 12 këndë ose 50% janë konstatuar në Gjykatën Themelore në Manastir.

Akuza për veprë penale Dhënie e çekut pa mbulesë nga neni 274 paragrafi 1 të KP që zhvillohet në Gjykatën Themelore në Manastir është dorëzuar më 23.11.2000, kurse procesi i parë për shqyrtimin kryesor është mbajtur më 20.11.2003

Element tjetër për vlerësimin e nivelit të respektimit të parimit të gjykimit në afat të arsyeshëm është edhe dukuria e regjistruar e kohëzgjatjes së shkurtër të proceseve gjyqësore.

Pasqyrë e kohëzgjatjes së seancave



Në të vërtetë, në bazë të të dhënave prej 918 pyetësorë të plotësuar, mund të konkludohet se përqindja më e madhe, më shumë se 54,8% të gjytimeve kanë zgjetur më pak se 30 minuta.

Në numrin më të madh të rasteve kohëzgjatja e shkurtër e shqyrtimeve është pasojë e shtyrjeve të shpeshta të proceseve.

Në Gjykatën Themlore në Veles është ndjekur lëndna penale e cila zhvillohet për vepër penale Fshehje e tatimit – neni 279, paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 1 të KP. Në këtë lëndë seancat janë shtyrë dhe mbajtur 44 herë. Më 10.02.2004 aktgjykimi është lexuar nga ana e gjykatësit.

Në Gjykatën Themlore Shkup 1 zhvillohet lëndë penale për vepër penale Përdhunim sipas nenit 186 të KP e cila e është shtyrë gjithsej 29 herë. Procedura ende është në vijim.


Për lëndën që zhvillohet në Gjykatë Themlore Shkupi 1 për vepër penale Fshehje sipas neni 261 paragrafi 1 të KP, seancat janë shtyrë ngase në 6 muajt e fundit të procedurës, sepse gjykata nuk ka mundur ta gjejë të akuzuarin e parë. Kështu pas 21 shtyrjeve të proceseve është sjellur aktakuza më 10.02.2004 në munges të të akuzuarit të parë.

Më 05.02.2004 në Gjykatën Themlore Shkup 1 është vëzhguar lënda që zhvillohet për vepër penale për Sulm seksual ndaj fëmijës në përputhje me nenin 188 paragrafi 1 të KP. Aktakuza është pranuar në gjykatë më 24.06.1998. I njejt proces është shtyrë 31 herë. Procedura është në vijim.

Për lëndën që zhvillohet në Gjykatën Themlore në Tetovë për vepër penale sipas nenit 272 paragrafi 2 të KP është sjellur aktgjykimi i cili është shqipuar menjëherë pas zhgjitjes së procedurës pesë vjet dhe pas 30 shtyrjeve të proceseve për shqyrtimin kryesor.

Sa i përket **arsyeve** për shtyrjen e shqyrtimit kryesor rezultatet e japin këtë pasqyrë:

Pasqyrë e arsyeve për shtyrje



Mund të konkludohet se arsyet më të shpeshta për shtyrjen e proceseve janë në anën e të akuzuarit dhe të mbrojtësit të tij.

Hasen lëndë në të cilat i akuzuari i shfrytëzon të drejtat e veta që i janë dhënë me Ligjin për procedurë penale gjithnjë me qëllim të shtyrjes së procedurës.

Në Gjykatën Themelore në Shkup zhvillohet një lëndë për vepër penale Ndërmjetësim në kryerje e prostitucionit nga neni 191 të KP në të cilën i akuzuari ka shfrytëzuar ligjin në dobi të veten ashtuqë e ka ndëruar mbrojtësin me çka e ka shtyrë procedurën e cila ka qenë në fazën e fjalën përfundimtare, e me këtë u ka shkaktuar dëm të tjerëve të cilët kanë qenë në paraburgim. Me këtë atij i jepet mundësia për shtyrje të mëtejshme për shkak të propozimit të dëshmitëve të reja.

Shtyrja e procesit për shkak të mospranisë të njërit prej të akuzuarve është arsye e mjaftueshme për ndarjen e procedurës dhe atë me qëllim që të shmangen shtyrjet e panevojshme të proceseve.

Në përputhje me nenin 30 LPP mundet për shkaqe të rëndësishme ose për arsye të përshatjes gjykata që është kompetente për përfundimin e shqyrtimit kryesor të vendosë që procedura kundër të akuzuarve të caktuar të ndahet dhe në mënyrë të veçantë të përfundohet ose t'i dorëzohet një gjykatë tjetër kompetente.²¹

Në lëndën që zhvillohet në Gjykatën Themelore në SHkup për vepër penale Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe auotorizimit, procedura nga neni 353 i KP është zhvilluar kundër pesë të akuzuarve. Megjithatë mosprania e njërit prej të akuzuarve në dy procese shkaktoi ndarjen e procedurës për të cilën gjykatësi solli vendim në procesin e tretë.

Ky është një shembull i mirë për pengimin e mundësisë për zgjatjen e procedurës.

Gjatë shtyrjes së shqyrtimit kryesor ai nuk duhet të shtyhet për më tepër se 30 ditë. Në pajtim me nenin 297 paragrafi 3 i LPP nëse shqyrtimi kryesor shtyhet për më tepër se 30 ditë ai duhet të rifillojë sërish dhe të gjitha dëshmisë të prezantohen përsëri.²² Kjo situatë mund të kontribuojë për zgjatjen e panevojshme të procedurës.

Sipas analizës 12,2% të seancave të vëzhguara janë shtyrë për më tepër se 30 ditë.

Më 30.03.2004 është vëzhguar lëndë e cila zhvillohet në Gjykatën themelore Vinicë për vepër penale ryshfet, ku për shkak të shtyrjes së procesit kryesor për më tepër se 30 ditë, ai fillon rishtazi, me ç'rast janë lexuar dëshmitë e dëshmitarëve dhe të të akuzuarit dhe është bërë shikimi i të gjitha dëshmitëve materiale.

Rekomandim:

Duke pasur parasysh angazhimin e madh të gjykatësve me lëndë dhe rifillimin e shpeshtë të shqyrtimit kryesor për shkak të kalimit të afatit prej 30 ditëve, do të mund të pranohen disa zgjidhje krahasuese ku ky afat është caktuar në 2 muaj respektivisht jo më shumë se 3 muaj.

²¹ Në Ligjin e Procedurës Penale të Shqipërisë, arsyet pse gjykata mund ta ndajë procedurën janë numëruar në mënyrë të përpiktë në nenin 93. Në një numërim të këtillë (pika c) është caktuar se gjykata do ta ndajë procedurën nëse një ose disa të akuzuar nuk paraqiten në gjykim për shkak të dorëzimit jo në rregull të thirjes, shmangies së qëllimshme të dorëzimit të thirjes...

²² Sipas Ligjit të Procedurës Penale të Serbisë, në përputhje me nenin 309 paragrafi 3 shqyrtimi kryesor do të rifillojë poqese shtyrja zgjat më shumë se tre muaj. Sipas Ligjit të Kroacisë (neni 327 paragrafi 3) kjo periudhë kohore është 2 muaj.

Me qëllim që të sigurohet prania e të akuzuarit i cili edhe pse ka qenë i thirrur në mënyrë të rregullt në shqyrtimin kryesor, nuk është paraqitur dhe mungesën e tij nuk e arsyetuar ose nëse nuk është bërë dorëzimi i rregullt i thirrjes, kurse nga rrethanat shihet qartë se i akuzuari i largohet pranimit të thirrjes, në pajtim me nenin 177 të LPP, gjykata mund të japë urdhër për sjelljen (arrestimin) e tij. Urdhërin për sjelljen e tij e kryen Ministria e punëve të brendëshme ashtu që personi të cilit i është besuar kryerja e urdhërit, ia përcjellë urdhërin të akuzuarit dhe e thërret të vijë me të. Nëse i akuzuari e refuzon këtë, do ta sjellë me forcë.

Kjo dispozitë e ligjit për procedurë penale supozon bashkëpunim të plotë mes gjykatës dhe Ministrisë së punëve të brendëshme e cila është e detyruar për kryerjen e urdhërit për arrestim, të dhënë nga gjykata. Analiza e pyetësorëve dhe seancave të vëzhguara tregon përqindje të madhe të rasteve në të cilat edhe pas disa urdhërave të dhëna për sjelljen me forcë, i akuzuarit nuk ka qenë i arrestuar nga MPB. Kjo tregon vetëm koordinimin jo të mjaftueshëm të punëve në mes gjykatës dhe MPB-së dhe mungesën e bashkëpunimit të tyre më ekspeditiv.

Nga të dhënat me të cilat disponojmë, në 61 lëndë është dhënë urdhër për sjelljen me forcë. E njëjta është realizuar në 35 lëndë.

Në lëndën e cila zhvillohet në gjykatën themelore Gostivar për vepër penale vjedhje e rëndë në pajtim me nenin 236, paragrafi 1 alineja 1 e KP, gjykimet shtyhen 9 herë për shkak të pamundësisë që të sigurohet prania e të akuzuarit, kurse gjykata 2 herë ka dhënë urdhër për sjelljen e të akuzuarit me forcë

Më 16.12.2003 gjykimi për lëndën e cila zhvillohet në gjykatën themelore Sveti Nikole për vepër penale falsifikim dokumentesh nga neni 378 paragrafi 1 në lidhje me paragrafin 3 është shtyrë sepse MPB-ja nuk ka kryer urdhërin e gjykatës për ta sjellur të akuzuarin.

Më 20.01.2004 vëzhguesit kanë ndjekur lëndën që zhvillohet në gjykatën themelore Prilep për vepër penale Vjedhje nga neni 235 paragrafi 1 i KP, me ç'rast kanë vërejtur se shqyrtimi kryesor shtyhet për të shtatën herë dhe për shqyrtimin e ardhshëm është dhënë urdhër për ta sjellur me forcë të akuzuarin me vërejtje që patjetër të zbatohet sepse ky urdhër është dhënë disa herë. Në vetë gjykimin janë vërejtur edhe reagimet e dëshmitarit dhe të dëmtuarit sedisa herë së koti vijnë në gjykim.

Gjatë vëzhgimit hasen edhe 11 raste kur shqyrtimi kryesor është shtyrë për kohë të pacaktuar. Nga të dhënat mund të vërehet se për një vendim të këtillë arsyet janë:

- Në një rast në anën e gjykatës
- në 6 raste kanë qenë në anën e të akuzuarit dhe
- në 3 raste për shkak të dhënies së urdhërit për ekspertizë.

Njëri prej mjeteve dëshmuese që shfrytëzohen në procedurën e dëshmisë gjatë procedurave penale, është *Ekspertiza* e cila kontribuon për ndriçimin e disa fakteve që janë të rëndësishme së lartë për sjelljen e vendimit të drejtë nga gjykatësit. Megjithatë, praktika tregon se vetë ekspertiza mund të ketë edhe ndikim negativ dhe shpesh herë mund të jetë arsye për zgjatjen e procedurës.

Sipas të dhënave mnë pyetësore mund të konstatohet se në 107 lëndë është kërkuar ekspertizë, edhe atë:

Ekspertizë Kriminalistike	Në 14 lëndë
---------------------------	-------------

Ekspertizë gjyqësore medicinale	Në 28 lëndë
Ekspertizë psikijatrike	Në 17 lëndë
Financiare-Kontabiliste	Në 18 lëndë
Ekspertizë e komunikacionit	Në 11 lëndë
Lloj tjetër i ekspertizës	Në 19 lëndë

Analiza tregon se në entin për ekspertiza gjyqësore janë dërguar 40 kërkesa për ekspertizë nga të cilat 12 kërkesa janë për ekspertizë financiare-kontabiliste. Në 5 raste ekspertiza është kthyer për më tepër se 5 muaj.

Në lëndën e cila zhvillohet në gjykatën themelore Manastir për vepër penale shpërdorim sipas nenit 354 të KP, ajo është kthyer në procedurë pas ankesës për vendosje të sërishme, urdhëri për ekspertizë i është dhënë më 04.05.1999 Entit për ekspertiza gjyqësore dhe është kthyer më 02.12.99.

Në lëndën e cila zhvillohet në gjykatën themelore në Gjevgjeli për vepër penale përdorim i dokumentit me përmbajtje të rrejshme sipas nenit 380 nga KP, gjykata i ka dhënë urdhër Entit për ekspertiza gjyqësore për ekspertisë grafologjike më 25.04.03. Ekspertiza është kthyer më 16.09.03. Nuk ka pasur urgjenca për kryerje më të shpejtë të ekspertizës.

Është fakt se shumë herë ekspertizat zgjasin më tepër, kurse gjykatësi nuk ka mundësi të ndikojë për kryerje më të shpejtë të ekspertizës edhe pse në përgjithsi ka për obligim të kujdeset që gjykimet të zhvillohen pas zgjatje të panevojshme.

Rekomandime:

Që të realizohet në tërësi roli i gjykatësit si dominis litis në procedurën, është e pashmangshme që të bëhen disa ndryshime legjislative të dispozitave që kanë të bëjnë me ekspertizën si mjet dëshmie. Në këtë aspekt është e pëlqyeshme që në urdhërin e shkruar për ekspertizë gjykatësi të mundet të caktojë një afat për të cilin ekspertiza duhet të përfundojë. Afati i caktuar gjithsesi se do të mundet të vazhdohet pas kërkesës së ekspertit me qëllim të kryerjes së suksesshme të ekspertizës. Në këtë mënyrë do të shmangeshin shtyrjet e shqyrtimit kryesor në kohë të pacaktuar që i jep ekspertit liri të madhe, por do të shmanget edhe mosdorëzimi i ekspertizave të kryera për shkak të moskryerjes së pagesave në mes institucionit që ka bërë ekspertizën dhe gjykatës.

Procedura civile

Në LPN (neni 10) është vënë parimi për ndalim të shpërdorimit të të drejtave që u takojnë palëve në procedurë, sepse autorizimet proscore palëve u janë dhënë me qëllim që të kontribuojnë në sjelljen e vandimit ligjor dhe të drejtë, e të mos i bëhet hile palës kundërshtarë, gjykatës ose pjesëmarrësve tjerë në procedurë. Në përputhje me këtë, sanksioni i drejtpërdrejtë për shpërdorimin e kryer të autorizimeve porcesore është rregulluar edhe me dispozitën e neni 301, sipas së cilës gjykata është e autorizuar ta dënojë me të holla palën, përfaqësuesin ligjor, të autorizuarin ose ndërhyrësin që me veprimet e


veta procesuese kanë shpërdoruar rëndë të drejtat që njihen me këtë ligj. Lartësia e dënimit arrinë deri në katër rroga mesatare në Rrepublicën e Maqedonisë në muajt e fundit.²³

Është çështje tjetër se sa gjykata e përdor këtë masë ndëshkimore me qëllim që t'i pengojë pjesëmarrësit në procedurë të mos i shpërdorojnë të drejtat.

Rezultatet e hulumtimit të bërë (për priudhën Korrik 2003-Korrik 2004) për çështjen se sa kohë ka zgjetur procedura e shkallës së parë janë si vijon: prej 720 lëndëve të vëzhguara ka përgjigje vetëm për 72 lëndë ose 10%, kurse për lëndët tjera, porcedura është në vijim.

Për lëndët e theksuara më lartë për të cilat është sjellë aktgjykimi, kohëzgjatja e procedurës ka qenë e ndryshme.


Pasqyrë e kohëzgjatjes së procedurës së shkallës së parë



Edhe pse kemi të dhëna për një numër të vogël lëndësh për kohëzgjatjen e procedurës (vetëm 72 prej 720) konsiderojmë se procedurat zgjasin shumë.

Në të shumtën e rasteve, faktor i rëndësishëm që ka ndikim në kohëzgjatjen e procedurës është dorrëzimi ose mosdorrëzimi në rregull i thirjeve për palët.

Pasqyrë për dorrëzimin



Në pikëpamje të dorëzimit, nëse merren parasysh vetëm treguesit për porceset për të cilat ka të dhëna, atëherë del se përqindja e dorëzimit në rregull është e kënaqshme, krahasuar me përqindjes e proceseve në të cilat dorëzimi nuk ka qenë në rregull. Megjithatë edhe nga këto të dhëna me të cilat


disponojmë mund të konkludohet se në pikëpamje të dorëzimit duhet të ndërmerren aktivitete përkatëse që do të shkonin në favor të përmirësimit të efikasitetit të dorëzimit në

²³ Sipas Ligjit të procedurës Ndërgjyqësuese të Sërbisë, në nenin 316 është përcaktuar edhe lartësia e dënimit në të holla (10.000 dinarë) me të cilin do të dënohen "përfaqësuesi ligjor, i autorizuari ose ndërhyrësi që me veprimet e tija ndërgjyqësuese tenton të shpërdë të drejtat e parapara me ligj."

rregull. Dorrëzimi në rregull padyshim ka ndikim të madh në kohëzgjatjen e procedurës, por ajo nuk është vendimtare.

Faktor i rëndësishëm i kohëzgjatjes së procedurës është edhe shtyrja e seancave. Prej 758 shqyrtimi kryesor është shtyrë në 626 raste.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se arsye të shtyrjes së seancave janë të ndryshme.



Rezultatet e hulumtimit tregojnë edhe diçka tjetër, e kjo është se seancat për një lëndë të njejtë shtyhen disa herë, që gjithsesi ndikon në rrjedhën kohore të procedurës. (Tabela 5).

Në lëndën që zhvillohet në Gjykatën Themelore Tetovë, seanca për shqyrtimin kryesor shtyhet 15 herë në periudhë prej një viti sa zgjat procedura edhe atë për arsye të ndryshme.

Në lëndën që zhvillohet në Gjykatën Themelore në Gostivar, shqyrtimi kryesor shtyhet 11 herë, për arsye të ndryshme. Procedura është në vijim.

Tabela 5. Sa herë është shtyrë seanca për shqyrtimin kryesor

Sa herë është shtyrë	Numri i seancave	Përqindja
Deri në dy herë	151	20.1%
Prej 3 deri në 6 herë	108	15%
Prej 7 deri në 15 herë	37	5.1%
Më shumë se 15 herë	13	1.8%
Nuk ka të dhëna	598	66%

Këta rezultate kanë të bëjnë me lëndët të cilat ende nuk kanë përfunduar që do të thotë se nuk është e thënë që ky është numri i përgjithshëm i shtyrjeve në një lëndë nga seanca e parë për shqyrtimin kryesor e deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor dhe sjelljen e aktgjykimit.

Rekomandime:

Shtyrja e seancave për një lëndë të njejtë shumë herë konsiderojmë se është e palejueshme dhe në këtë drejtim duhet kërkuar zgjidhje të cilat do të shpënin drejt ndryshimeve dhe plotësimeve të LPN.

Sipas nenit 270 të LPN i akuzuari ka të drejtë t'i japë përgjigje akuzës dhe këtë mund ta bëjë me vullnetin e vet, por mundet ta bëjë edhe kryetari i këshillit poqese konsideron se është e nevojshme të bëjë me dije të akuzuarit për afatin e caktuar i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë prej dorëzimit të akuzës. Me përjashtim nën rrethana të posaçme të rastit ky afat mund të jetë edhe në 30 ditë. Megjithatë, dhënia e përgjigjes në akuzën mund të ndikojë në ndriçimin e fakteve të caktuara që nga ana tjetër do ta thjeshtësojë dhe shpejtojë procedurën e mëtejshme.

Nga të dhënat që i përmbajnë pyetësorët mund të shihet se i akuzuari i ka dhënë përgjigje akuzës në 160 lëndë, ndërsa në 493 lëndë nuk është dhënë përgjigje. Shkalla e kështillë e lartë e mosdhënie së përgjigjeve në akuzën sigurisht se ka ndikim të madh për shtyrjen e lëndëve. Nëse kësaj i shtohet e dhëna se përgjigjet e dhëna ndaj akuzës në 23 lëndë ose 14,4% përgjigjet nuk janë dhënë në kohë, bëhet krejtësisht e qartë se seancat duhet të shtyhen ngase nuk ekzistojnë kushte që gjykata të bëjë shqyrtimin.

Kryetari i këshillit mund të vendos që të thirrë seancë përgaditore (vetëm në rastet kur gjykon këshilli gjyqësor) por mundet edhe menjëherë të caktojë seancë për shqyrtim kryesor nëse konsideron se për shkak të përmbajtjes së akuzës dhe natyrës së kontestit nuk është e nevojshme mbajtja e seancës përgaditore (neni 269 i LPN).

Në 259 raste është mbajtur seancë përgaditore. Seanca përgaditore caktohet vetëm nëse gjykon këshilli gjyqësor, kjo gjithashtu mund të ndikojë pozitivisht në lehtësimin e mëtejshëm dhe shpejtimin e procedurës ngase në seancës përgaditore paraprakisht diskutohet për çështje që kanë të bëjnë me pengesat e rrejdhes së mëtejshme të procedurës qoftë kur Kryetari i këshillit pas analizimit të akuzës të ketë shtyrë zgjidhjenë këtyre çështjeve, qoftë nëse ata janë inicuar në përgjigjen ndaj akuzës ose në seancën përgaditore. Për këto çështje në seancës përgaditore, mund të nxjerren dëshmi nëse kjo është e nevojshme.

Seanca përgaditore po të jetë e domosdoshme drejtpërdrejtë do të ndikonte në përmirësimin dhe në shpejtimin e kohëzgjatjes së procedurave.


Rekomandim:

Duhet të bëhen ndryshime në LPN me të cilat përgjigja ndaj akuzës dhe seanca përgaditore do të ishin paraparë si faza të domosdoshme të procedurës²⁴

²⁴ Si vërejtje nga tryeza e rumbullakët u theksua se poqese përgjigja për padinë përfshihet si fazë e domosdoshme e procedurës ndërgjyqësuese, paraqitet problemi i pagesës së taksës gjyqësore për përgjigje në padinë me çka i padituri detyrohet të pagujë. Prandaj duhet theksuar se nëse vihet përgjigja ndaj padisë si fazë e domosdoshme do të duhet të mos paguhet taksta gjyqësore për përgjigje ndaj padisë.

Në kohëzgjatjene procedurës ka ndikim edhe periudha kohore për të cilën është shtyrë seanca.

Pasqyrë e kohës për të cilën është shtyrë shqyrtimi kryesor




Rekomandim:

Gjykata duhet të orvatet që seancat të mos shtyhen në kohë të pacaktuar.

Në përputhje me nenin 172 paragrafi 1 të Ligjit të procedurës ndërgjyqësuese, ndërgjyqësia fillon të rrjedhë që nga momenti i dorrëzimit të akuzës të akuzuarit (litis pendentia). Ndërkaq në pikëpamje të punës ekspeditive të gjykatave mund të analizohet edhe periudha prejkur është dorëzuar akuza në gjykatë e derisa akuza t'i dorëzohet të akuzuarit.

Në përputhje me analizën, pasqyra e rezultateve është si vijon:

Pasyrë për kohën prej parashtrimit të padisë në gjykatë deri në dorëzimin e saj tek i padituri



Në lëndën që zhvillohet në Gjykatën Themlore në Manastir, për bazë juridike borxh akuza i qe dorrëzuar gjykatës më 26.08.2002, gjykatësi e ka marrë për ta punuar më 15.07.2003 kurse të akuzuarit i është dorrzuar më 23.07.2003. Periudha që ka kaluar prej dorëzimit të akuzës në gjykatë deri në dorëzimin e saj te i akuzuari është 11 muaj.

Në gjatësinë e kësaj periudhe mund të ndikojnë shumë faktorë të cilat janë të lidhura me veprimet që ndërmerren në atë periudhë, në të vërtetë, gjykata para se t'ia dorëzojë akuzën të akuzuarit analizon se a është akuza e plotë dhe a është dorëzuar në kohë. Në rastin kur ajo nuk është në regul ia kthen akuzuesit duke i caktuar një afat gjykatë të cilit duhet ta rregullojë dhe t'ia rikthejë gjykatës.

Në lëndën që zhvillohet në Gjykatën Themlore në Berovë, periudha prej dorëzimit të akuzës në gjykatë deri në dorëzimin e saj të akuzuarit është 4,5 muaj, ndërkaq është fjala për një akuzë e cila nuk ka qenë në rregull kur i është dorrzuar për ç'arsey gjykata ia ka kthyer akuzuesit që ta plotësojë.

Edhe pse kjo nuk do të thotë shkelje të dispozitave të ligjit, megjithatë kan ndikim të madh në parimin e gjykimit në afat të arsyeshëm si dhe në besimin e qytetarëve ndaj gjyqësisë dhe në dëshirën e tyre që të drejtat e veta ti realizojë përmes gjykatave.

Sidoqoftë dorrëzimi i akuzës të akuzuarit nuk guxon që të bëhet pas kalimit të një afati prej 3 muajsh dhe në këtë kuptim duhet të krijohen kushte nëpër gjykata me qëllim që të shkurtojhet kohëzgjatja e procedurës.

Pushimi e procedurës²⁵ është institut i veçantë në procedurën ndërgjyqësuese dhe paraqet ngecje në veprimin e gjykatës dhe të palëve në kontest ashtuqë afatet e caktuara me ligj nuk pushojnë të rrjedhin dhe kjo mund të ndodhë deri në përfundimin e shqyrtimit

²⁵ Në përputhje me nenin 201 të LPN, pushimi i procedurës vjen në shprehje nëse që të dyja palët para përfundimit të diskutimit kryesor merren vesh, ose kur të dyja palët do të mungojnë nga seanca përgaditore ose nga seancat për shqyrtim kryesor, respektivisht kur palët e pranishme në seancë nuk duan të diskutojnë si dhe kur njera nga palët e cila është e thirrur në mënyrë të rregullt nuk do të vijë, kurse pala tjetër do të propozojë pushim, ose kur në seancë do të vijë vetëm paditësi për çka nuk do të vazhdojë sjellja e aktgjykimit për shkak të mungesës.

kryesor kur të dyja palët do të mungojnë ose si pasojë ligjore e joaktivitetit të palëve. Pushimi i procedurës mundet gjithashtu të ndikojë në kohëzgjatjen e procedurës.

Në periudhën që është vëzhguar, sipas të dhënave të fituara pushim të procedurës ka pasur vetëm në 19 lëndë ose 2,6 %.

Rekomandim:

Edhe pse përqindja e lëndëve të vëzhguara në të cilat ka pasur pushim të procedurës është e vogël, dispozitat e LPN-së për pushimin e procedurës duhet të shfuqizohen.

Gjatë analizës së rezultateve të hulumtimit për dia konteste mund të vërehet se procedura ka zgjatur shumë kohë edhe pse për atë lloj kontesti LPN parasheh se procedura është urgjente (konteste pune)²⁶.

Në Gjykatën themelore në Gjevgjeli më 06.10.2003 është vëzhguar lëndë nga një kontest pune-Kompensim i rrogave dhe kontributeve nga rrogat. akuzta është dorëzuar në Gjykatë në vitin 1992 dhe procedura e shkallës së parë ka përfunduar me aktgjykim pas një kohezgjatjeje prej 10 viteve. Kundër aktgjykimit është parashtruar ankesë, gjykata e shkallës së dytë e ka shfuqizuar dhe lëndën e ka rikthyer për gjykim në gjykatën e shkallës së parë. Procedura e shkallës së dytë ka zgjatur 3 muaj.

Në Gjykatën themelore në Kumanovë për lëndën që i përket kontestit në punë-shfuqizimi i vendimit dhe kthimi në punë, akuzat është dorëzuar më 29.07.1998, aktgjykimi është sjellur më 19.03.2003. Është paraqitur ankesë dhe gjykata e shkallës së dytë e ka shfuqizuar aktgjykimin dhe lëndën e ka kthyer për shqyrtim në shkallën e parë.

Në Gjykatën Themelore Shkup 1, procedura për lëndën e kontestit në punë zhvillohet prej vitit 1999. Shqyrtimi kryesor është shtyrë shumë herë për arye të ndryshme, prej të cilave njëra është ndryshimi në këshillin gjyqësor, për ç'raste procedura është dashur të nis nga fillimi.

Në gjitha këto raste mund të shtrohet me plotë të drejtë pyetja, vallë gjykimi mbahet në afatin e arsyeshem.

7. E drejta e heshtjes

E drejta e heshtjes në situatë të ekzaminimit policor dhe privilegjit kundër vetë-akuzës, proklamohen si standarde të përgjithshme ndërkombëtare që shtrihen në zemrën e

²⁶ Në lëndën Janeva kundër Republikës së Maqedonisë e cila zhvillohej në Gjykatën evropiane për të drejtat e njeriut në Strazbur, aplikuesi thekson fakte të cilat shkojnë në favor të shkeljes së të drejtave të tij për gjykim të afat të arsyeshem, sepse në gjykatat e vendit procedura për kontest puna ka zgjatur 10 vjet, lënda është kthyer 4herë për vendosje në shkallën e parë kurse aktgjykimin e fundit gjykata nuk e ka shkruar 1 vjet e 9 muaj. Është arritur një marrëveshje miqësore dhe aplikantit i është paguar dëmshpërblim prej 77.000 evro.

nocionit për gjykime të drejta dhe i sigurojnë të akuzuarit mbrojtje nga detyrimi i paligjshëm për të pranuar (John Murray v. U.K., 8.02.1996, R.J.D., 1996-1, No.1).

Në të gjitha sistemet bashkëkohore juridike, i akuzuari ka të drejtën e heshtjes, edhe atë më së paku në kuptimin e ngushtë të fjalës: gjatë tërë procedurës penale i akuzuari ka të drejtë të refuzojë dhënien e përgjigjeve në pyetjet dhe për shkak të shfrytëzimit të kësaj të drejteje nuk guxon tu nënshtrohet sanksioneve penale, e aq më pak torturave me urdhër të autoriteteve, siç ka qenë në të kaluarën.

Në sistemin juridik të vendit disa dyshime shkaktuan ndalimin kushtetues që personi i thirrur, i arrestuar ose i privuar nga liria të mos mundet të kërkohet deklarata. Në ligjin për procedurë penale kjo dispozitë e kushtetutës komentohet si shprehje e të drejtës për heshtje, respektivisht si ndalim që personi të detyrohet të japë ose të nënshkruaj ndonjë deklaratë, e jo në kuptim se me të nuk mund të bisedohet fare. Kjo me të vërtetë nuk është komentim tejet restriktiv i dispozitave kushtetuese, i cili do të jetë qasje parimore kur bëhet fjalë për të drejtat dhe liritë elementare, por është më reale dhe tek e fundit përputhet me zgjidhjet dhe praktikën në të drejtën ndërkombëtare.


Gjykata lështë e obliguar t'ia bëjë me dije të akuzuarit se ka të drejtë të heshtë dhe kjo të evidentohet në procesverbal.

Në 430 lëndë të akuzuarit i është bërë me dije për të drejtën e heshtjes, kurse në 17 lëndë ai nuk ka qenë i njoftuar për këtë të drejtë. Nga këto 17 lëndë, 10 lëndë janë zhvilluar në gjykatën themelore në Vinicë. Më së shpeshti në këto raste, i akuzuari nuk njoftohet me të drejtën e heshtjes kurse njoftimi drejtpërdrejtë evidentohet në procesverbal. Patjetër duhet përmendur se me vetë shënimin e informimit për të drejtën e heshtjes në procesverbal nuk plotësohet obligimi që ka gjykatësi për t'i sqaruar të akuzuarit të drejtat që ka gjatë procedurës. Para se të shënojë në procesverbal, gjykatësi ka për detyrë të informojë të akuzuarin se nuk është i obliguar të flasë dhe të prezantojë mbrojtjen e tij, t'i sqarojë domethënien e kësaj të drejte si dhe fakti që nëse i akuzuari merr vendim të përdorë këtë të drejtë, vendimi i tij nuk do të reflektohet me pasoja negative ndaj tij.

Sipas gjykatës, ku janë zhvilluar lëndët ku i akuzuari nuk ka qenë i informuar për të drejtën e heshtjes, gjendja është me sa vijon:

Gjykata Themelore Vinicë	10 lëndë
Gjykata Themelore Shkup 1	1 Lëndë
Gjykata Themelore Radovish	1 lëndë
Gjykata Themelore Koçanë	1 lëndë
Gjykata Themelore Dibër	2 lëndë
Gjykata Themelore Manastir	1 lëndë

Pasyrë e përdorimit të së drejtës për heshtje



Megjithatë analiza tregon se shumë rrallë i akuzuari përdo të drejtën e heshtjes. Respektivisht, në 395 lëndë ai nuk ka përdorur këtë të drejtë, kurse vetëm në 10 lëndë është përdorur e drejta e heshtjes.

8. E drejta për përkthyes

Procedurë penale

E drejta për përkthyes për të akuzuarin i cili nuk e kupton gjuhën është standard i pakontestueshëm në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, i akceptuar edhe në të drejtën krahasuese, si e drejtë e çdo personi të privuar nga liria ose të akuzuar për veprë penale, tek ne e përhapur mbi të gjithë pjesëmarrësit në procedurë. Standardi ndërkombëtar nuk nënkupton të drejtën që personi të shprehet në gjuhën që e zgjedh vetë, nëse ai ose mbrojtësi i tij nuk njohin mirë atë gjuhë (që është një çështje faktike).

Në procedurën penale nënkuptohet ndihma e përkthyesit që të mundësojë të kuptuarit e tërë asaj që e theksojnë prokuroria, dëshmitarët dhe ekspertët, por e drejta për ndihmë falas nga përkthyesi nuk është kufizuar në shqyrtimin gojor në gjykatë. Kjo krahas deklaratave ka të bëjë edhe me të gjitha dokumentet që i akuzuari ka nevojë t'i kuptojë, me qëllim që të ketë gjykim të drejtë. Garancia mbulon edhe procedurën e mëparshme, edhe përkthimin e dokumenteve siç janë akti i prokurorisë etj. Megjithatë, sipas Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, e drejta nga neni 6 paragrafi 3 respektivisht nga konventa evropiane *nuk shkon aq larg që të kërkojë përkthim me shkrim të çdo dëshmi me shkrim ose akt zyrtar në procedurë*. Ndihma e përkthyesit në këtë kuptim, duhet të jetë e tillë që t'i mundësojë të akuzuarit të ketë njohuri për rastin kundër tij dhe të mbrohet në mënyrë që para gjykatës të mund ta nxjerrë versionin e tij për ndodhitë. E drejta më tutje nënkupton përkthimin e deklaratave të dëshmitarëve në interes të tij.

Obligimi i autoriteteve kompetente shtetërore nuk kufizohet vetëm me caktimin e përkthyesit, por nënkupton edhe kontroll të arsyeshëm mbi *saktësinë e përkthimit*, veçanërisht nëse paraqitet nevoja për këtë. Në këtë drejtim mund të kërkohej edhe ndërrimi i përkthyesit.

Në përputhje me nenin 5 dhe 6 të KEDNJ, LPP fillimisht parasheh që çdo person i thirrur, arrestuar ose i privuar nga liria menjëherë të njoftohen në gjuhën që e kupton për arsyet e thirrjes, arrestimit ose privimit nga liria si dhe për çdo akuzë penale kundër tij dhe të drejtave të tij (neni 3). Çdo i akuzuar ka të drejtë të jetë i informuar menjëherë, në gjuhën që e kupton dhe hollësisht për veprat për të cilat akuzohet dhe për dëshmitë kundër tij (neni 4 paragrafi 4 alineja 1).

Ajo që nuk duhet haruar është fakti se në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, harxhimet për përkthim i mbulon buxheti edhe të për të gjithë, e jo vetëm për të akuzuarit që nuk e njohin gjuhën. Përveç kësaj shkeljet e dispozitave të gjuhës nuk janë më shkelje absolute të procedurës, por mund të paraqesin vetëm shkelje relative, nga aspekti i shkeljes së të drejtave në shqyrtimin kryesor.

Sipas LPP, pjestar i ndonjë nacionaliteti që është shtetas i Republikës së Maqedonisë në procedurën penale ka të drejtë të përdorë gjuhën e nacionalitetit të cilit i përket. Gjykata këtij personi i siguron përkthyes falas. Palët tjera, dëshmitarët dhe pjesëmarrës në

procedurën në gjykatë kanë të drejtë për ndihmë falas²⁷ nga përkthyesi, nëse nuk kuptojnë apo flasin gjuhën në të cilën zhvillohet procedura. Kjo është në përputhje me nenin 6 (3) d nga konventa evropiane për të drejtat e njeriut.

Në gjykatën themelore në Vinicë është vëzhguar një lëndë për veprë penale Raste të veçanta të falsifikimit të dokumenteve nga neni 379 i KP. Gjatë dhënies së mbrojtjes së tij dhe gjatë marrjes në pyetje, i akuzuari ka përdorur gjuhën angleze, me ç'rast i është mundësuar interpretues përkatës. Gjykata nuk ka mundur të gjejë përkthyes nga gjuha holandeze prandaj i akuzuari është pajtuar që mbrojtjen e tij ta japë në anglisht dhe të komunikojë me gjykatën anglisht.²⁸ I akuzuari ka parashtruar ankesë pas dhënies së deklaratës dhe marrjes në pyetje nuk i është përkthyer asgjë dhe ka dashur që kjo të evidentohet në procesverbal, mirëpo gjykata ka refuzuar këtë ankesë duke shpjeguar se i akuzuari ka të drejtë të ketë përkthim vetëm gjatë marrjes në pyetje ose gjatë dhënies së deklaratës. Më tutje nuk ka obligim për përkthim të të gjitha veprimeve dhe diskutimeve sepse për interesat e të akuzuarit kujdeset personi i autorizuar.²⁹

Nga të gjitha gjykimet e vëzhguara, në 95,1% të lëndëve i akuzuari ka përdorur gjuhën maqedonase, në 22 lëndë ai ka përdorur gjuhën shqipe, në 2 lëndë gjuhën turke dhe në një lëndë atë anglishte. Për ata që nuk e përdorin gjuhën maqedonase gjykata ka mundësuar ndihmë falas nga përkthyesi dhe atyre u ka siguruar interpretues. Në një lëndë është vërejtur shkelje e kësaj të drejte.

Në Gjykatën themelore Kumanovë në një lëndë të vëzhguar të akuzuarit kanë kërkuar përkthyes në gjuhën shqipe. Gjykata ka kërkuar përkthyes mirëpo nuk e ka siguruar pasi që përkthyesi gjyqësor ka qenë në pushim mjekësor, prandaj të akuzuarit janë marrë në pyetje pa përkthyes. Në senacën e njejtë është sjellur aktgjykimi.

Gjykata nuk ka për obligim vetëm gjetjen dhe sigurimin e përkthyesit të autorizuar gjyqësor, por duhet edhe të ketë kujdes për cilësinë dhe saktësinë e përkthimit nëse ka nevojë. Mirëpo, në gjykatat themelore të vendit pik së pari duhet të zgjidhet problemi i numërit të mjaftueshëm të përkthyesve gjyqësorë³⁰

Rekomandime:

Në përputhje me dispozitat për përdorimin e gjuhëve gjatë procedurave penale çdo gjykatë duhet të ketë listën e përkthyesve të regjistruar gjyqësor për gjuhë

²⁷ Në rastin Luedicke, Belkacem dhe Koc kundër Republikës Federale të Gjermanisë, gjykata ka vendosur se dispozita për ndihmë falas për përkthyes ndalon që t'i urdhërohet të akuzuarit që të paguajë për harxhimet e përkthyesit dhe se kjo dispozitë i mbulon edhe ato dokumente dhe deklarata gjatë procedurës që vendosen kundër tij, që është e nevojshme ai t'i kuptojë për të pasur një gjykim të drejtë.

²⁸ Në rastin Brozicek kundër Italisë një gjerman ka qenë i dënuar në Itali. Gjykata ka vendosur që dokumentet të cilat përmbajnë akuzënduhet të dërgohen në gjuhën gjermane përveç nëse vendoset se aplikuesi kupton italishten në nivel të mjaftueshëm (Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut)

²⁹ Në rastin Kamasinki kundër Austrisë, Gjykata ka vendosur që ndihma të jetë e tillë që t'i mundësojë të akuzuarit të ketë njohuri rreth rastit dhe të mbrohet, respektivisht të mundet të prezantojë versionin e vet për nëndodhitë, para gjykatës (Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut)

³⁰ Në veprimet që zhvillohen për vepra penale Ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit, të dëmtuarit më së shpeshti janë nga Rumania dhe Molldavia. Përkthyes të autorizuar për këto dy gjyhë nuk ekzistojnë, por gjatë gjykimeve përkthejnë persona që njohin gjuhën vllehe. Kjo ndikon për cilësi të dobët të përkthimit për çka ankohen edhe vetë të dëmtuarit.

përkatëse me qëllim që gjykatësi të mundet në kohë të sigurojë interpretues cilësorë dhe të dëshmuar.

Nuk guxon të tolerohet që mossigurimi i interpretuesit të jetë shkak për shtyrjen e seancës. Kjo flet se gjykatësi nuk e ka përgatitur si duhet shqyrtimin kryesor.

Procedura civile

Njëri prej standardeve të rëndësishme që garanton kushtetuta, e mandej i konkretizuar me LPN është çështja e përdorimit të gjuhëve dhe alfabetit në procedurat gjuhësore. Ky standard ka rëndësi të veçantë kur bëhet fjalë për nacionalitetet e Republikës së Maqedonisë. E drejta e pjestarëve të nacionaliteteve të Republikës së Maqedonisë në procedurat gjuhësore ta përdorin gjuhën dhe alfabetin e vet ka tre aspekte: aspekti i parë është nga pikëpamja e barazisë dhe jodiskriminimit në gjykatë, i dyti është mundësia që pala të përdorë gjuhën dhe alfabetin e vet në procedurën në gjykatë kur kjo e drejtë është e garantuar me Kushtetutë në pajtim me ligjin, dhe i treti, pala ka të drejtë për përkthyes kur nuk e kupton dhe nuk e flet gjuhën maqedonase dhe alfabetin e tij cirilik.

Sipas nenit 1 paragrafi 1 të LNPLPN procedura ndërgjygjësuese zhvillohet në gjuhën maqedonase dhe me alfabetin e saj cirilik. Në procedurën ndërgjygjësuese, gjuha tjetër zyrtare që e flasin të paktën 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj, përdoren në përputhje me këtë ligj (neni 1 paragrafi 2 i LNPLPN). Pjestari i bashkësisë i cili si palë ose pjesëmarrës tjetër në procedurë i cili nuk e kumton dhe nuk e flet gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj, ka të drejtë për përkthyes (neni 1 paragrafi 3 i LNPLPN). Harxhimet për përkthim i mbulon gjykata me mjetet e saj (neni 1 paragrafi 4 i LNPLPN).

Në përputhje me këto dispozita palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë, të cilët janë qytetarë të RM gjuha e të cilëve është e ndryshme nga gjuha zyrtare maqedonase, thirrjet, vendimet, dhe dokumentet tjera gjyqësore u dorëzohen krahas gjuhës maqedonase edhe në gjuhën e tyre. Poashtu këto palë dhe pjesëmarrës në procedurë, akuzat, ankesat dhe parashtrësate tjera mund t'i dorëzojnë në gjykatë në gjuhën dhe alfabetin e tyre, nëse ajo është gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj. Parashtrësat (podnesci) e dorëzuara në gjuhë dhe alfabet tjetër zyrtar, gjykata i përkthen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik dhe ua dorëzon të përkthyer palëve tjera dhe pjesëmarrësve në procedurën. Përkthimin e bëjnë përkthyes gjyqësorë kurse harxhimet i mbulon gjykata me mjetet e saj.

Gjykata, ka obligim, respektivisht është e detyruar ta informojë palën, respektivisht pjesëmarrësin tjetër në procedurë për të drejtat e lartpërmendura për përdorimin e gjuhës dhe këtë si dhe deklaratën e palës, respektivisht të pjesëmarrësit tjetër në procedurën, ta evidentojë në procesverbal.

Palët dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë që janë qytetarë të RM, gjuha e të cilëve nuk është gjuha maqedonase dhe alfabeti cirilik, e nuk është as gjuhë tjetër zyrtare e ndryshme prej gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik që e flasin të paktën 20% e qytetarëve, gjatë procedurës kanë të drejta ta përdorin gjuhën e tyre gjatë pjesëmarrjes në seanca gjyqësore dhe gjatë veprimeve të tjera në gjykatë. Këtyre palëve dhe pjesëmarrësve në procedurë iu sigurohet përkthim gojor në gjuhën e tyre për atë se çka flitet në seancë, si dhe përkthim gojor të dokumenteve që përdoren gjatë seancës si dëshmi. Këto palë dhe pjesëmarrës gjykata është e obliguar t'i informojë për të drejtën se mundën procedurën gojore ta ndjekin në gjuhën e tyre me ndërmjetësimin e përkthyesit.

Këtu mund të shtrohet edhe pyetja për gatishmërinë e gjykatave për përkthyes të kualifikuar, që mund të jetë edhe arsye vonese për marrjen e këtyre lëndëve për t'i punuar. Duke ditur këtë, palët të cilët kanë dëshirë tu merret më shpejtë lënda për punim, ndoshta ende nuk vendosin masivikisht që ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre për përdorimin e gjuhës së tyre si gjuhë zyrtare që është e ndryshme nga gjuha maqedonase.

Në pyetjen, vallë a u ka mundësuar gjykata interpretues palëve, respektivisht pjesëmarrësve të cilët gjuhn maqedonase nuk e kanë gjuhë amtare, respektivisht përkthyes të siguruar, përgjigja është se vetëm në tre lëndë gjykata nuk u ka siguruar interpretues palëve. Pa marrë parasysh arsyet pse gjykata nuk ka mundur tu sigurojë përkthyes palëve, të cilëve u takon kjo e drejtë, bile edhe nëse nuk ka pasur përkthyes, kjo nuk e liron nga obligimi ligjor ta bëjë këtë dhe ka qenë i obliguar ta shtyjë diskutimin deri në momentin kur të krijohen kushtet.

Edhe pse gjykatat bëjnë përpjekje serioze që të sigurojnë realizimin e të drejtës së përkthyesit, pasi gjendja momentale me numrin e përkthyesve të kualifikuar për të gjitha gjuhët krijon probleme organizative të cilat në të ardhshmen urgjentisht duhet të zgjidhen, kjo nuk mund të jetë arsyetim.


9. E drejta për mbrojtje

Procedura penale

Të drejtën e mbrojtësit parimisht e proklamojnë të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare duke garantuar të drejtën që i akuzuari tëp mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit sipas zgjedhjes së vet (neni 14 i PNDCP; neni 6, paragrafi 3 nga KEDNJ) që i mundëson të akuzuarit liri të plotë që të vendosë për atë se si do të mbrohet.

E drejta për mbrojtje është kategori kushtetuese e në përputhje me nenin 12 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë kjo është zgjeruar edhe në procedurën policore. E drejta është konkretizuar në shumë dispozita të LPP duke përfshira edhe të atilla të cilat, në rastet kur të akuzuarit nuk i tregohet për të drejtën e mbrojtësit, parashihen sanksione të ashpra procesuese që nënkuptojnë ndalim dhënies së vendimit gjyqësor të mbështetur në deklaratën e dhënë (neni 218 paragrafi 10 i LPP).

I akuzuari mund të mbrohet vetë dhe sipas rregullit, ai vendos vetë se ado të marrë dhe cilin do ta marrë për mbrojtës. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se kjo e drejtë është absolute sepse i akuzuari për mbrojtës mund të zgjedhë vetëm ndonjë avokat kurse me ligj rregulohet se në cilat raste i akuzuari duhet patjetër të ketë mbrojtës, të cilin e cakton gjykata në rast se vetë i akuzuari nuk e zgjedh.



Sipas analizës së të dhënave në 97% të lëndëve i akuzuari e ka zgjedhur vetë mbrojtësin e vet

ndërsa në 3% të lëndëve avpkati i është caktuar sipas detyrimit zyrtar. .

Përveç rasteve të mbrojtjes së domosdoshme, mbrojtja është e mundshme, sipas detyrimit zyrtar, edhe në rastet kur i akuzuari nuk mund t'i mbulojë shpenzimet e mbrojtjes. Në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për drejtat e njeriut në rastet *Godi* (*Goddi v. Italy, Series A, No. 76, 1984*) dhe *Artiko kundër Italisë* (*Artico v. Italy, Series A, No. 37, 1980*) mbrojtësi i caktuar sipas detyrimit zyrtar i cili nuk e kryen si duhet detyrën e vet, kryetari i gjykatës mund ta shkarkojë me kërkesë të të akuzuarit ose me iniciativën e vet, me pëlqimin e të akuzuarit. Në vendin e mbrojtësit të shkarkuar vendoset mbrojtës i ri kurse për shkarkimin informohet Dhoma e avokatëve (neni 68 paragrafi 4 i LPP). Sa u përket shpenzimeve të mbrojtjes, madje edhe kur do të shpallet fajtor, i akuzuari gjithëherë lirohet nga shpenzimet në rastet kur mbrojtësi në përputhje me nenin 66 të LPP i është caktuar nga gjykata pikërisht për arsye se ai vetë nuk ka pasur mjete që t'i paguajë si dhe në rastet kur mbrojtësi është i domosdoshëm, kur me mbulimin e atyre shpenzimeve do të vehej në pyetje sigurimi i ushqimit për të dhe për familjen e tij (neni 91 i LPP).

Zgjidhjet e këtilla janë në përputhje me interpretimin e nenit 6 (3) (v) të Konventës Evropiane dhe mund të konkludohet se vështirësi më të mëdha në harmonizimin e legjislativës së vendit dhe praktikës me Konventën nuk do të duhet të ketë. Në këtë çast ekzistojnë tre dispozita të cilave duhet tu bëhet një harmonizim i tillë: 1) mbikëqyrja e komunikimit ndërmjet mbrojtësit dhe të akuzuarit në paraburgim; 2) mbrojtja e të varfërve; dhe 3) mbrojtja gjatë gjykimeve në mungesë.

Ndihmë ligjore falas. Gjatë kohë konsiderohej se shtetet duhet t'i rregullojnë mënyrën dhe kushtet e ndihmës ligjore falas në rastet kur i akuzuari nuk ka mjete të mjaftueshme që t'i mbulojë shpenzimet e këtilla. Kërkesa që kjo të sigurohet kur këtë e kërkojnë "interesat e drejtësisë" filloi të marë përmbajtje kënkrete në jurispodencën më të re në Strazbur. Kriteret që shfrytëzohen në këtë kuptim janë: serioziteti i shkeljes dhe ashpërsia e sanksionit të mundshëm; kompleksiviteti i rastit dhe gjendja personale e të akuzuarit. Për ne është posaçërisht e rëndësishme ajo që Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut në rastin *Kuaranta* (*Quaranta v. Switzerland, Series A, No. 205, 1991*) ka gjetur shkelje të Konventës duke nisur pikësëpari nga rrethana që dënimi i paraparë mund të arrihte 3 vjet burgim. Kjo kërkon ndryshime përkatëse në procedurën penale të vendit duke pasur parasysh atë që neni 67 i LPP parasheh mundësinë që në rastet kur ai sipas gjendjes së vetë pronësore nuk mund ti mbulojë shpenzime e mbrojtjes, të akuzuarit t'i caktohet mbrojtës nëse procedura zhvillohet për vepër penale për të cilën është caktuar dënim me burg *mbi 3 vjet* dhe atë vetëm në bazë të akuzës së ngritur.³¹

Nga ana tjetër ky nen i Ligjit në masë të vogël i cakton kushtet për dhënien e ndihmës juridike falas edhe në aspekt të pjesës së nenit 6 (3) v të Konventës Evropiane sipas të cilit i akuzuari ka të drejtë...nëse nuk ka mjete të mjaftueshme që të paguajë për ndihmën juridike, kjo të sigurohet falas në interes të drejtësisë.

³¹ Sipas ligjeve për procedura penale të Kroacisë, Sllovenisë dhe Shqipërisë, si kusht për ndihmë ligjore falas është paraparë se i akuzuari ka të drejtë për ndihmë ligjore falas vetëm atëherë kur sipas gjendjes së tij pronësore nuk mund t'i paguajë harxhimet e mbrojtjes. Kufizimet tjera (me përjashtim kur është fjala për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg mbi 3 vjet) nuk ekzistojnë.

Ky kusht i dytë i caktuar me Konventën në interes të drejtësisë nuk është inkorporuar në dispozitën e Ligjit tonë për procedurë penale.³² Ky kusht është shumë i rëndësishëm ngase gjykata do ta ketë parasysh aftësinë e të akuzuarit që në mënyrë adekuate ta prezantojë rastin pa ndihma.³³

Sipas analizës, vetëm në 7 lëndë i akuzuari shfrytëzon të drejtën e ndihmës juridike falas.

Komunikimi ndërmjet të akuzuarit dhe mbrojtësit. PIsH ligji federativ për procedurë penale në nenin 74 paragrafi 2 e autorizonte thjesh gjykatësin hetus për mbikqyrje në komunikimin me shkrim dhe në atë gojor ndërmjet të akuzuarit që është në paraburgim dhe mbrojtësit, derisa të përfundojë hetimi. Sipas ligjit të ri për procedurë penale (1997) me të akuzuarin i cili është në paraburgim ose në burg për shkak të gjykimit, mbrojtësi mundet *lirisht dhe pa mbikqyrje të mbajë korespondencë dhe të bisedojë*(neni 70 i LPP). *Në përputhje me këtë ligj vetëm në raste të veçanta, gjatë hetimit, kjo e drejtë mund t'i nënshtrohet mbikqyrjes nëse paraburgimi është caktuar për shkak të rezikut nga korrupcioni (neni 184, paragrafi 2 pika 1).*

Rekomandim:

Është i domosdoshëm saktësimi (në kuptim të ish nenit 74 paragrafi 2 të LPP) se urdhër për këtë mund të japë vetëm gjykatësi hetimor dhe se vetëm ai, në raste të tilla është i autorizuar ta kontrollojë korespondencën me shkrim, përkatësisht të marrë pjesë në bisedën, e jo dikush tjetër.

Theksimi i arsyeve për të cilat, me përjashtim, mund të zbatohet një kontrollë i këtitllë, ka për qëllim të pamundësojë që të njejtit kufizim ti nënshtrohet edhe ai i akuzuar, kundër të cilit paraburgimi aspak nuk është caktuar për shkak të rezikut nga koluzioni. Nryshimet kishin për qëllim që mundësia e mbikqyrjes të vendoset në mënyrë restriktive që të shmanget shfrytëzimi i panevojshëm i tij në praktikë, e në dëm të së drejtës të të drejtave të mbrojtjes. Me këtë rast krejtësisht logjike dukej që mundësia e këtitllë të parashihet vetëm në rastet kur ekziston mundësia që të ndikohet në deklaratat e të bashkëakuzuarve ose dëshmitarëve ose në mënyrë tjetër të shpërdoren kontaktet me mbrojtësin për t'i fshehur dëshmitë dhe për të penguar hetimin. Megjithatë, analiza e praktikës së vendosur me Konventën evropiane për të drejtat e njeriut tregon dobësi të caktuara të një zgjidhjeje të tillë që u morrën parasysh gjatë përpilimit përfundimtar të tekstit të ligjit.

Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut në mënyrë të prerë nuk garanton të drejtën e komunikimit të papenguar me mbrojtësin sipas zgjedhjes vetiake. Sidoqoftë e drejta e këtitllë mund të nxjerret nga neni 6(3)(b) dhe (v), dhe kjo e drejtë njihet edhe në neni 93 të rregullave minimale standarde për veprimin me të burgosurit, të përfshira në rezolutën (73) 5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës dhe në nenin 3.2 të Marrëveshjes Evropiane që ka të bëjë me personat që marrin pjesë në procedurat në Strazbur.

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut konkludon se “e drejta e të akuzuarit të komunikojë me mbrojtësin e vet pa e dëgjuar këtë bisedë personi i tretë është pjesë e

³² Në Ligjin për procedurë penale të Serbisë, neni 71 krahas kushteve që i akuzuari të mos ketë mjete për pagesën e mbrojtësit dhe të bëhet fjalë për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg mbi 3 vjet, është theksuar edhe “...në rastet tjera kur këtë e kërkojnë interesat e të së drejtës”.

³³ Në rastin Hoang kundër Francës, Gjykata ka vendosur se në rastet kur bëhet fjalë për çështje të ndërlikuara, kurse i akuzuari nuk e ka stërvitjen e nevojshme juridike për mbrojtje cilësore dhe atëherë kur vetëm avokati ka aftësi të përgatisë rastin, në interes të së drejtës në mënyrë zyrtare caktohet që rastin ta marrë avokati (Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut).



kërkesave themelore për gjykim të drejtë në shoqërinë demokratike dhe kjo rrjedh nga neni 6(3)(v). Nëse avokati nuk mund të këshillohet me klientin dhe të marrë instruksione të besueshme prej tij pa një mbikqyrje të tillë, mbrojtja e tij do të humb shumë nga dobia e vetë, ndërsa Konventa është paramenduar që të sigurojë të drejta të cilat janë praktike dhe efikase". Që të shmanget shfrytëzimi ekstenziv i autorizimit ligjor për mbikqyrje të komunikimeve ndërmjet të akuzuarit në paraburgim dhe mbrojtësit (kjo vërtetë të jetë me *përrjashtim*), por edhe për të siguruar përputhshmëri me praktikën e gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut dukej e arsyeshme dispozita e nenit 70 të LPP të plotësohet me "e ekziston dyshim i bazuar se i akuzuari do të mundej ta shpërdorë komunikimin me mbrojtësin", që do të duhet të dëshmohet dhe arsyetohet në rrethanat e çdo rasti konkret. Në këtë mënyrë, e në përputhje me praktikën e vendosur në Strazbur, kufizimet eventuale në këtë drejtim nuk do të mund të imponohen automatikisht në të gjitha rastet në paraburgim të caktuar për shkak të rezikut nga koluzioni. Komiteti i Këshillit të Evropës për prevencë nga tortura megjithatë konsideron se rregullativa e këtillë nuk është në përputhje me standardet evropiane, dhe për habinë tonë, i citon aktgjykimet e njejtja.

Procedura civile

Përfaqësimi i drejtë i palëve gjatë procedurës është njëri nga standardet e rëndësishme për të cilat gjykata duhet të ketë kujdes sipas detyrimit zyrtar. Në të vërtetë, gjykata gjatë tërë procedurës është e obliguar të ketë kujdes që personi juridik i cili është palë në kontest të jetë i përfaqësuar nga personi i autorizuar në byzë të statutit, ose në bazë të ligjit. Poashtu, gjykata ka për obligim që gjatë tërë procedurës të ketë kujdes vallë pala e paaftë në ndërgjygjësi a përfaqësohet nga përfaqësuesi i saj ligjor dhe vallë a ka nevojë për autorizim.

Gjykata gjatë tërë procedurës duhet të kujdeset vallë personi që ka person të autorizuar ka autorizim për përfaqësim dhe a mundet të paraqitet si person i autorizuar. Nëse gjatë procedurës gjykata konstaton se ka mangësi në përfaqësimin e palës, ai është i obliguar të ndër marrë masa përkatëse.

Analiza e pyetësorëve në pyetjen vallë palët a kanë pasur autorizues dhe vallë a kanë qenë ata avokatë kanë dhënë këta rezultate:



Gjatë analizës së të dhënave të lartshënuara me plotë të drejtë mund të përfundojmë se edhe akuzuesi edhe i akuzuari në të shumtën e rasteve kanë qenë të përfaqësuar gjatë gjyqimit në gjykatë nga person i autorizuar, i cili në të shumtën e rasteve ka qenë avokat. Kjo tregon se palët duan të jenë të përfaqësuar nga persona të autorizuar të kualifikuar-avokatë, që është krejt e kuptueshme dhe shumë mirë.

Sa i përket pyetjes për ndihmë juridike falas, ajo si institut nuk parashihet në procedurën civile³⁴, e poashtu nuk është qartë e definuar në Konventën evropiane për të drejtat e njeriut³⁵.

³⁴ Prej vendeve të Evropës Qëndrore-Lindore, në Hungari, Lituani, Poloni, Rumani dhe Sllovaki caktimi i ndihmës juridike falas në procedurat civile është një nga mekanizmat për lehtësim të qasjes ndaj gjykatës për

E vetmja gjë që parasheh ligji për procedurë ndërgjygjësuese e që ka të bëjë me ndihmën falas, është në përputhje me nenin 160- kur pala në tërësi lirohet nga pagesa e harxhimeve të procedurës, gjykata e shkallës së parë me kërkesë të saj do të caktojë person të autorizuar që ta përfaqësojë, nëse kjo është e domosdoshme³⁶ për shkak të mbrojtjes së të drejtave të palës. Pala së cilës i është caktuar person i autorizuar lirohet nga pagesa e harxhimeve faktike dhe shpërblimit për personin e autorizuar që i ka caktuar gjykata. Si person i autorizuar caktohet avokat, por nëse në selinë e gjykatës nuk ka avokatë të mjaftueshëm atëherë person i autorizuar mund të jetë një person tjetër me përgatitje juridike, i aftë që të japë ndihmën e nevojshme juridike.

Nëse vendimi për lirim ka qenë i shfuqizuar për shkak se është konstatuar se pala është në gjendje t'i paguajë harxhimet e procedurës, ajo obligohet që t'i paguajë edhe shpërblim. Nëse bëhet fjalë për shtetas të jashtëm, shfuqizimi mund të jetë pasojë e moskzistimit të reciprocitetit.

Në përputhje me nenin 161 nga LPN- kur pala është tërësisht e liruar nga pagesa e harxhimeve të procedurës, nga mjetet e gjykatës do të pagohet avans për harxhimet e dëshmitarëve, ekspertëve, për këqyrje dhe për botimin e shpalljes gjyqësore, si dhe harxhimet faktike të personit të autorizuar që është caktuar. Taksat gjyqësore dhe harxhimet bëjnë pjesë në harxhimet ndërgjygjësuese.

Nëse pala e liruar e humb ndërgjygjësinë, gjykata nuk do t'i paguajë harxhimet. Nëse fiton ndërgjygjësinë ajo duhet të paguajë avansin dhe harxhimet e vërteta të personit të autorizuar.

10. E drejta e ankesës

Procedura penale

Çdonjëri që është dënuar për ndonjë vepër penale ka të drejtë ligjore të kërkojë rishqyrtimin e aktgjykimit dhe të dënimit në një gjykatë më të lartë (neni 14 paragrafi 7 i PNDKP, protokollu 7 i KEDNJ). E drejta për ankesë ka për qëllim që të sigurojë të paktën 2 instanca të shqyrtimit gjyqësor të ndonjë rasti, me ç'rast i dyti duhet të zhvillohet në gjykatë të instancës më të lartë. Rishqyrtimi, që e bën ajo gjykatë, duhet të jetë autentike. Kjo don të thonë se, mes tjerash, procedura e ankesës që kufizohet vetëm me shqyrtimin e çështjeve juridike, nuk do ta kënaq këtë kriter gjithmonë. Procedura e ankesës, përveç kësaj, duhet të zhvillohet në kohë.

Sipas ligjit për procedurë penale, pas shpalljes së aktgjykimit kryetari i këshillit do t'i informojë palët për të drejtën e ankesës si dhe për të drejtën për t'iu përgjigjur ankesës.

I akuzuari në 17,9% të lëndëve të vëzhguara ka qenë i informuar për të drejtën e ankesës. Sipas analizës së gjykimeve të vëzhguara nuk janë vërejtur shkelje të kësaj të drejte.

ato që nuk kanë mjetet e mjaftueshme materiale. Në Bullgari dhe Llatvi si dhe në vendin tonë, në procedurat civile është paraparë vetëm lirimi nga pagesat e taksave gjyqësore si mekanizëm.

³⁵ Irlanda ofron ndihmë juridike falas vetëm në procedurat penale por jo edhe në ato civile (Airey v. Ireland)

³⁶ Domosdoshmërinë gjykata e përcakton duke u nisur nga ajo se vallë pala a ka ndonjë njohuri rreth drejtësi, vallë zhvillon padi të ndërlikuar për të cilën i duhet ndihmë nga eksperti, rëndësia e lëndës së kontestit për palën e kështu me radhë

Procedura civile

Në pajtim me LPN kundër vendimeve jo fuqiptotë të gjykatave që janë sjellë në shkallën e parë, pala e pakënaqur mund të parashtojë ankesë. Ankesa parashtrohet në gjykatën e shkallës së dytë përmes gjykatës e cila ka marrë vendimin në shkallën e parë, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i vendimit, e kundër vendimeve të marra në procedurat e veçanta ndërgjyqësuese afati ankesës është tetë ditë.

Sipas të dhënave të mara nga lëndët e vëthguara vetëm në 17 lëndë është parashtruar ankesë. Ky numër i ulët i ankesave të parashtruara nuk është rezultat i asaj se palët janë të kënaqura me aktgjykimet gjyqësore që i kanë sjellë gjykatat, por është rezultat i asaj që gjykatat gjatë periudhës së vëzhgimit, prej gjithsej 720 lëndëve kanë sjellur vetëm 89 aktgjykime.

KREU 3 Funksionimi i gjyqësisë

1. Shpërndarja e lëndëve

Në lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen e pavarësisë, paanësimit dhe kompetencës së gjyqësisë³⁷, është çështja lidhur me mënyrën dhe metodën e dhënies së lëndëve për vendimmarje tek ndonjë gjykatës ose këshill.

Për këtë çështje tejet drejtpërdrejt shprehet parimi 14 i “Parimeve Themelore për pavarësinë e gjyqësisë në” Kombet e Bashkuara. Sipas këtyre parimeve, *në çdo sistem gjyqësor, në administratën e tij duhet të ketë rregulla qartë të definuara për organizimin e lëndëve mes gjykatësve apo këshilleve gjyqësore.*

Kjo çështje është aq serioze sa Parimet për pavarësinë e gjyqësisë në OKB, shkeljen e këtij parimi e caktojnë si bazë për shkarkimin e gjykatësve, respektivisht dënimin e punëtorit administrativ i cili manipulon me lëndët në këtë bazë.

Çështja e orarit të lëndëve në gjykatat bëhet sipas numrave për çdo gjykatës me orarin vjetor për punë të gjykatësve. Kryetari i gjykatës, fillimisht cakton sipas profesionalizmit të gjykatësve, për atë se cili gjykatës në cilën sferë do të punojë, e pastaj gjykatësit e sferës së njëjtë marin numër sipas të cilit i marin lëndët në punë. Në të vërtetë, lëndët më së shpeshti

³⁷ Shiko kreun 2 pika 2

shpërndahen me rastësi rendit të parashtrimit të padive në gjykatë. Çdo lëndëje të marë i jepet një numër, e në këtë mënyrë shpërndahen lëndët nëpër gjykatës.

Problemi i shpërndarjes së lëndëve gjatë analizës e identifikuaam përmes dy aspekteve: së pari, ndikimi i administratës në dhënien e lëndëve, që shpeshherë mund të jetë burim i koropcionit në gjykatë. Vetë fakti se sekretaria gjyqësore është ajo që cakton numrat, ekziston mundësia e keqpërdorimit të vetë procesit.³⁸

Nga ana tjetër, Kryetarët e gjykatave kanë të drejtë diskrecione që lëndë të caktuara ti japin cilido gjykatës në gjyktë.

Rekomandim:

Zgjidhjet duhet kërkuar në dy drejtime: me Ndryshimet ligjore në Ligjin për Organizimin e gjyqësisë- norma të fuqishme precize për atë se si bëhet evidentimi i orarit të lëndëve si dhe kush është i përgjegjshëm për këtë. E dyta, edukim profesional, moral dhe etik për gjykatësit në përputhje me Kodin Gjyqësor Etik. Shkelja e këtyre rregullave duhet të jetë bazë për shkarkimin r gjykatësit, që është në përputhje me rregullat ndërkombëtare për gjyqësi të pavarur.

2. Përgatitja e lëndëve

Përgatitja e lëndëve është çështje e pastër metodologjike, specifike për çdo organ dhe çdo fazë të procedurës. Ajo është çështje që në mënyrë përkatëse është zgjidhur në Rregulloren Gjyqësore, edhe pse ka nevojë që të analizohet dhe adoptohet për kushtet e reja të punës, ingerencat dhe gjendjet e reja të çdo organi fuqiptotë, si dhe të caktohet qasje e re profesionale kah zbatimi i tij.

Rekomandim:

Nëse Rregullorja Gjyqësore ndërrohet me Ligj për organizimin e gjyqësisë, metodologjia e punës do të fitojë rëndësi më të madhe, do të zmadhohet përgjegjësia dhe dicitplina gjatë zbatimit të rregullave të përmbajtura në Ligjin.

Në të vërtetë, parashtrrohet pyetja se sa gjykatësit vijnë të përgatitur në diskutime/shqyrtime, me përgatitje të mëhershme të lëndëve, analizimin e tyre dhe kontrole të mëparshme në pikëpamje të dorëzimit dhe sigurisë së dëshmimeve të cilat do të jenë lëndë e vlerësimit dhe shqyrtimit në vetë diskutimin/shqyrtimin?

Që të mundet procedura të rrjedhë në mënyrë normale, ekspeditive, ligjore dhe efikase është e domosdoshme që gjykatësi që gjykon të bëjë veprime të caktuara përgaditore:

³⁸ Sipas Judicial Reform Index të ABA/CEELI (American Bar Association's Central and East European Law Initiative) të nëntorit të vitit 2003, sipas të intervistuarëve, lëndët nuk ndahennë mënyrë objektive. Për shembull, kur dorëzohen më tepër padi për një periudhë më të shkurtër, ato mund të shpërndahen në mënyrë që të arrihen rezultatet e dëshiruara. Ndonjëherë lëndëve u vëhet numër pasi ti jepen gjykatësit. Akuzuesit si një nga problemet e objektivizimit gjatë shpërndarjes së lëndëve, e kanë theksuar problemin e shpërndarjes së lëndëve për vepra të rënda penale gjykatësve të cilët nuk kanë përvojë të duhur në atë sferë.

- ta caktojë shqyrtimin/diskutimin kryesor në përputhje me vlerësimin e tij se sa kohë do të zgjaste procedura në përputhje me afatet ligjore;
- të sigurojë praninë e palëve përmes thirrjes, të kontrollojë se a është bërë thirja në rregull, të ndërmarë masa të duhura që të mos ndodh shtyrja e seancës;
- të verifikojë se a i ka në disponim gjykata dëshmitë dhe të bëjë shikimin e tyre;
- të verifikojë se a janë të nevojshme ekspertizat dhe të jap urdhër për ato, sa më shpejt të përfundojnë dhe të merret rezultati dhe mendimi i ekspertëve;
- të zgjidh çështjet e sigurimit të opinjonit në procedurë dhe çështje të tjera që duhet ti zgjidh gjykatësi.

3. Sistemi i zhvillimit të lëndëve

Zhvillimi i lëndëve gjyqësore ka shumë aspekte dhe ky është një aktivitet administrativ procesesh që e kryejnë shërbime të shumta në gjykatë. Ndërkaq, zhvillimi i lëndëve sipas rregullave të caktuara të proceseve dhe administrative e siguron mënyrën efikase dhe ekspeditive të gjykatësve në zgjidhjen e lëndëve, në shfrytlizimin e suksesshëm të përfshirë në lëndë dhe mbrojtjen e materialit nga vjedhjet, shkatërimi dhe nga dukuritë e tjera të pavolitshme të cilat e bëjnë dosien (lëndën) të jetë jo e plotë dhe e papërshtatshme për të vendosur. Në praktikën gjyqësore të caktuar tani, çështjet lidhur me zhvillimin e lëndëve, ishte zgjedhur me rregulloren gjyqësore dhe puna e tërësishme i është besuar administratës gjyqësore.

Rekomandim:

Kompjutorizimi i punës së gjykatave duhet të kontribuojë që puna e gjykatësit dhe të gjitha veprimet e procesit që dalin prej saj, të përpunohet, evidentohen dhe të futen në kompjutorë (dosie kompjutorike) që e punon. Në këtë mënyrë krijohet mundësia që përmes kompjutorit, gjykatësi ta ketë dosien pranë vetes dhe gjithmonë të mund ta përdorë gjatë përgatitjes për punë ose gjatë vetë punës rreth asaj lënde. Dosia e përgatitur kështu (e përpunuar në kompjutor) i ndihmon gjykatësit në punën e tij por edhe siguron një shikim të plotë në atë që ndodh, si dhe atij që bën shikimin e dosies, i cili e shfrytëzon dhe për çfarë qëllimesh si dhe sigurohet një shkallë e lartë e mbrojtjes së vetë dosies.³⁹

Pjesa e dytë e sistemit për zhvillimin e dosjeve është ajo që realizohet në sekretarinë gjyqësore, e cila hapet pas pranimit të padisë, denoncimit penal ose ndonjë parashtrere tjetër, si dhe në mënyrë të shkruar nga ndonjë organ shtetëror ose organ tjetër ose qytetar me çka inicohet procedurë gjyqësore. Administrata gjyqësore e mban dosjen, e rregullon dhe plotëson rregullisht me materiale të reja që vijnë si rezultat i veprimeve të procesit nga gjykata apo ndonjë organ tjetër që ka detyrime në lidhje me lëndën. Këto vendime të procesit si dhe librat gjyqësore ku ato regjistrohen, mbahen evidenca gjyqësore, janë të rregulluara dhe të përshkruara me rregulloren gjyqësore.

Rekomandim:

Sistemi i ruajtjes dhe përpunimit kompjutorik të dosjeve gjyqësore duhet ta përfshijë edhe këtë proces. Për këtë nevojitet të përgatiten programe kompjutorike të

³⁹ Zbatimi i sistemit të teknologjisë kompjutorike në gjykata është njëra nga ndryshimet e parapara me Strategjinë për reforma në gjyqësi.

cilat do të kenë metodologji të unjisuar të ruajtjes së dosjeve gjyqësore dhe të mundësojë komunikim lidhur me dosjet e të gjitha gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë dhe në tërë shtetin. Me sjelljen e sistemit për teknologji informatike, njëherit duhet të punohet edhe në programet për përpunimin e të dhënave nga dosjet.

Sistemi kompjutorik, gjyqësisë duhet t'ia zgjidh edhe problemin e komunikimit të rregullt me organet e tjera shtetërore të të gjitha niveleve.

4. Caktimi i seancave

[Sa i përket caktimit të seancave, gjatë analizës së pyetësorëve janë vërejtur situata të caktuara të cilat tregojnë jodisiplinën e gjykatësve.

Në vetë pyetësorët ka situata kur seancat e caktuara **nuk fillojnë në kohën e caktuar**.

Në lëndën penale e cila mbahet në gjykatën themelore në Veles për vepër penale Dhuna, nga neni 386 i KP të cilën vëzhguesit e ndjekin në kontinuitet dhe e kanë ndjekur në 8 seanca të deritashme, është vërejtur vonesë e vazhdueshme e fillimit të diskutimeve madje edhe prej 30 minutash.

Kjo vonesë e fillimit të gjykimeve shpesh herë ka të bëjë me faktin se **në të njëjtën kohë caktohen më tepër gjykime**⁴⁰.

Në Gjykatën themelore Shkupi 1 gjykimi për vepër penalëe Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit , sipas nenit 353 paragrafi 3 i KP, që është shtyrë 10 herë, ka filluar në 8:45 në vend që të fillojë në 8 e 30 minuta, sepse në këtë termin kanë qenë të caktuara 2 gjykime.

Ndërkaq, është vërejtur edhe situatë kur gjykimi ka filluar dhe ka përfunduar edhe **para kohës së caktuar**, me ç'rast poashtu pason shtyrja e gjykimit.

Në Gjykatën themelore Shkup 1 shqyrtimi kryesor për vepër penale shpifje , sipas nenit 172 paragrafi 3 i KP, ka filluar dhe ka përfunduar me shtyrje para kohës së caktuar. Vëzhguesit kanë qenë para gjykatores kur ka arritur i akuzuari, i cili është njoftuar për shtyrjen.

Këto të dhëna tregojnë edhe për disiplinën e vetë gjykatës që tu përmbahen termineve saktësisht të caktuara për mbajtjen e seancave.

5. Procesverbalet

Për veprimet gjyqësore që ndërmerren gjatë procedurës, shqyrtimit apo seancësta dhe njoftime më të rëndësishme të palëve ose pjesëmarrësve të tjerë, deklaratat që i japin ato, jashtë shqyrtimit apo seancës si dhe për veprime të tjera të gjykatës kur ajo caktohet me dispozita të veçanta, përpilohet procesverbal.⁴¹

⁴⁰ Sipas nenit 135 paragrafi 2 i Rregullores së gjykatës, "Caktimi i shqyrtimeve dhe seancave për më tepër lëndë në orën e njëjtë nuk është e lejueshme".

⁴¹ Neni 142 i Rregullores së gjykatës

Përpilimi i procesverbaleve rregullohet edhe me Ligjin për procedurë penale, neni 75-82 si dhe me ligjin për procedurë ndërgjyqësuese, neni 112 – 117.

Në procesverbal duhet të regjistrohen të gjitha veprimet e ndërmarra gjatë shqyrtimit kryesor/ diskutimit kryesor. Ai paraqet dëshmi për veprimet e kryera të procesit gjyqësor, palëve dhe pjesëmarrësve tjera në procedurë të regjistrohen në të dhe i përmban të gjitha karakteristikat e dokumentit publik. Gjatë vëzhgimit të seancev gjyqësore nga vëzhguesit janë vërejtur lëshime të caktuara në mbajtjen e procesverbalit.

Sipas ligjit për procedurë ndërgjyqësuese, (neni 115 paragrafi 2), alët kanë të drejtë të lexojnë procesverbalin ose të kërkojnë t’u lexohet si dhe të kundërshtojnë në përmbajtjen e procesverbalit.

Sipas analizës së seancave të vëzhguara, në 579 seanca palët nuk kanë pasur kundërshtim ndaj procesverbalit, kurse në 7 seanca ato kanë kundërshtuar përmbajtjen e tij.

Në **procedurën civile**, shikim në procesverbalet si dhe në shkresat e lëndës kanë të drejtë palët, personat e autorizuar dhe përfaqësuesit ligjor. personave të tretë u nevojitet leje e veçantë për shikimin dhe përshkrimin e procesverbaleve. Këta persona mund të marrin leje për shikim dhe përshkrim të procesverbaleve vetëm nëse kanë interes të arsyeshëm që duhet ta dëshmojnë, kurse vërtetësinë e këtij interesi e vlerëson gjykata. Lejen e jep Kryetari i Këshillit, respektivisht gjykatësi individ nëse procedura është në zhvillim e sipër, gjegjësisht kryetari i gjykatës ose nëpunësi i gjykatës, nëse procedura ka pëfunduar. Procesverbalet nga këshilli dhe votimi është i natyrës sekrete dhe ai gjendet në papka Faksimil të veçantë në regjistrat e lëndës dhe këtë nuk kanë të drejtë ta shikojnë as palët e kontestit.

Në **procedurën civile**, personi që nuk është palë në procedurën nuk ka të drejtë t’i shikojë regjistrat e lëndës dhe procesverbalet, pos me vendim të gjykatës edhe atë vetëm nëse tregon interes të arsyeshëm për këtë.

Me analizën e mendimit të vëzhguesve është konstatuar se në gjykata u është siguruar qasje e papenguar dhe shikim në regjistrat e lëndës, kurse gjykatësit kanë qenë të hapur për bashkëpunim dhe dhënie të informatave të duhura.

6. Vendime gjyqësore

Gjykatësi sjell vendime të paashme në bazë të vlerësimit të tij të lirë të dëshmive dhe zbatimit të ligjit. Gjatë vendimmarrjes nuk mundet të bëhen çfarëso kufizimesh, ndikimesh, motivime, shtypje, kërcënime ose përzierje të drejtpërdrejt ose tërthorazi, mbi gjykatësin nga cilido subjekt dhe për cilëndo arsye. Askush nuk ka të drejtë në asnjë mënyrë ta kufizojë apo pengojë të drejtën e gjykatësit që të shpall vendimin lirisht (neni 14 i rregullores gjyqësore).

Kërcënim serioz për paanësinë e vendimeve të gjykatësve mund të jetë korupcioni, ndikimi i partive politike dhe i interesave personale.

Në Judicial Reform Index të ABA/CEELI (American Bar Association’s Central and East European Law Initiative) të nëntorit të vitit 2003, është theksuar se “Stejt departamenti amerikan në hulumtimin e vet për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë ka

përfunduar se gjyqësia në bazë është e dobët dhe nën ndikim të shtypjes politike dhe korupcionit, pjesërisht si rezultat i rrogave të uklëta; megjithatë, nuk ekzistojnë raporte për përhapjen e shpërdorimit ose korupcionit sistematik".

Mirëpo, nga gjykimet e vëzhguara, në pajtim me vlerësimin e vëzhguesve, nuk ka pasur dyshim me bazë për paanësinë e gjykatësit.

7. Kodi etik

Në vitin 1994 shoqata e gjykatësve të Republikës së Maqedonisë pranoi Kodin etik për gjykatësit ku përmbahen dispozitat që nuk janë të obligueshme, por më tepër paraqesin parime dhe udhëzues për punën e gjykatësve. Paralelisht me këtë, Këshilli gjyqësor Republikan ka sjellur më tepër dokumente në lidhje me zgjedhjen dhe përgjegjësinë e gjykatësve, ku përmbahen shumë elemente dhe përcaktime nga Kodi etik gjyqësor. Këshilli gjyqësor republikan së bashku me shoqatën e gjykatësve ka organizuar më tepër diskutime profesionale lidhur me zbatimin e kodit gjyqësor etik.

Ndërkohë janë nxjerrë shumë dokumente ndërkombëtare me të cilat u bë krye ndryshimi dhe përparimi i normave të kodit gjyqësor. Qasjet e reja drejt pozitës së gjykatësve dhe gjykatave në shoqëri imponuan norma të reja të sjelljes, obligime të reja dhe kërkesa të reja para gjykatësve.

Rekomandim:

Është e domosdoshme që Shoqata e gjykatësve ose Këshilli gjyqësor republikan ti rikthehen kodit gjyqësor, ta plotësojnë, ndryshojnë dhe ta përparojnë. Pastaj do të ishte e domosdoshme të kryhet një edukim i plotë i gjykatësve në Maqedoni lidhur me përmbajtjet e kodit gjyqësor, për llojin, natyrën dhe karakterin e shkeljeve të kodit.

Kodi etik nuk përmban masa detyrimi por më tepër paraqet përmbledhje normash morale me të cilat duhet të sigurohet gjyqësi e pavarur dhe e paanëshme.⁴²

Në përputhje me kodin etik, gjykatësit nuk guxojnë të japin këshilla juridike, përveç rasteve kur këtë e kërkon ligji, nuk guxojnë të kryejnë punë që janë jashtë funksionit të gjykatësit, e të cilat mund të diskreditojnë pavarësinë e tyre dhe duhet tu largohen aktiviteteve të biznesit përveç atyre që kanë të bëjnë me pronën e tyre.

Dispozita të domosdoshme për etikën gjyqësore nuk ekzistojnë në Republikën e Maqedonisë.


Mirëpo, Ligji për gjykatat përmban dispozita të shumta lidhur me etikën gjyqësore. Në të vërtetë, gjykatësit nuk guxojnë të marrin peshqeshe nga palët ose personat të cilët drejtpërdrejtë ose tërthorazi kanë interes në gjykimin⁴³ Më tutje, gjykatësi nuk mund të ushtrojë çfarëdo funksioni ose profesioni tjetër publik, përveç funksioneve tjera të caktuara

⁴² Në përputhje me nenin 12 të Kodit etik "Ekziston përgjegjësi morale e gjykatësit që t'i zbatojë këto parime, T'i përmirësoj dhe t'i përparojë ato si dhe të jetë model se si tjerët duhet tu përmbahen atyre". Sipas nenit 13 "gjykatësi ka përgjegjësi morale nëse i shkel parimet e këtij kodi".

⁴³ Neni 54 i Ligjit për Gjykatat

me ligj⁴⁴ dhe nuk mund të jetë anëtar dhe të ushtrorë funksion politik në ndonjë parti politike ose të kryejë aktivitete partiake dhe politike⁴⁵.

Gjykatësit me Ligjin e gjykatave obligohen të mbajnë veshje të veçantë gjyqësore (TOGA), me të cilën dallohen nga pjesëmarrësit tjerë në procedurat e gjykimit. Prej seancave të vëzhguara në procedurën civile dhe atë penale, përgjigja në pyetjen se vallë gjykatësi ka mbajtur Toga, jep pasqyrën që vijon:



8. Shkarkimi dhe përgjegjësia disiplinore e gjykatësve

Në përputhje me Ligjin e Këshillit gjyqësor republikan, Këshilli gjyqësor republikan (KGJR) propozon shkarkimin e gjykatësit nëse ai këtë e ka kërkuar vetë, nëse i plotëson kushtet për pension ose në rastet kur është i dënuar për vepër penale me dënim pa kusht-burgim prej së paku 6 muaj. Më tutje KGJR jep propozim për shkarkim prej funksionit të gjykatësit dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë i propozon shkarkim të gjykatësit kur plotësohet ndonjë kushteve të parapara me Kushtetutë, me anë të procedurës dhe sipas mënarës që i parashihet ky lig: nëse përgjithmonë humb aftësinë psiko fizike për kryerjen e funksionit të gjykatësit; për shkak të kryerjes së funksionit të gjykatësit në mënyrë jo profesionale dhe të pandërgjegjshme dhe për shkak të ndonjë shkeljeje më të rëndë, të paraparë me ligj, e cila e bën jo të denjë për kryerjen e funksionit të gjykatësit.

Gjykatësi mund të jetë i shkarkuar nga funksioni i gjykatësit nëse kryen shkelje më të rëndë disiplinore, të përcaktuar në bazë të kriterëve objektive.

Kriteret objektive me të cilat verifikohet shkelja e kryer nga gjykatësi janë përfshirë, para së gjithash, në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë si dhe në Ligjin e gjykatave.

Në të vërtetë, në përputhje me Ligjin e gjykatave, neni 69, shkelje të rënda disiplinore llogariten:

- prishja e rëndë e rendit dhe qetësisë publike me çka shkellet autoriteti i tij dhe i gjykatës
- aktivitetet partiake dhe politike
- kryerja e funksionit ose profesionit publik

⁴⁴ Neni 50 paragrafi 2 i Ligjit për gjykatat

⁴⁵ Neni 50 paragrafi 6 i Ligjit për Gjykatat

- nxitja e prishjes së rëndë të marrëdhënieve në gjykatë që dukshëm ndikojnë në kryerjen e funksionit të gjykatësit, dhe
- cënimi i rëndë i të drejtave të palëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurën me çka shkilet autoriteti i gjykatës dhe i funksionit të gjykatësit⁴⁶.

Ndërkaq, këto zgjidhje që i përmban Ligji i gjykatave në aspekt të disa llojeve të shkeljeve disiplinore nuk paraqesin zgjidhje të tërësishme.

Rekomandim:

Është e domosdoshme që në ligjin e gjykatave të nis rregullimi i plotë dhe i hollësishëm i çështjeve përkitazi me përgjegjësinë disiplinore të gjykatësve.

Këshilli gjyqësor republikan vetëm propozon shkarkimin e gjykatësit nga kryerja e funksionit të gjykatësit. Sipas Kushtetutës, vendimin e merr Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

Propozim për zhvillimin e procedurës për verifikimin e përgjegjësisë disiplinore të gjykatësit, mund të paraqesë kryetari i gjykatës, kryetari i gjykatës më të lartë dhe seanca e përgjithshme e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë.

Për shqyrtimin e propozimeve të këtilla Këshilli gjyqësor republikan grumbullon të dhëna nga Ministria e drejtësisë, në pikëpamje të rezultateve të arritura, numrit të lëndëve të zgjidhura, cilësisë dhe azhuritetit në punën e gjykatësit. Procedura është e mbyllur për opinionin, kurse gjykatësi ka të drejtë t'i përgjigjet akuzave. Pati të përfundoi hetimi, nëse dy të tretat e Këshillit gjyqësor republikan kanë votojnë për shkarkimin e gjykatësit, lënda i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të marrë vendimin⁴⁷.

Gjatë kohës së hetimeve gjykatësi mund të jetë i suspenduar nga ushtrimi i detyrës së gjykatësit.

9. Paisje zyresh dhe me kompjutorë

Me programin (Strategjia për reformën në gjyqësi) me të cilin parashihet ndërtim i sistemit informatik duhet të zgjidhet edhe problemi i kompjutorizimit të gjykatave. Për këtë tanimë ekzistojnë programe të FARE-s dhe KARDS-it me të cilin parashihet instalimi i paisjes kompjutorike që është në procedurë.

⁴⁶ Këshilli gjyqësor Republikan me dispozitat numër 08-238/2 aneksi A,B, definojnë se çka paraqet sjellje joetike dhe joprofesionale (shtyrje të shpeshta dhe të panevojshme të gjykimeve, veprime me të cilat gjykatësi tregon interes për njërin nga palët, mosrespektimi i parimit të pavarësisë, pranimi i peshqesheve ose i shpërblimeve si dhe rënia nën ndikime të jashtme, pakujdesia ndaj ligjeve të reja dhe vendimeve të gjykatave më të larta dhe të ngjashme). Judicial report Index, ABA/CEELI (American Bar Association's Central and East European Law Initiative), November 2003

⁴⁷ Në maj të vitit 2004, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë shkarkoi 3 gjykatës për shkak të punës së pandërgjegjësme edhe atë një gjykatës të gjykatës themelore në Kumanovë dhe 2 gjykatës të Gjykatës themelore në Strumicë. Në korrik të vitit 2004, Gjykata themelore në Strumicë solli aktgjykim për marrje të mitos dhe dënoi gjykatësin e akuzuar me burg në kohëzgjatje prej 1 vjet e 3 muaj.

Në pikëpamje të paisjes së gjykatave me kompjutorë mungesave teknike për atë paisje, situata në disa gjykata është si vijon:

Gjykata themelore Shtip- Gjykatoret, zyrat e gjykatësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë dhe sekreteritë janë të paisura me kompjutorë, vetëm seksioni i pranimit nuk ka kompjutor.

Gjykata themelore Radovish- Në zyrat e gjykatësve dhe në gjykatore ka kompjutorë, vetëm mungojnë kompjutorët në sekreteritë.

Gjykata themelore Strumicë- Në gjykatore më parë ka pasur kompjutorë dhe sistem të rrjetit kompjutorik por i njëjti është hequr dhe kompjutorët janë dërguar në zyrat e gjykatësve

Gjykata themelore Koçan- Vetëm disa zyra kanë kompjutorë

Gjykata themelore Shkup 2- Në çdo gjykatore ka nga një kompjutor dhe printer, poashtu nga një kompjutor dhe printer ka për çdo daktilograf në byronë e daktilografëve. Meqë në këtë gjykatë ekziston byroja e daktilografëve dhe daktilografët nuk janë në zyrë së bashku me gjykatësin, nëpër zyrat e gjykatësve nuk ka kompjutor.

Gjykata themelore Negotinë- Kompjutorë ka vetëm në zyrat e gjykatësve por jo edhe nëpër gjykatore.

Gjykata themelore Manastir- ka kompjutorë por përdoren paralelisht me makinat e shkrimit

Në gjykatoret tjera paisja me kompjutorë është në nivelin e kënaqshëm.

Rekomandim:

Kompjutorizimi i plotë i gjyqësisë do të thotë qasje më e mirë në informatat e nevojshme me çka mundësohet zbatimi i parimit të opinionit. Në të vërtetë, me ndryshimet në Ligjin e procedurës penale, në nenin 123-a është theksuar se “gjykata është e obliguar çdo ditë pune, të gjithë pjesëmarrësve në procedurën, përmes rrugës elektronike ose në mënyrë tjetër tu mundësojë qasje në evidencën për seancat e konvokuara”. Zbatimi i kësaj dispozite është i mundshëm vetëm nëse gjykatat janë të paisura me numër të mjaftueshëm të kompjutorëve dhe me përdorimin e atyre kompjutorëve në punë nga gjykatësit. Gjithashtu nevojitet edhe lidhja e kompjutorëve në një rrjetë me çka do të përmirësohet niveli i komunikimit.

Përveç paisjes me kompjutorë, për gjykatat problem i posaçëm paraqet orendia e zyrave siç janë byroja, karriket, dollapët dhe paisje tjera që janë të vjetëruara dhe duhet zëvendësuar me të reja. Me vite të tëra gjykatave nuk u janë ndarë mjete për përtrirjen e paisjes.

Rekomandim:

Është e domosdoshme të ndërtohet një program për çdo gjykatë veçmas për përtrirjen e paisjes me dinamikë të paraparë të realizimit, në përputhje me gjendjen dhe urgjencën e nevojave të gjykatave të veçanta⁴⁸.

⁴⁸ Pushtetit gjyqësor duhet t'i sigurohen mjete më moderne teknike me qëllim që të mundësohet realizimi i drejtësisë në mënyrën më efikase, veçanërisht me sigurimin e qasjes së shpejt në burimet e të së drejtës dhe kryerje e shpejtuar e vendimeve gjyqësore (parimi 9 i Rekomandimit numër (84)5 të Komitetit të ministrave të vendeve anëtare)

10. Efikasiteti i administratës gjyqësore

Që të mundën gjykatat ta kryejnë me konsekuencë dhe me efikasitet punën e tyre është e domosdoshme që të kenë numër të mjaftueshëm të bashkëpunëtorëve dhe punëtorëve administrativë. Numri i pozicioneve administrative është caktuar me rregulla që i ka sjellur Ministria e drejtësisë. Sipas këtyre rregullave gjykatat themelore duhet të kenë 2.4 të punësuar për një gjykatës përfshirë këtu edhe një daktilograf për një gjykatës dhe një bashkëpunëtor profesional për dy gjykatës.

Sipas analizës së të dhënave, në gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë kaq mesatarisht nga 3.9 punëtorë administrativë për një gjykatës që e tejkalon numrin e përcaktuar si rregull nga Ministria e drejtësisë. Një përpjestim më të madh ka Gjykata themelore në Strumicë ku ka 5.8 punëtorë administrativë për një gjykatës.

11. Ndërtesat gjyqësore dhe sigurimi

Në Republikën e Maqedonisë me vite nuk është investuar aspak në infrastrukturën gjyqësore, përveç që u ndërtua ndërtesa e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës themelore Shkup 2. Të gjitha gjykatat tjera hasen me sprovë të lokalit të punës dhe atij funksional.

Në Gjykatën themelore në Manastir filloi ndërtimi edhe i një kati të ndërtesës gjyqësore me çka do të zgjerohej.

Në Gjykatën themelore në Tetovë është duke u bërë ristrukturimi i brendshëm hapësinor i ndërtesës gjyqësore.

Si probleme sa u përket mungesave hapësinore paraqiten këto që vijojnë:

- Gjykatësit janë nëpër zyra së bashku me daktilografët dhe me personelin tjetër ndihmës, përveç në Gjykatën themelore Shkup 2 ku daktilografët nuk janë në të njëjtën zyrë me gjykatësit por ekziston byro e daktilografëve.
- Në Gjykatën themelore në Gjevgjeli, në Gjykatën themelore në Veles dhe në Gjykatë Themelore në Resnjë, në ndërtesën e gjykatës gjenden edhe zyrat e Prokurorisë themelore publike.
- Numri i pamjaftueshëm i gjykatoreve ndikon që gjykatësit të gjykojnë në zyra e veta me çka gjykimi humb esencën e vet, vetë procedura nuk mund të zhvillohet normalisht si dhe shkelet parimi i opinjonit në procedurë. Sipas analizës së të dhënave, në procedurën penale 89% të seancave janë mbajtur në gjykatore, kurse 11% në zyra, ndërsa në procedurën civile 67,7% në gjykatore dhe 33,4% në zyrë. Numri më i madh i seancave që mbahen në zyra krahasuar me seancat që mbahen në gjykatore hasen në gjykatën themelore në Vinicë, që është e kuptueshme ngase gjykata disponon vetëm me një gjykatëore kurse ka 5 gjykatës dhe numri mesatar i lëndëve arrin 15 për një ditë.

Nga ana tjetër, në Gjykatën Themelore në Sveti Nikole ka 6 gjykatës dhe 8 gjykatore, 2 prej të cilave janë të mëdha, kurse 6 të tjera janë të vogla.

Sipas analizës në të gjitha gjykatat themelore, mesatarisht, 3,5% gjykatës gjykojnë në një gjykatore. Dallimet në pikëpamje të numrit të madh të gjykatësve kundrejt numrit të vogël të gjykatoreve më karakteristike janë: në Gjykatën Themelore në Gjyvgjeli, ku ka vetëm 2 gjykatore dhe gjithsej 17 gjykatës; në Gjykatën Themelore në Koçan ku ka 3 gjykatore dhe 17 gjykatës të cilët zgjidhin mesatarisht 35 lëndë në ditë; në Gjykatën Themelore në Shtip ku ka 3 gjykatore ndërsa 24 gjykatës të cilët zgjidhin mesatarisht 16 lëndë në ditë.

- Mungesa e lokaleve të veçanta për avokatët dhe prokurorët publik, ku do të mund ta kalojnë ndërmjet dy gjykimeve. Lokale të këtuja ka vetëm në Gjykatën Themelore Shkup 2 ku ka lokal të veçantë për avokatët dhe lokal të veçantë për prokurorët, pastaj në Gjykatat Themelore në manastir, Krushevë, Veles, Kriva Pallankë, Berovë, Sveti Nikole, Kratovë, Kumanovë dhe Dellçevë.

Rekomandim :

Doemos duhet të shqyrtohet problemi i lokalit gjyqësor për punë dhe të hartohet një program afatgjytë për sigurimin e hapësirës gjyqësore në përputhje me nevojat e procesit gjyqësor bashkëkohor dhe punës së gjykatësve dhe gjykatave.

Sa i përket sigurimit të ndërtesës gjyqësore, në vitin 1996 u themelua policia gjyqësore, kurse pozita e saj është rregulluar me ligjin e gjykatave.

Në **Gjykatën Themelore në Manastir** ka nga dy persona të policisë gjyqësore në çdo etazh, të cilët përveç se kujdesen për sigurinë e gjykatës, gjithashtu i orientojnë palët sepse nuk ka lista të publikuara për gjykimet e ditës.⁴⁹

Në hyrje të ndërtesës gjyqësore janë montuar edhe detektorë për metal të cilët kontribuojnë për ritjen e sigurisë nëpër gjykata.

Sipas analizave të pyetësorëve, në procedurë penale janë vërejtur shtatë raste të prishjes së rendit në gjykatore prej të cilave vetëm në një rast është larguar personi nga gjykimi, ndërsa në procedurë civile vetëm në 4 raste. Në këto raste, nuk është fjala për ndonjë eksces më serioz dhe më së shpeshti kjo është bërë nga pjesëmarrësit në procedurë.⁵⁰

12.Financimi i Gjyqësisë

Elaborati që i paraprinte miratimit të Ligjit të Buxhetit të pavarur gjyqësore, i evidentoi të gjitha problemet lidhur me pozitën financiare dhe materijale të gjyqësisë. Me të, propozoheshin zgjidhje afatgjate dhe afatshkurtëra, fitionomia e ligjit të buxhetit gjyqësor si dhe metodologjia e hartimit dhe miratimit të buxhetit gjyqësor. Për fat të keq, shumë nga këto propozime dhe zgjidhje nuk u përfshinë në Ligjin e buxhetit të pavarur

⁴⁹ Kreu 2 pika 5

⁵⁰ "Gjykimi për vrasje u shndërua në zënkë masive ku morën pjesë afër dhjetë persona. Nuk ka persona me lëndime të rënda duke i falenderuar intervenimit të policisë gjyqësore". (Dnevniku i 12.03.2004).

gjyqësor. Ligji i buxhetit gjyqësor u miratua dhe kaloi më se një vjet nga miratimi i tij, por ende nuk ekziston metodologji mirë e përpunuar për zbatimin e tij.

Ekzistojnë disa arsye për këto situata:

E para, Pushteti ekzekutiv nuk tregon mirëkuptim për problemet e gjyqësisë dhe nuk ndërmerr masa konkrete për zbatimin e ligjit;

E dyta, Ligji nuk ka metodologji të fortë për përgatitjen e buxhetit gjyqësor për çdo gjykatë dhe të tërë buxhetit për gjyqësinë, nuk është përgatitur metodologji për miratimin e buxhetit gjyqësor si i pavarur dhe i mëvetësishëm. Në procedurë të veçantë nuk ka metodologji të ndarjes së mjeteve për buxhetin gjyqësorë nga buxheti i shtetit.

Rekomandim:

Është e domosdoshme të punohet për përgatitjen e akteve nënligjore, metodologjisë për përgatitje dhe realizim të buxhetit të gjykatës. Paralelisht, e domosdoshme është të përpilohet një program për formimin e fondit për mjetet që janë prej burimeve të veta të gjyqësisë, të cilat, sipas këtij programi duhet të përdoren për përparimin e gjendjes së gjyqësisë në të gjitha aspektet: duke filluar prej ndërtesave, teknikës dhe teknologjisë dhe përparimit të metodave për punë dhe punë shkencoro-hulumtuese.

Së fundi, duhet të zgjidhet edhe çështja e përgatitjes dhe sjelljes së Ligjit për rrogat e gjykatësve.

Gjykatat poshtu finansohen edhe nga taksat gjyqësore, taksat për depozit gjyqësor dhe burime të ngjashme. Këto mjete ruhen në llogari të veçanta dhe përcjellen në buxhetin shtetëror në çdo 15 ditë.

Rekomandime

1. Çështja e pavarësisë së gjyqësisë në Republikën e Maqedonisë është komplekse dhe kërkon një qasje implementuese përmes strategjisë për reforma në gjyqësi me vënien e kaheve të qarta në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, e pastaj edhe në ligjet e tjera me të cilët zgjidhet kjo çështje, pozita, funksionimi dhe organizimi i gjyqësisë.
2. Të gjitha gjykatat duhet me konsekuencë ta zbatojnë dispozitën e LPN për pagesën e taksave gjyqësore me çka qytetarët do të veshin në pozitë të njëjtë siç e parashihet këtë ligji. Gjykatave që nuk e zbatojnë me konsekuencë dispozitën për pagesën e taksave gjyqësore, duhet tu bëhet me dije kjo.
3. Duhet të mundësohet që kërkesa për përjashtim të paraqitet edhe pas fillimit të shqyrtimit kryesor, sepse nuk përjashtohet mundësia që rrethanat të cilat

shkaktojnë dyshim në paanësinë e gjykatësit ose gjykatësit-porotë të krijohen gjatë procedurës. Por, për shkak të faktit që shqyrtimi kryesor është në vijim, në ligj duhet të përshkruhen afati i shkurtër gjatë të cilit duhet patjetër të merret vendim rreth kërkesës për përjashtim.

4. Me qëllim që të pengohet shpërdorimi i mundësisë që të kërkohet përjashtim i gjykatësit, vetëm me qëllim që të zhagitet procedura, do të ishte mirë që të pamundësohet me ligj riparacitja e kërkesës për përjashtim të gjykatësit të njejtë për shkak të rrethanave të njejtë të përmendura në kërkesën paraprake për përjashtim, e cila ka qenë e vlerësuar si e pa bazë.
5. Paanësia duhet vazhdimisht të ndiqet përmes institutit për përjashtimin e gjykatësve dhe gjykatësve porotë, mënyra e ndarjes së lëndëve ndërmjet gjykatësve dhe sa më shpejt duhet të fillojë sjellja e një ligji të veçantë për organizimin e gjyqësisë i cili duhet ta ndjekë dhe plotësojë ligjin e gjykatave.
6. Duhet të ndryshohen dispozitat e LPN për vlerën e lëndëve të kontestit që gjykohet nga gjykatësi individ dhe të rritet vlera e lëndës së kontestit për gjykim nga gjykatësi individ (edhe për kontestet për kërkesat pronësore juridike në procedurë të rregullt edhe për kontestet ekonomike).
7. Për përqindjen e lartë të lëndëve në të cilat vlera e lëndës së kontestit nuk është përcaktuar, duhet tu bëhet me dija gjykatësve për zbatimin me konsekuencë dhe adekuat të dispozitave ligjore sepse kjo mund të shkaktojë shpërdorime serize në pagimin e taksave gjyqësore.
8. Që të evitohet të gjitha dyshimet e mundshme për çfarëdo ndikimi ndaj pavarësisë së gjykatësit, do të duhet të ndërmerren masa dhe të shqyrtohet mundësia për ndryshimin e rregulloreve që e rregullojnë procedurën dhe mënyrën e zgjedhjes dhe shkarkimit të gjykatësve.
9. Në LPN duhet të caktohen afatet në të cilat kryetari i gjykatës do të vendosë për kërkesën për përjashtim.
10. Në rastet në të cilat ka më shumë bashkë aktorë, të merret vendim për ndarjen e procedurës, poqese këtë gjykatësi e çmon si jo të përshtatshme, në vend të marrjes së vendimit për gjykim në mungesë.
11. Që të mundësohet prania e opinjonit të përgjithshëm, gjykatat duhet ta zgjidhin në mënyrë organizative këtë çështje për atë se si, për ditën dhe orën e një gjykimi të caktuar, t'i informojë në kohë ata që do të tregojnë interes për këtë. Gjykatat duhet sa më shpejt të kompjuterizohen me çka do të mundësohet marrja në kohë e informatave për ditën dhe orën e gjykimit si dhe për stadiumin të cilin e ka arritur një lëndë e caktuar. Në këtë mënyrë do

të lehtësohet komunikimi edhe me palët edhe me mbrojtësit dhe personat tjerë të interesuar.

12. Duke pasur parasysh natyrën e lëndëve penale duhet bërë përpjekje (bile edhe të insistohet) që gjykimet të mbahen në gjykatore, e jo në zyrat e gjykatësve ku nuk ka kushte për zhvillim normal të gjykimit, për prani të të gjithë personave të inetersuar, për zhvillimin e veprimeve procedurale si, dëgjimi i dëshmitarëve, ekspertëve etj.
13. Duke pasur parasysh angazhimin e madh të gjykatësve me lëndë dhe rifillimin e shpeshtë të shqyrtimit kryesor për shkak të kalimit të afatit prej 30 ditëv, do të mund të pranohen disa zgjidhje krahasuese ku ky afat është caktuar në 2 muaj respektivisht jo më shumë se 3 muaj.
14. Është e pëlqyeshme që në urdhërin e shkruar për ekspertizë gjykatësi të mundet të caktojë një afat për të cilin ekspertiza duhet të përfundojë. Afati i caktuar gjithsesi se do të mundet të vazhdohet pas kërkesës së ekspertit me qëllim të kryerjes së suksesshme të ekspertizës. Në këtë mënyrë do të shmangeshin shtyrjet e shqyrtimit kryesor në kohë të pacaktuar që i jep ekspertit liri të madhe, por do të shmanget edhe mosdorëzimi i ekspertizave të kryera për shkak të moskryerjes së pagesave në mes institucionit që ka bërë ekspertizën dhe gjykatës.
15. Shtyrja e seancave për një lëndë të njejtë shumë herë konsiderojmë se është e palejueshme dhe në këtë drejtim duhet kërkuar zgjidhje të cilat do të shpënin drejt ndryshimeve dhe plotësimeve të LPN.
16. Duhet të bëhen ndryshime në LPN me të cilat përgjigja ndaj akuzës dhe seanca përgaditore do të ishin paraparë si faza të domosdoshme të procedurës.
17. Gjykata duhet të orvatet që seancat të mos shtyhen në kohë të pacaktuar.
18. Dispozitat e LPN-së për pushimin e procedurës duhet të shfuqizohen.
19. Në përputhje me dispozitat për përdorimin e gjuhëve gjatë procedurave penale çdo gjykatë duhet të ketë listën e përkthyesve të regjistruar gjyqësor për gjuhë përkatëse me qëllim që gjykatësi të mundet në kohë të sigurojë interpretues cilësorë dhe të dëshmuar. Nuk guxon të tolerohet që mossigurimi i interpretuesit të jetë shkak për shtyrjen e seancës. Kjo flet se gjykatësi nuk e ka përgatitur si duhet shqyrtimin kryesor.

20. Kompjutorizimi i punës së gjykatave duhet të kontribuojë që puna e gjykatësit dhe të gjitha veprimet e procesit që dalin prej saj, të përpunohet, evidentohen dhe të futen në kompjutorë (dosie kompjutorike) që e punon. Në këtë mënyrë krijohet mundësia që përmes kompjutorit, gjykatësi ta ketë dosien pranë vetes dhe gjithmonë të mund ta përdorë gjatë përgatitjes për punë ose gjatë vetë punës rreth asaj lënde. Dosia e përgatitur kësisoji (e përpunuar në kompjutor) i ndihmon gjykatësit në punën e tij por edhe siguron një shikim të plotë në atë që ndodh, si dhe atij që bën shikimin e dosies, i cili e shfrytëzon dhe për çfarë qëllimesh si dhe sigurohet një shkallë e lartë e mbrojtjes së vetë dosies.
21. Është e domosdoshme që në ligjin e gjykatave të nis rregullimi i plotë dhe i hollësishëm i çështjeve përkitazi me përgjegjësinë disiplinore të gjykatësve.
22. Është e domosdoshme të punohet për përgatitjen e akteve nënligjore, metodologjisë për përgatitje dhe realizim të buxhetit të gjykatës. Paralelisht, e domosdoshme është të përpilohet një program për formimin e fondit për mjetet që janë prej burimeve të veta të gjyqësisë, të cilat, sipas këtij programi duhet të përdoren për përparimin e gjendjes së gjyqësisë në të gjitha aspektet: duke filluar prej ndërtesave, teknikës dhe teknologjisë dhe përparimit të metodave për punë dhe punë shkencoro-hulumtuese. Së fundi, duhet të zgjidhet edhe çështja e përgatitjes dhe sjelljes së Ligjit për rrogat e gjykatësve.

Shtojca 1

Raport për lëndët e interesit të veçantë

Koalicioni “Të gjithë për gjykime të drejta” , në suazat e projektit “Vëzhgimi i implementimit të standardeve ndërkombëtare për gjykime të drejta në gjykatat e vendit dhe vlerësimi i funksionimit të gjyqësisë në Republikën e Maqedonisë”, në opinion doli me dy

raporte për ato lëndë të cilat nga Bordi ekzekutiv i Koalicionit më 22.12.2003 u zgjedhën si lëndë me interes të veçantë:

1. Lënda **P.br.612/01** e cila zhvillohet në Gjykatën themelore në Tetovë, për shfuqizimin e Kontratës për shitëblerje të pronës së patundshme, të lidhur në mes Tetovo Tabak SHA Shkup, të përfaqësuar nga drejtori Sretko Gjurçinovski si shitës dhe Makedonija 2000 SHPK Eksport Import Shkup të përfaqësuar nga personi i autorizuar Bozhidar Gjorgjievski si blerës.

Lëndën e gjykonte këshili gjyqësor i përbërë prej një gjykatësi dhe dy gjykatës porotë.

Palët kanë të autorizuarit e tyre të cilët janë avokatë dhe gjatë procedurës respektohet *e drejta e tyre për mbrojtje*.

Ankesa për lëndën është parashtruar më 10.09.2001, e më 17.09.2001 ajo i dorëzohet të paditurit. Aktgjykimi i lëndës një herë është shfuqizuar dhe kthyer për vendosje të sërishme në shkallën e parë me vendim të Gjykatës së apelit më 20.02.2003, në bazë të ankesës së deklaruar nga i padituri.

Gjatë procedurës është respektuar *parimi i opinionit* dhe vëzhguesve u është siguruar qasje e papenguar në seancat dhe në shkresat e lëndës nga ana e gjykatësit dhe e administratës gjyqësore.

Gjatë tërë procedurës, dy gjykatës kanë qenë të përjashtuar nga kryetari i gjykatës. Gjykatësi i parë ka qenë i përjashtuar me kërkesë të të paditurit në përputhje me nenin 65 pika 6të Ligjit të procedurës ndërgjyqësuese për shkak të lidhjeve farefisnore me paditësin. Gjykatësi i dytë ka qenë i përjashtuar në bazë të deklaratës së tij për përjashtim për shkak të lidhjeve të afërta me palët.

Kjo lëndë është shtyrë 17 herë dhe mund të konfirmohet se arsye më e shpeshtë për këtë ka qenë kërkesa e palëve ose të autorizuarëve të tyre, mosprania e tyre, dorëzimi jo në rregull i thirrjeve që në seancën e gjashtë ka qenë arsye e shtyrjes së shqyrtimit kryesor ndërsa për dy seanca arsyet e shtyrjes kanë qenë në anën e gjykatës. Sa i përket shtyrjes së

Shqyrtimit kryesor mund të vërehet se në tri seanca palët dhe të autorizuarit e tyre nuk kanë qenë të pranishëm edhe pse kanë qenë të thirrur me rregull.

Më 30.03.2004 gjykata solli aktgjykimin menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe i njejtë është lënë në arkivin e gjykatës më 29.06.2004 për t'iu dorëzuar palëve.

Përpos lëshimeve të caktuara sa u përket arsyeve për shtyrjen e gjykimeve dhe kohëzgjatjes prej 90 ditësh nga sjellja e aktgjykimit deri në dorëzimin e tij tek palët, që paraqet shkelje të *parimit të gjykimit në afat të arsyeshëm* në përputhje me nenin 6 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, sipas standardeve ndërkombëtare për gjykime të drejta, në lëndën konkrete është konstatuar se nuk ka shkelje tjera.

2. Lënda **K.br.229/03** e cila mbahet në Gjykatën themelore në Veles për vepër penale Dhunë, sipas nenit 386 paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 1 të KP kuindër të akuzuarëve Ordanço Tasev dhe 19 të tjerëve. Lëndën e gjykon Këshilli gjyqësor në përbërje 1+2,

prandaj sipas peshës së veprës penale mund të konstatohet se gjykata është formuar në rregull. Element shtesë është paraqitja e personave të mitur si viktimea.

Bëhet fjalë për lëndë të ndërlikuar për vepër sipas nenit 386 të Kp – dhunë, e cila është vepër penaëe e ndërlikuar, por në këtë rast bëhet fjalë për paragrafin 2 të nenit të përmendur (vepër e kryer nga ndonjë grup, dhunë e ashpër , me pjesëmarrje të një numri më të madh të aktorëve dhe e cila në opinion shkakton ndjenjë të pasigurisë, rrezikimit dhe frikës).

Këshilli gjyqësor të gjithë të akuzuarëve u ka siguruar mbrojtës sipas zgjedhjes së tyre. Ka rast kur mbrojtësit nuk paraqiten në gjykim për shkak të angazhimit të madh ose për shkak të refuzimit të autorizimit nga i akuzuari, por gjykata menjëherë ka caktuar mbrojtës sipas detyrimeve zyrtare. Domethënë, gjykata e ka respektuar parimisht **të drejtën për mbrojtës**.

Këshilli gjyqësor ka zbatuar parimisht parimin e informimit të të akuzuarit për të drejtat e tij: **të mbrohet me heshtje** (askush deri tani nuk ka përdorur këtë të drejtë), **të drejtën e përdorimit të gjuhës** dhe standardet tjera për garancë të të akuzuarit gjatë procedurës penaëe;

Deri në momentin e përgatitjes së raportit, për këtë lëndë janë mbajtur 8 seanca në të cilat është zhvilluar procedura e dëshmisë.

Sa i përket dhënies së dëshmive, përdoret qasje e dyfishtë: dëshmitarët gojarisht i japin dëshmitë e tyre, kurse për disa lexohen edhe dëshmitë e tyre që i kanë dhënë gjatë procedurës hetuese. Dias nga dëshmitarët gjatë shqyrtimit kryesor i tërheqin dëshmitë e tyre që i kanë dhënë gjatë hetimit dhe arsyetohen me atë se kanë qenë të detyruar të dëshmojnë një gjë të tillë. Me propozim të mbrojtjes bëhen ballafaqime gjatë shqyrtimit kryesor. Janë kryer edhe ekspertiza, veçanërisht për lëndimet e shkaktuara fizike.

Për shkak të numri më të madh të të akuzuarëve, gjykimi zhvillohet në vazhdimësi dhe deri tani janë mbajtur disa shqyrtime kryesore për dhënien e dëshmive. Gjatë seancës së fundit të mbajtur më 31.03.2004 personi i autorizuar i të akuzuarit të parë ka njoftuar gjykatën se i akuzuari i parë është i sëmirë rëndë dhe për këtë arsye nuk është në gjendje të marrë pjesë në gjykim. Gjykata ka shtyrë shqyrtimin kryesor për kohë të pacaktuar.

Vëzhguesit e procesit konstatojnë se respektohen të drejtat e të akuzuarit për mbrojtje të ndershme, në atë mënyrë që u është dhënë mundësia të shikojnë të gjitha dëshmitë, pranohen propozimet e dëshmitarëve dhe bëhet ballafaqimi, respektohen afatet ligjore për njoftim në kohë për mbajtjen e shqyrtimit. Gjykata e siguron këtë në mënyrë që për çdo shqyrtim kryesor të përfunduar, në procesverbal e cakton shqyrtimin e ardhshëm dhe në kë mënyrë i njofton palët.

Në këtë proces **nuk ka kërkesë për përjashtim** të kryetarit, të këshillit dhe gjykatësve porotë. Vlerësimi i përgjithshëm i vëzhguesve është se nuk ka indikacione për sjellje dhe veprim të anësisë së gjykatës.

Gjatë tërë procedurës respektohet **parimi i opinionit**. Doemos të përmendet edhe fakti se ky rast ka qenë i ndjekur, komentuar, sqaruar në të gjitha mediat publike, me çka mund të thuhet se u krijua një atmosferë e shtypjes së vazhdueshme mbi gjykatën.

Rreth sjelljes personale të kryetarit të këshillit, vëzhguesit kanë vërejtur se gjatë gjykimit ai ka pirë duhan. Kjo është një vërejtje e mirë sa i përket sjelljes së gjykatësve gjatë shqyrtimit kryesor.

Shtojca 2

Konkluzione nga tryeza e rumbullakët e mbajtur me rastin e Raportit përfundimtar të Koalicionit “Të gjithë për gjykime të drejta”

Në tryezën e rumbullakët që u mbajt me rastin e Raportit përfundimtar të Koalicionit “Të gjithë për gjykime të drejta” në të cilën përveç antarëve të Zyrës nacionale të Koalicionit dhe ekspertëve juridikë nacionalë për sferën penale dhe civile, përfaqësuesve të Misionit vëzhgues së OSBE-së në Shkup, morën pjesë edhe përfaqësuesit më të lartë të gjyqësisë, Ministrisë së drejtësisë të Republikës së Maqedonisë, Shoqatës së gjykatësve, Shoqatës së prokurorëve publikë, Këshillit gjyqësor Republikan, Zyrës së avotatit popullor, zyrës së Këshillit të Evropës në Shkup si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të cilat punojnë në sferën e funksionimit të gjyqësisë. Nga diskutimi cilësor u nxorrën këto konkluzione:

- Pjesëmarrësit i dhanë përkrahje të plotë Koalicionit “Të gjithë për gjykime të drejta” në implementimin e projektit që vijon nga sfera e mbikqyrjes së implementimit të standardeve ndërkombëtare për gjykime të drejta nga gjykatat e vendit.
- Pjesëmarrësit u pajtuan se ka nevojë të mbikqyren procedurat gjyqësore nga persona të paanëshëm të cilët nuk i takojnë gjyqësisë e as janë të involvuar si palë gjatë procedurave dhe se ka nevojë për zbatimin e hulumtimeve objektive me qëllim që të gjenden problemet me të cilat ballafaqohet gjyqësia dhe gjetja e zgjidhjeve përkatëse të cilat në formë të propozimeve do t’u dorëzohen organeve kompetente.
- Konkluzionet dhe rekomandimet nga projekt versioni i raportit përfundimtar të Koalicionit morën vlerësim pozitiv dhe përkrahje nga përfaqësuesit e gjyqësisë dhe institucioneve tjera që ndërlidhen me funksionimin e saj. Raporti me rekomandimet pas botimit të tij do t’i dërgohet Këshillit për reforma të gjyqësisë në Ministrinë e drejtësisë.
- Formimi i grupit të punës të përbërë nga përfaqësues të Koalicionit “Të gjithë për gjykime të drejta”, Ministria e drejtësisë, gjykata supreme e RM, gjykatat e apelit, Këshilli gjyqësor republikan dhe Prokuroria publike e RM, me qëllim të vetëm që të ndiqet zbatimi i rekomandimeve nga raporti përfundimtar dhe përfshirja e tyre në procesin e reformave gjyqësore, që do të kontribuojë në rritjen e respektimit të standardeve ndërkombëtare për gjykime të drejta në gjykatat e vendit, për rritjen e besimit të qytetarëve në gjyqësinë dhe për zbatimin më efikas të reformave gjyqësore në Maqedoni.

Shtojca 3

Letra përkrahjeje

(Përkthim i origjinalit prej maqedonisht në shqip)

GJYKATA THEMELORE PRILEP

-Kryetari-

20.09.2004

Për:Koalicionin “Të gjithë për gjykime të drejta”

Realizimi i sukseshëm i projekteve të këtilla ka rëndësi të veçantë si për këtë gjykatë ashtu edhe për gjyqësinë në tërësi.

Mendoj se prania e personave që vlerësojnë punën e gjykatës e që nuk janë palë në kontest, ka rëndësi për gjykimet, që do të ketë ndikim për objektivitetin e vlerësimit të punës së gjykatës. Veçanërisht për arsye se në opinion gjithnjë e më tepër janë të pranishme mendimet e, sipas meje, në masë të madhe pohimet e pa baza, për joefikasitetin dhe korupcionin e gjyqësisë.

Në bazë të hulumtimeve të bëra kësisoj, nga organizata të pavarura siç është e Juaja, do të krijohen baza reale për t'i nxjerr në pah problemet dhe për një vlerësim më objektiv për punën e gjykatave. Kjo, për atë se, nga materiali i dorëzuar prej jush shihet se objektivi kryesor i interesimit tuaj është zbatimi i ligjeve nga gjykatësit në procedurat e ndryshme në gjykatat në R.M.

Të dhënat e grumbulluara kësisoj dhe rekomandimet e dhëna prej jush, mund të shërbejnë edhe si rekomandime për ndryshime të ligjeve procesuese që do të mundësojë edhe zgjidhje më efikase të kontesteve.

Sa i përket Gjykatës themelore në Prilep, ju edhe më tutje do ta kenë bashkëpunimin tonë.

Me respekt,
Kryetari i gjykatës themelore Prilep
Angelço Videv
nënshkrim
vulë e rumbullakët me shënimin
Gjykata themelore Prilep

(Përkthim i origjinalit prej maqedonisht në shqip)

Republika e Maqedonisë

GJYKATA THEMELORE

Su.br.347/2004

24.09.2004

R e s n j ë

KOALICIONIT

-Të gjithë për gjykime të drejta-
S H K U P

Në lidhje me raportin e Koalicionit- Të gjithë për gjykime të drejta (projektverzioni), që keni dorëzuar, Kolegjiumi gjyqësor i Gjykatës themelore Resnjë gjatë mbajtjes së mbledhjes më 21.09.2004, duke analizuar raportin i jep përkrahje të plotë atij, pa vërejtje dhe në i pranon në tërësi konstatimet dhe rekomandimet e shkruara.

Në këtë kuptim, përveç tjerash vëmë në pah dy probleme më të ndjeshme të gjyqësisë në përgjithësi. Ato janë lëndët e kundërvajtjes, lëndët ekzekutive dhe problemi i dorëzimit. Është fakt se kjo çështje është përmendur vite më parë që nga fillimi i reformave në gjyqësi, që datojnë nga viti 1996, ato janë të njohura dhe nuk duam që në këtë rast t'i elaborojmë, por sipas mendimit tonë konsiderojmë se këto janë probleme të rëndësishme, të cilave duhet t'u kushtohet përparësi gjatë reformave dhe vlerësojmë se në masë të madhe do të përmirësohej gjendja e gjyqësisë, poqese ato zgjidhen. Numri i gjykatësve të cilët punojnë në lëndët e kundërvajtjes është i madh. Poqese ato lëndë hiqen nga kompetenca e gjyqësisë, gjykatësit do të kishin qenë të angazhuar në zgjidhjen e lëndëve tjera të komplikuar, si në sferat penale ashtu edhe në ato civile, do t'u kushtohet vemendje më e madhe atyre lëndëve dhe do të pakësoheshin intervenimet e palëve për zgjatjen e procedurave ose mosmarrjen e lëndëve në punë për një periudhë më të gjatë. Poashtu, nëse problemi i dorëzimit do të zgjidhej më shpejt, mendojmë se kjo do të kishte efekt pozitiv si për përmirësimin e gjendjes financiare të gjyqësisë ashtu edhe për azhuritetin e gjykatës, sepse lëndët të cilat për shkak të dorëzimit jo të rregullt shtyhen, do të ishin zgjidhur më shpejt, me çka do të vinte në shprehje puna ekspeditive e gjyqësisë dhe eliminimi i problemit me grumbullimin e lëndëve.

Me këtë rast duam të vëmë në pah probleme të caktuara të pranishme në këtë gjykatë, të cilat ndikojnë në punën e përgjithshme të gjykatës. Në të vërtetë, ai është problemi i gjykatoreve, i lokaleve dhe arkivit.

Gjykata ka vetëm dy gjykatore, kurse drejtësinë e ndajnë 5 gjykatës, duke përfshirë edhe kryetarin e gjykatës. Kjo ndikon që gjatë një dite gjykatoret, nënkuptohet për gjykim, mund t'i shfrytëzojnë vetëm dy gjykatës, kurse të tjerët janë të obliguar ta kryejnë punën në zyrat e veta, që njëherit është gjendje e palakmueshme dhe paraqet problem serioz. Në gjykatë 3 lokale shfrytëzon Prokuroria themelore publike e Resnjës. Ky problem

është theksuar që moti dhe është i pranishëm edhe në gjykatat tjera pasi prokuroritë kryesisht janë të vendosura në ndërtesat e gjykatave. Nëse gjendet zgjidhje me këtë edhe prokuroria zhvendoset, përdorimi i këtyre tre lokaleve, respektivisht me marrjen e këtyre lokaleve nga gjykata do të zgjidhej edhe ai problem, sepse mometalisht, vetëm si shembull me një hapësirë relativisht të vogël janë vendosur këshilltari gjyqësor dhe dy bashkëpunëtorë ekspert, kurse e këtillë është gjendja edhe me daktilografët, që nuk jep hapësirë dhe mundësi për kryerjen normale dhe efikase të punësve. Arkivi ekzistues i gjykatës me kapacitetin e tij absolutisht është i pamjaftueshëm, kështuqë lëndët që përfundohen dhe që duhet të vehen në arkiv janë grumbulluar në hapësirën e sekreterisë gjyqësore.

Duke theksuar këto probleme, të cilat në çdo rast janë serioze për gjykatën e duke pasur parasysh mundësitë Tuaja, shpresojmë se në të ardhmen do të mund të presim ndihmën përkatëse nga ana Juaj.

Kolegjiumi gjyqësor,
Kryetari,
Dragi Zhalovski
Nënshkrim
Vulë e rumbullakët me shënimin
Gjykata themelore Resnjë